BULETINI EKONOMIK

mars 2006

Banka e Shqipërisë

Nëse përdorni të dhëna të këtij publikimi, jeni të lutur të citoni burimin.
Botuar nga : Banka e Shqipërisë, Sheshi "Skënderbej", Nr.1, Tiranë.
Tel : 355-4-222230; 235568; 235569;
Faks : 355-4-223558
E-mail: public@bankofalbania.org

www.bankofalbania.org

Shtypur në Shtypshkronjën e Bankës së Shqipërisë.
Tirazhi : 600 kopje

P Ë R M B A J T J A

Opinion mbi gjendjen e ekonomisë në tremujorin e parë të vitit 2006 7
1. Fjala e Guvernatorit 7
2. Zhvillimet ekonomike dhe inflacioni 10
3. Zhvillimet monetare dhe tregjet financiare 23

Diskutim i Guvernatorit të Bankës së Shqipërisë z.Ardian Fullani në Forumin e 11-ë të Euromoney: "Zgjerimi i kufijve: Përforcimi i konkurrencës në Evropën Qendrore dhe Lindore", Vjenë, 18 janar 2006 36

Fjala e Guvernatorit të Bankës së Shqipërisë, z.Ardian Fullani në konferencën për shtyp të organizuar në kuadër të nënshkrimit të marrëveshjes së re me FMN, Tiranë, 30 janar 2006 41

Fjala e Guvernatorit të Bankës së Shqipërisë, z.Ardian Fullani në takimin me komunitetin e biznesit, me përfaqësues të pushtetit lokal dhe të sektorit bankar dhe me akademikë të qytetit të Shkodrës, 17 shkurt 2006 43

Fjala e Guvernatorit të Bankës së Shqipërisë, z.Ardian Fullani "Remitancat: Një mundësi për rritje. Emigracioni shqiptar në Itali si rast studimi." Bari, 3-4 mars 2006 48

Fjala e Guvernatorit të Bankës së Shqipërisë, z.Ardian Fullani në takimin me Kryeministrin e Republikës së Shqipërisë dhe Shoqatën e Bankave. Tiranë, 20 mars 2006 53

Fjala e Guvernatorit të Bankës së Shqipërisë, z.Ardian Fullani në leksionin e parë të Serisë së Leksioneve të Bankës së Shqipërisë. Tiranë, 23 mars 2006 56

Fjala e Guvernatorit të Bankës së Shqipërisë, z.Ardian Fullani në takimin me komunitetin e biznesit, pushtetin lokal, qarqet akademike etj., të Prefekturës së Gjirokastrës. Gjirokastër, 31 mars 2006 58

Investime të huaja direkte. Shënime metodologjike 62

Banka e Shqipërisë në harkun kohor janar-mars 2006 80

Ngjarjet juridike, janar-mars 2006 83

Drejtimi i Bankës së Shqipërisë, 31 mars 2006 86

Lista e subjekteve të licencuara nga Banka e Shqipërisë 87

- *Banka dhe degë të bankave të huaja* 87
- *Subjekte jobanka* 90
- *Subjektet financiare që nuk licencohen nga Banka e Shqipërisë për kryerjen e veprimtarisë së tyre, në mbështetje të vendimit nr. 26, datë 29.03.2000, të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë "Për përjashtimin e disa subjekteve nga zbatimi i dispozitave të ligjit nr. 8365, datë 02.07.1998 "Për bankat në Republikën e Shqipërisë""* 92
- *Zyra të këmbimeve valutore* 93
- *Unionet e shoqërive të kursim-kreditit* 100
- *Zyra të përfaqësimit të bankave të huaja* 100

PËRMBAJTJA E TABELAVE

Opinion mbi gjendjen e ekonomisë në tremujorin e parë të vitit 2006

Tabelë 1. Ecuria e shitjeve të sektorit të industrisë për gjashtëmujorin e parë 2005 (në përqindje). 11
Tabelë 2. Bilanci i energjisë elektrike (në GWh). 12
Tabelë 3. Treguesit e tregut të punës (në mijë vetë). 13
Tabelë 4. Ritmet e rritjes së treguesve fiskalë (në përqindje). 14
Tabelë 5. Ritmet e rritjes së të ardhurave gjatë viteve 2002-2005 (në përqindje). 15
Tabelë 6. Ritmet e rritjes së shpenzimeve gjatë viteve 2002-2005 (në përqindje). 16
Tabelë 7. Ritmet e rritjes së deficitit gjatë viteve 2002-2005 (në përqindje). 16
Tabelë 8. Shpërndarja e deficitit sipas tremujorëve në projektbuxhetet e viteve 2003-'06. 16
Tabelë 9. Struktura e eksporteve dhe importeve (në përqindje). 17
Tabelë 10. Norma vjetore e inflacionit (në përqindje). 19
Tabelë 11. Inflacioni i grupit "Ushqime dhe pije joalkolike" dhe pesha e tij në inflacionin total. 20
Tabelë 12. Inflacioni i grupit "Qira, ujë, lëndë djegëse, energji" dhe pesha e tij në inflacionin total. 20
Tabelë 13. Inflacioni vjetor i vendeve partnere dhe ndryshimet në kursin e këmbimit (në përqindje) për vitin 2005. 22
Tabelë 14. Realizimi i objektivave sasiorë të Bankës së Shqipërisë. 25
Tabelë 15. Treguesit monetarë për periudhën janar-shkurt (në miliardë lekë). 27
Tabelë 16. Ecuria e disa treguesve kryesorë. 27
Tabelë 17. Tregues të tepricës së kredisë në përqindje ndaj totalit (në përqindje). 28
Tabelë 18. Teprica e kredisë sipas degëve të ekonomisë (në përqindje). 29
Tabelë 19. Normat e interesit dhe ndryshimi i tyre në tregun e depozitave në lekë (në përqindje). 32
Tabelë 20. Normat e interesit në tregun e depozitave në valutë dhe ndryshimi i tyre (në përqindje). 32

Investime të huaja direkte. Shënime metodologjike

Tabelë 1. Shpërndarja sektoriale e IHD-ve sipas FMN dhe OECD. 70
Tabelë 2. Përparësitë dhe mangësitë e burimeve kryesore të informacionit për IHD. 76

P Ë R M B A J T J A E G R A F I K Ë V E

Opinion mbi gjendjen e ekonomisë në tremujorin e parë të vitit 2006

Grafik 1. Ecuria e shitjeve të ekonomisë gjatë periudhës T1 '01 – T4 '05. 10
Grafik 2. Kontributi i sektorëve në shitjet e ekonomisë (në pikë përqindjeje). 10
Grafik 3. Ndryshimi vjetor i indeksit të shitjeve për sektorin e ndërtimit (boshti majtas) dhe i indeksit të kushtimit në ndërtim (boshti djathtas). 11
Grafik 4. Norma tremujore e ndryshimit të shitjeve në sektorin "Tregti, hotele dhe restorante" (në përqindje). 11
Grafik 5. Ndryshimi vjetor i shitjeve të sektorit "Industria gjithsej" dhe degëve përbërëse. 12
Grafik 6. Struktura e papunësisë sipas moshës dhe arsimit. 13
Grafik 7. Treguesit kryesorë fiskalë, janar–shkurt 2006 (në miliardë lekë). 14
Grafik 8. Struktura e të ardhurave buxhetore për dy muajt e parë të vitit (në milionë lekë). 14
Grafik 9. Struktura e shpenzimeve buxhetore (në përqindje). 15
Grafik 10. Bilanci tregtar (në milionë euro). 17
Grafik 11. Pesha e importeve dhe eksporteve sipas vendeve (në përqindje). 18
Grafik 12. Inflacioni vjetor (në përqindje). 19
Grafik 13. Kontributi i grupeve kryesore në inflacionin vjetor (në pikë përqindjeje). 19
Grafik 14. Inflacioni vjetor i 4 grupeve kryesore të shportës së IÇK-së (në përqindje). 20
Grafik 15. Ecuria e kushteve monetare. 21
Grafik 16. Rritja vjetore e shpenzimeve buxhetore. 21
Grafik 17. Ndryshimet vjetore të IÇP-së dhe IÇK-së për vitet 2002-2004. 23
Grafik 18. Ndryshimi vjetor i çmimit të naftës dhe i kursit të këmbimit (në përqindje). 23
Grafik 19. Ecuria e normës bazë të interesit. 24
Grafik 20. Ecuria e normave vjetore të treguesve monetarë. 25
Grafik 21. Ecuria e raportit të depozitave në valutë ndaj M3. 26
Grafik 22. Struktura kohore e depozitave në valutë dhe norma bazë e interesit të usd. 26
Grafik 23. Raporti i parasë jashtë bankave ndaj M2 dhe norma reale mesatare e interesit. 26
Grafik 24. Ecuria e kontributit të përbërësve të kërkesës për para. 27
Grafik 25. Raporti i kredisë ndaj PBB, norma vjetore e rritjes së kredisë dhe kontributi vjetor ndaj rritjes së M3. 28
Grafik 26. Normat vjetore të rritjes së kredisë sipas monedhës. 28
Grafik 27. Ecuria e normave vjetore të rritjes së kredisë sipas monedhës dhe subjektit. 29
Grafik 28. Mjetet valutore neto të sistemit bankar. 29
Grafik 29. Ecuria kumulative e financimit të deficitit buxhetor (në miliardë lekë). 30
Grafik 30. Ecuria e normave të interesit në tregje, në përqindje. 30
Grafik 31. Niveli i likuiditetit dhe huamarrja në tregun ndërbankar (në miliardë lekë). 31
Grafik 32. Ecuria e normave të interesit në treg ndërbankar. 31
Grafik 33. Ecuria e interesit mesatar të ponderuar të kredive në lekë. 32
Grafik 34. Spread-i midis interesave të depozitave në lekë me ato në valutë. 33
Grafik 35. Ecuria e kursit nominal efektiv (NEER). 34
Grafik 36. Ndryshimi vjetor i kursit mesatar të këmbimit të lekut. 34

Investime të huaja direkte. Shënime metodologjike

Grafik 1. Bilanci i Pagesave dhe IHD. 64

OPINION MBI GJENDJEN E EKONOMISË NË TREMUJORIN E PARË TË VITIT 2006

1. FJALA E GUVERNATORIT

Ekonomia shqiptare në fund të tremujorit të parë të vitit 2006, vazhdon të karakterizohet nga një qëndrueshmëri e përgjithshme makroekonomike, e pasqyruar kryesisht në mbajtjen e inflacionit nën kontroll dhe nga një suficit i konsiderueshëm buxhetor, si rezultat i realizimit të të ardhurave mbi nivelin e planifikuar ndërkohë që shpenzimet buxhetore kanë qenë më të ulta se ky nivel. Monedha kombëtare ka qenë e qëndrueshme për gjatë gjithë periudhës, ndërkohë që të dhënat e janarit, tregojnë se vëllimi i tregtisë së jashtme në vlerë, ka pësuar rritje të ndjeshme në krahasim me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar. Ashtu si dhe në vitin e kaluar kreditimi për ekonominë ka regjistruar qëndrueshmëri në ritmet e rritjes, duke u bërë burim kryesor i zgjerimit të ofertës së parasë.

Inflacioni vjetor, ka qëndruar poshtë kufirit të poshtëm të objektivit të Bankës së Shqipërisë gjatë tre muajve të parë të vitit 2006. Norma mesatare vjetore e inflacionit për tremujorin e parë ishte 1.4 për qind, duke shënuar një ulje prej 0.8 pikësh përqindjeje në krahasim me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar. Inflacioni i ulët i regjistruar gjatë tremujorit të parë të vitit është përcaktuar nga presioni i ulët i ushtruar mbi çmimet e konsumit nga kërkesa agregate, dhe nga mospërcjellja e presioneve të tepërta inflacioniste nga ana e faktorëve të ofertës. Politikat monetare dhe fiskale kanë kontribuar në ruajtjen e stabilitetit makroekonomik, duke kontrolluar tendencat inflacioniste të kahut të kërkesës.

Politika monetare e ndjekur gjatë tremujorit të parë të vitit 2006, ka ruajtur stabilitetin e faktorit monetar në ecurinë e normës së inflacionit. Ngadalësimi i ritmeve të rritjes së treguesve monetarë dhe qëndrueshmëria e treguesve financiarë, kanë treguar përputhje me dinamikën aktuale të presioneve inflacioniste në ekonomi. Ritmi i rritjes së ofertës monetare është ngadalësuar gjatë tremujorit të parë të vitit, ndërkohë që kursi i këmbimit të lekut paraqitet i qëndrueshëm dhe raportet e likuiditetit të ofertës monetare janë përmirësuar. Struktura kohore e normave të interesit të vërejtura në ekonomi, luhatet në intervale minimale dhe të qëndrueshme kundrejt standardeve historike, duke reflektuar edhe pritshmëritë për norma të ulëta inflacioni në periudhën afatmesme.

Politika fiskale e tre muajve të parë, në vijim të reduktimit të ndjeshëm të financimit të brendshëm në fund të vitit 2005, ka ndikuar drejtpërdrejt në krijimin e një ambienti joinflacionist. Sipas të dhënave të Ministrisë së Financave, deri në fund të muajit mars, janë mbledhur 106 për qind e të ardhurave të planifikuara dhe janë realizuar rreth 87.6 për qind e shpenzimeve të programuara. Kështu bilanci fiskal për tremujorin e parë të vitit rezultoi me

rreth 10.3 miliardë lekë suficit, nga 1.1 miliardë lekë të parashikuara. Rritja e të ardhurave buxhetore dëshmon për një hap përpara në rritjen e efikasitetit të administrimit fiskal.

Si rezultat i të ardhurave të shtuara dhe i një përmbajtjeje të Qeverisë në kryerjen e shpenzimeve, *yield*-i i bonove të thesarit ka manifestuar një rënie me hapa të lehtë por gradualë, gjatë gjithë tremujorit të parë. Megjithatë, politika e qeverisë në kryerjen e shpenzimeve gjatë gjysmës së dytë të vitit 2006 duhet ndjekur me kujdes, për të korrigjuar efektet e mundshme negative të një përqendrimi të tyre në segmente të shkurtra kohore. Gjithashtu, realizimi i investimeve kapitale kërkon një vëmendje më të madhe nga ana e autoriteteve përgjegjëse, duke qenë se këto investime shërbejnë për krijimin e infrastrukturës së domosdoshme për mbështetjen e rritjes ekonomike në periudhën afatgjatë.

Kursi i këmbimit të lekut paraqitet i qëndrueshëm në terma nominalë efektivë, por gjithsesi me një mbiçmim vjetor me 1.0 për qind. Kursi mesatar i këmbimit të lekut ndaj euros shënoi një mbiçmim vjetor prej 2.9 për qind, gjatë tremujorit të parë të vitit 2006. Megjithatë, tendenca mbiçmuese e lekut ndaj euros ka ardhur në rënie krahasuar me tremujorin paraardhës dhe me të njëjtin tremujor një vit më parë.

Ecuria e çmimeve të naftës në tregjet ndërkombëtare në tre muajt e parë të vitit 2006, dëshmon për një presion të jashtëm në rritje. Rritja vjetore e çmimeve të karburantit në tregjet ndërkombëtare gjatë tremujorit të parë është 23 për qind. Rritjet e ditëve të fundit si dhe perspektiva e paqartë që karakterizon këtë treg, ngrenë shumë pikëpyetje mbi ndikimet që do të ketë çmimi i këtij produkti në ekonomi. Pesha e vogël që zë ky produkt (nëngrupi ku përfshihet çmimi i naftës ka një peshë prej 1.6 për qind në shportën e indeksit të konsumatorit), bën që efekti direkt në inflacion të jetë i kufizuar. Megjithatë, shqetësim mbeten efektet e raundit të dytë, të cilat mund të ndikojnë në inflacion në formën e rritjes së kostove.

Rritja vjetore e ofertës monetare ka zbritur në 11.6 për qind në muajin shkurt kundrejt 14.0 për qind në fund të vitit 2005. Në vlerë absolute, gjatë dymujorit të parë, agregati M3 është rritur vetëm me 2.2 miliardë lekë. Kthimi i parasë *cash* në sistem pas rritjes sezonale të saj në fund të vitit të kaluar, ka rezultuar me ritme më të shpejta se parashikimet. Gjithashtu, bilanci fiskal pozitiv i sektorit publik në muajt e parë të vitit, ka kushtëzuar huamarrje të ulët të qeverisë nga sistemi bankar. Të dy këta faktorë kanë krijuar kushte për rritjen e shpejtë të likuiditetit të sistemit gjatë tremujorit të parë.

Teprica e likuiditetit të sistemit bankar ka shfaqur tendencë rritjeje drejt nivelit 9.5 miliardë lekë në fund të tremujorit të parë, ndërsa mesatarja tremujore rezulton rreth 5.8 miliardë lekë. Prania e Bankës së Shqipërisë në tregjet e parasë ka synuar tërheqjen e likuiditetit të sistemit nëpërmjet përdorimit të instrumenteve afatgjata dhe afatshkurtra të politikës monetare. Instrumenti kryesor ka qenë marrëveshja e anasjelltë e riblerjes me maturim njëjavor, me çmim fiks dhe shumë të pakufizuar. Njëkohësisht, që prej muajit shkurt, Banka e Shqipërisë ka tërhequr likuiditet me anë të repove me maturim tremujor,

ndërsa likuiditeti i investuar nga bankat në repo me afat maturimi njëmujor ka qenë në nivele minimale. Tërheqja e likuiditetit me anë të repove tremujore dhe njëmujore ka synuar zbutjen e presioneve rënëse të normave të interesit në tregjet e parasë. Gjithashtu, Banka e Shqipërisë ka tërhequr tepricat ditore të likuiditetit nëpërmjet përdorimit të depozitës njëditore.

Paralelisht, Banka e Shqipërisë ka qenë e pranishme në tregun valutor në përputhje me strategjinë e saj për përmbushjen e objektivave sasiorë. Ndërhyrjet në tregun valutor kanë rezultuar në injektimin e rreth 0.8 miliardë lekëve para në qarkullim. Njëkohësisht, prania e Banka e Shqipërisë në këtë treg ka përmirësuar pozicionin e rezervës valutore për tremujorin e parë, duke kontribuar në rritjen e nivelit të rezervës në rreth 100 milionë usd mbi objektiv. Në kushtet e kontraktimit të bazës monetare, është mundësuar respektimi i objektivit të mjeteve të brendshme neto, ndërsa mungesa e nevojës për financim të deficitit fiskal ka lënë të pandryshuar nivelin e kredisë së brendshme neto për qeverinë.

Struktura valutore dhe ajo kohore e ofertës monetare ka respektuar tendencat historike të vërejtura në vitet e fundit. Komponenti valutor i ofertës monetare ka vazhduar të rritet me ritëm më të shpejtë. Raporti i depozitave në valutë ndaj M3 në muajin shkurt u rrit në 27.2 për qind nga 24.1 për qind në muajin shkurt të një viti më parë.

Ecuria e kredisë në periudhën janar - shkurt të vitit 2006 ka ruajtur tendencën rritëse të dëshmuar gjatë vitit 2005. Teprica e kredisë është rritur me 7 miliardë lekë ose me një normë vjetore mesatare 71.4 për qind. Gjatë kësaj periudhe janë akorduar gjithsej 18 miliardë lekë kredi e re ose 31 për qind më shumë se kredia e dhënë për të njëjtën periudhë një vit më parë. Në fund të muajit shkurt 2006, kredia për ekonominë përbënte 22.2 për qind të M3 dhe 15.2 për qind të PBB-së së parashikuar për vitin 2006. Nga ana tjetër, rritje të mëtejshme kanë pasqyruar edhe treguesit e ndërmjetësit bankarë. Raporti i kredisë ndaj aktiveve totale të sistemit bankar arriti në 25.6 për qind, ndërsa ndaj totalit të depozitave në 29.2 për qind. Nga ana tjetër, rritja e shpejtë e kredisë mund të ketë ndikuar në thellimin e deficitit të llogarisë korente, duke mbështetur rritjen e kërkesës për mallra e makineri të importuara.

Raporti i kredisë afatshkurtër ndaj totalit të kredisë ka ruajtur një tendencë zbritëse në dy muajt e parë të vitit 2006. Nga ana tjetër, vihet re që kredia me afat maturimi mbi 5 vjet vazhdon trendin e saj rritës, duke dëshmuar në fund të muajit shkurt një rritje të konsiderueshme në 38 për qind të portofolit të kredisë. Kreditimi i degëve të ekonomisë kryesisht ka ruajtur të njëjtën shpërndarje si dhe në fund të vitit të kaluar. Sektori i tregtisë mbetet dega më e kredituar me 18.7 për qind të portofolit të kredisë. Kredia për sektorët prodhues të ekonomisë ka pasqyruar rritjen më të ndjeshme, duke arritur në 14.3 për qind. Kredia për sektorin e ndërtimit ka mbetur e pandryshuar në nivelin 13 për qind të portofolit të kredisë.

Në këndvështrimin e saj perspektiv Banka e Shqipërisë, mbi të gjitha mbështetet në modelet e saja të parashikimit të inflacionit. Në përputhje me

këto parashikime si dhe mbështetur në zhvillime të pritshme, kombëtare dhe ndërkombëtare, jemi duke vlerësuar me kujdes përshtatshmërinë e pozicionit aktual të politikës monetare, dhe nivelin prej 5 për qind të normës bazë të interesit.

Pavarësisht se parashikimet afatshkurtra flasin për një normë nën kontroll të inflacionit, në jemi duke vlerësuar me shumë seriozitet disa rreziqe potenciale, të cilat prej pak kohësh po rrinë pezull mbi ekonominë tonë. Më konkretisht, faktorë të tillë si: ecuria e çmimeve të naftës dhe energjisë, rritja e shpejtë e kreditimit, përqëndrim i madh i mundshëm i shpenzimeve buxhetore në muajt e fundit të vitit (përfshirë dhe një buxhet të mundshëm shtesë) si dhe ulja e vazhdueshme e dallimit midis normave të interesit në lekë me ato në valutë, mund të diktojnë nevojën e një korrigjimi të mundshëm të shënjestrës së politikës monetare, duke e nxjerrë atë nga statusi i neutralitetit ku ajo po qëndron për një kohë relativisht të gjatë.

Grafik 1. Ecuria e shitjeve të ekonomisë gjatë periudhës T1 '01-T4 '05.



Burimi: INSTAT, Indeksi i shitjeve.

Grafik 2. Kontributi i sektorëve në shitjet e ekonomisë (në pikë përqindje).



Burimi: INSTAT, Indeksi i shitjeve.

2. ZHVILLIMET EKONOMIKE DHE INFLACIONI

2.1 AKTIVITETI EKONOMIK DHE RRITJA EKONOMIKE

Vlerësimi i ecurisë së ekonomisë shqiptare gjatë tremujorit të parë të vitit 2006 bëhet i vështirë, në mungesën e të dhënave të pothuaj të gjithë treguesve ekonomikë sipas sektorëve të ndryshëm. Të dhënat në dispozicion mundësojnë analizimin e zhvillimeve të shitjes së ekonomisë në tremujorin e fundit të vitit 2005 dhe ecurinë e sektorit të energjitikës gjatë tremujorit të parë 2006.

Indeksi i shitjeve të ekonomisë në total është rritur me 13.5 për qind në terma vjetorë në tremujorin e katërt të vitit 2005. Rritja e shitjeve sipas sektorëve ka ndryshuar dinamikë gjatë tremujorit të fundit të vitit 2005. Kontributi i sektorëve të "Industrisë" dhe të "Ndërtimit" në rritjen vjetore të shitjeve të ekonomisë ka rënë ndjeshëm në krahasim me një vit më parë. Sektori i industrisë ka kontribuar me 0.36 pikë përqindje dhe sektori i ndërtimit me 1.1 pikë përqindje, në rritjen e shitjeve të ekonomisë gjatë tremujorit të katërt 2005. Gjatë të njëjtit tremujor një vit më parë, këta sektorë kanë kontribuar përkatësisht me 2.4 pikë përqindje dhe 7.9 pikë përqindje. Ndërkohë, kontributi i sektorit "Tregti, hotele dhe restorante" është rritur nga 5.8 në 10.1 pikë përqindje.

Ndërtimi

Duke gjykuar nga ecuria e shitjeve dhe nga ecuria e grupit "Importi i dukshëm i çimentos", sektori i "Ndërtimit" ka ulur ritmet e rritjes gjatë tremujorit të katërt 2005. Shitjet për këtë periudhë kanë shënuar një rritje vjetore prej 6.8 për qind, nga 45.6 për qind një vit më parë dhe importet e çimentos u ulën me 1 për qind. Kostot e ndërtimit, siç tregohen nga indeksi i kushtimit në ndërtim, janë rritur në norma modeste si në krahasim me tremujorin e mëparshëm, ashtu edhe në krahasim vjetor.

Grafik 3. Ndryshimi vjetor i indeksit të shitjeve për sektorin e ndërtimit (boshti majtas) dhe i indeksit të kushtimit në ndërtim (boshti djathtas).



Burimi: INSTAT, Indeksi i shitjeve.

Shërbimet

Sektori i shërbimeve vazhdon të zërë një peshë të rëndësishme në shitjet e ekonomisë. Zëri "Tregti, hotele dhe restorante" ka kontribuar me 10 pikë përqindje në rritjen vjetore të indeksit të përgjithshëm, duke përcaktuar pothuaj tërësisht amplitudën rritëse të tij. Rritja vjetore e shitjeve të këtij sektori është 21.6 për qind, ndërsa në krahasim me tremujorin paraardhës është 7.2 për qind. Gjallërimi i prodhimit të këtij sektori është shoqëruar dhe me një rritje të kontributit të çmimeve të këtij grupi në indeksin e çmimeve të konsumatorit.

Grafik 4. Norma tremujore e ndryshimit të shitjeve në sektorin "Tregti, hotele dhe restorante" (në përqindje).



Burimi: INSTAT, Indeksi i shitjeve.

Industria

Sektori i industrisë, një nga sektorët më të rëndësishëm të ekonomisë shqiptare për nga pesha dhe kontributi në rritje, u rrit me 1.7 për qind gjatë tremujorit të katërt të vitit 2005. Industria nxjerrëse përbën 7.4 për qind peshë në shitjet e sektorit, duke dhënë një kontribut prej 0.5 pikësh përqindjeje në rritjen e tij. Rritjen vjetore të shitjeve të sektorit të industrisë gjithsej e përcaktuan rritjet në shitjet në sektorin e "Industrisë përpunuese". Ky sektor kontribuoi me 3.6 pikë përqindje në rritjen totale të shitjeve të industrisë gjithsej.

	Pesha ndaj totalit	Shitje '05/'04
Industria gjithsej	100	1.7për qind
Industria nxjerrëse	7.4	6.1për qind
Industria përpunuese	67.3	5.3për qind
Energjia elektrike, ujë, gaz	25.3	-7.8për qind

Burimi: INSTAT, Indeksi i shitjeve.

Tabelë 1. Ecuria e shitjeve të sektorit të industrisë për gjashtëmujorin e parë 2005 (në përqindje).

Siç shihet dhe nga grafiku i mëposhtëm, dega e industrisë përpunuese është rritur me ritme më të ulta se një vit më parë, ndërsa industria nxjerrëse ka filluar të shënojë norma vjetore pozitive rritjeje, pasi shënoi rënie 20 për qind në tremujorin e katërt të vitit 2004.



Burimi: INSTAT, Indeksi i shitjeve.

Energjitika

Gjatë dy muajve të parë të këtij viti u regjistrua një rritje vjetore në furnizimin me energji elektrike, në masën 8.4 për qind. Rritja e furnizimit u mbulua kryesisht nga importi, duke qenë se prodhimi në vend i energjisë elektrike shënoi rënie me rreth 11.4 për qind në krahasim me prodhimin e të njëjtës periudhë të një viti më parë. Hidrocentralet mbeten prodhuesit më të mëdhenj në vend, duke mbuluar rreth 98 për qind të prodhimit gjithsej. Importi i energjisë elektrike u rrit ndjeshëm gjatë kësaj periudhe në krahasim me të njëjtën periudhë të një viti më parë. Importi zuri 17.9 për qind të furnizimit gjatë periudhës janar-shkurt 2006.

Humbjet në rrjet rezultuan në rritje, duke regjistruar një nivel prej 19.6 për qind më të lartë sesa në të njëjtën periudhë të një viti më parë. E njëjta situatë paraqitet edhe me humbjet në teknikë, të cilat rezultuan në 27.1 për qind më të larta. Konsumi i faturuar pati një rritje modeste prej 0.4 përqindësh, por shqetësues mbetet fakti se konsumi i pafaturuar është rritur me 139.5 për qind, në krahasim me të njëjtën periudhë të një viti më parë.

Tabelë 2. Bilanci i energjisë elektrike (në GWh).

	Jan-Shk 04	Jan-Shk 05	Jan-Shk 06	Jan-Shk 06/05 në për qind
Energjia nga Prodhimi i Brendshëm	1,023.4	1,110.9	983.7	-11.4
Import	176.1	13.1	209.3	1,494
Shpërndarje	1,124.8	1,077.7	1,168.5	8.4
Humbjet në shpërndarje	481.9	444.3	531.4	19.6
Humbjet teknike	216.3	222.4	282.6	27.1
Konsumimi i faturuar	642.9	633.4	637.0	0.6
Konsumimi i pafaturuar	265.6	221.9	531.5	139.5
Konsumimi i faturuar i familjarëve	405.6	398.1	399.6	0.4
Konsumimi i faturuar i familjarëve në (përqindje)	63.1	62.8	62.7	-0.2

Burimi: KESH.

2.2 TREGU I PUNËS

Në pamundësi të një informacioni[1] më të plotë statistikor mund të konkludohet se tregu i punës ka patur zhvillime të pakta gjatë dy muajve të parë të vitit 2006, ku spikat një rënie e mëtejshme e numrit të të papunëve, të regjistruar nëpër zyrat e punës. Ky fakt mbështetet nga analiza e të dhënave mbi normën e papunësisë deri në fund të muajit shkurt. Kështu, në fund të muajit shkurt numri i të papunëve[2] ra me 1156 vetë në krahasim me fundin e dhjetorit të vitit të kaluar, duke e çuar numrin e të papunëve në 152094 mijë vetë ose 14 për qind të të gjithë forcave të punës[3]. Në krahasim me një vit më parë, norma e papunësisë ka rënë me 2.5 pikë përqindjeje. Përsa i përket strukturës së papunësisë, pjesa më e madhe e tyre përbëhet nga të papunët mbi moshën 35 vjeç dhe arsimimi i tyre nuk e kalon shkollimin tetëvjeçar.

Forca e punës dhe punësimi, gjatë tremujorit të parë zakonisht nuk dallohen për rritje të treguesve të tyre. Reforma në administratën shtetërore dhe në mënyrë të veçantë në ndërmarrjet e mëdha shtetërore, ende të paprivatizuara, mendohet të ketë shkaktuar ulje të treguesve të punësimit në tremujorin e parë të këtij viti (e njëjta dukuri është vërejtur në tremujorin e katërt të vitit 2005). Ndërkohë që pritet që të kemi rritje në sektorin privat jobujqësor. Në përgjithësi, rritja e treguesit të punësimit gjatë viteve të fundit, ka ardhur kryesisht nga rritja e punësimit në këtë sektor. Nga tremujori i parë i vitit 2004 deri në fundin e vitit 2005, ky sektor ka krijuar 9 mijë vende të reja pune. Këtë tremujor, një faktor i rëndësishëm ndihmës për punëzënien në këtë sektor mendohet të jetë ulja e taksave për biznesin e vogël.

Grafik 6. Struktura e papunësisë sipas moshës dhe arsimit.



Punëkërkuesit e papunë sipas moshës

Punëkërkuesit e papunë sipas arsimit

Burimi: Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta.

Tabelë 3. Treguesit e tregut të punës (në mijë vetë).

	2004				2005			
	Tr.I	Tr.II	Tr.III	Tr.IV	Tr.I	Tr.II	Tr.III	Tr.IV
Forcat e punës gjithsej (në mijë)	1080	1081	1080	1074	1087	1086	1086	1086
A. Të punësuar (në mijë)	919	921	922	917	931	931	931.2	932
i) në sektorin shtetëror	179	179	177	171	176	175.6	175.6	175
ii) në sektorin privat jobujqësor	206	208	211	212	213	213.4	214	215
iii) në sektorin privat bujqësor	534	534	534	534	542	542	542	542
B. Papunësia (në mijë)								
i) të papunë gjithsej	161	160	158	157	156	155	154.8	154
ii) përfitojnë pagesë papunësie	11.7	12.3	12	11	11.5	11.5	11.5	11.2
C. Shkalla e papunësisë (në për qind)	14.9	14.8	14.6	14.4	14.3	14.3	14.2	14.2

Burimi: INSTAT, Konjuktura, prill 2006.

Paga mesatare në sektorin shtetëror ka shënuar rritje gjatë gjithë këtyre viteve. Pritjet janë që një rritje e tillë të jetë më e ndjeshme gjatë vitit 2006. Tregues aktualë të këtij fakti janë konfirmimi nga ana e Ministrisë së Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta të rritjes së pagës minimale të miratuar, rritja e pagave të mësuesve dhe kategorive me paga të ulëta, si dhe indeksimi i pensioneve.

2.3 SEKTORI FISKAL

Sipas të dhënave të Ministrisë së Financave, deri në fund të muajit mars, janë mbledhur 106 për qind e të ardhurave të planifikuara dhe është realizuar rreth 87.6 për qind e shpenzimeve të programuara. Kështu bilanci fiskal për tremujorin e parë të vitit rezultoi me rreth 10.3 miliardë lekë suficit, nga 1.1 miliardë lekë të parashikuara. Rritja e të ardhurave buxhetore dëshmon për një hap përpara në rritjen e efikasitetit të administrimit fiskal. Gjatë tremujorit

të parë të vitit u vu re një thyerje e trendit të krijuar gjatë tetë viteve të kaluara, ku bilanci fiskal ka rezultuar në deficit.

Tabelë 4. Ritmet e rritjes së treguesve fiskalë (në përqindje).

	T1-01/00	T1-02/01	T1-03/02	T1-04/03	T1-05/04	T1-06/05
Të ardhura	-24.0	48.5	9.1	16.9	9.8	16.7
Shpenzime	-22.7	47.0	9.8	7.8	8.0	-6.0
- Shpenzime kapitale	-19.9	8.0	-1.6	23.2	7.5	-33.7
Deficiti	-17.4	2.0	4.7	-53.5	-30.0	-829.1

Burimi: Ministria e Financave.

Grafik 7. Treguesit kryesorë fiskalë, janar–shkurt 2006 (në miliardë lekë).



Burimi: Ministria e Financave.

Grafik 8. Struktura e të ardhurave buxhetore për dy muajt e parë të vitit (në milionë lekë).



Burimi: Ministria e Financave.

2.3.1 Të ardhurat buxhetore

Tremujori i parë i vitit 2006 ka shfaqur një rritje të lartë të ritmit të prurjeve fiskale. Të ardhurat në total janë rritur në masën 16.7 për qind në krahasim me të njëjtën periudhë të një viti më parë, duke përfaqësuar një nga nivelet më të larta të rritjes së të ardhurave në vitet e fundit.

Të ardhurat nga akcizat dhe ato nga tatimi mbi të ardhurat personale kanë patur performancën më të mirë të të ardhurave. Ndërkohë, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë, të ardhurat nga pushteti lokal kanë rënë me 13.4 për qind.

Niveli i të ardhurave tatimore, në fund të tremujorit të parë të vitit, arriti në rreth 47.3 miliardë lekë, ndërsa tatimet e mbledhura nga doganat rezultuan rreth 3.4 miliardë lekë, duke realizuar nivelin e parashikuar në projektbuxhetin e fillimvitit respektivisht me 105.6 dhe 112.4 për qind.

Tatimi mbi Vlerën e Shtuar përbën burimin kryesor të të ardhurave tatimore. Ritmi i rritjes së të ardhurave nga TVSH-ja, gjatë tremujorit të parë të vitit është 2.4 pikë përqindje më i lartë se mesatarja e rritjes së këtij treguesi në katër vitet e fundit. Vihet re gjithashtu që në këtë periudhë, përveç të ardhurave nga pushteti lokal, të gjithë treguesit e tjerë të të ardhurave fiskale e kanë tejkaluar planin e parashikuar për këtë periudhë.

	T1 - 03/02	T1 - 04/03	T1 - 05/04	T1 - 06/05	Mesatare 2002-06	Real. Planit T1 - 06
Totali i të ardhurave	9.1	16.9	9.8	16.7	13.1	106.3
Të ardhura tatimore	47.1	13.3	8.8	15.2	21.1	105.6
Tatimi mbi Vlerën e Shtuar	15.7	15.7	7.9	16.3	13.9	106.5
Tatimi mbi fitimin	12.7	11.4	35.1	24.4	20.9	139.4
Akcizat	50.6	17.8	20.4	34.1	30.7	122.1
Tatimi mbi të ardhurat personale	-3.7	22.7	-2.3	23.9	10.1	108.0
Taksa doganore	10.7	-2.7	-4.0	18.0	5.5	112.5
Të ardhura nga pushteti lokal	187.7	41.8	-0.2	-13.4	54.0	79.0
Të ardh. buxh. pavarur (kontribute)	14.8	10.1	11.7	11.5	12.0	100.6
Të ardhura jotatimore	-53.1	93.0	6.1	24.6	17.6	133.8

Burimi: Ministria e Financave.

Tabelë 5. Ritmet e rritjes së të ardhurave gjatë viteve 2002-2005 (në përqindje).

2.3.2 Shpenzimet buxhetore

Shpenzimet buxhetore gjatë tremujorit të parë të këtij viti ishin 42.7 miliardë lekë, duke përbërë rreth 87.6 për qind të nivelit të programuar për këtë periudhë. Për herë të parë në 14 vitet e fundit, shpenzimet në total janë më të ulta se e njëjta periudhë e vitit paraardhës, duke shënuar kështu një rënie vjetore prej 8.9 për qind. Plani i buxhetit për vitin 2006 parashikon një tkurrje të shpenzimeve qeveritare prej 9.5 përqindësh gjatë këtij viti, në krahasim me vitin e kaluar.

Shpenzimet korente, të cilat përbëjnë rreth 92 për qind të shpenzimeve totale, pësuan një rënie prej 6 për qind në krahasim me një vit më parë. Shpenzimet operative të mirëmbajtjes, ato për interesa dhe të pushtetit lokal patën rënien më të lartë në këtë periudhë, duke regjistruar ulje me 30.7, 9.0 dhe 18.2 për qind respektivisht.

Shpenzimet e personelit, të cilat përbëjnë 30.5 për qind të shpezimeve korente dhe 28.2 për qind të shpenzimeve totale, u realizuan në masën 100 për qind. Shpenzimet kapitale të cilat patën një rënie të konsiderueshme gjatë tremujorit të parë të këtij viti, vazhdojnë të jenë poshtë nivelit të planifikuar, duke arritur masën 55.6 për qind të planit. Nga këto të fundit, shpenzimet e mbuluara me financim të brendshëm dhe të huaj u realizuan respektivisht në masën 75.8 dhe 38.7 për qind.

Grafik 9. Struktura e shpenzimeve buxhetore (në përqindje).



Burimi: Ministria e Financave.

Vërehet se shpenzimet për sigurime sociale dhe ato të kontributeve për sigurime shoqërore kanë qenë të vetmet, të cilat kanë patur rritje në shpenzimet korente. Ndërkohë, shpenzimet operative të mirëmbajtjes dhe ato kapitale janë zvogëluar më shumë se treguesit e tjerë të shpenzimeve, duke qenë poshtë nivelit të planifikuar. Shpenzimet kapitale kanë pësuar një tkurrje të konsiderueshme gjatë kësaj periudhe, por sjellja e tyre gjatë viteve paraqitet e çrregullt, duke sugjeruar se ecuria e këtyre shpenzimeve ndikohet mjaft nga ecuria e

projekteve individuale dhe prioritetet qeveritare. Në shpenzimet kapitale vihet re pesha gjithnjë në rritje e financimit të brendshëm kundrejt atij të huaj.

Tabelë 6. Ritmet e rritjes së shpenzimeve gjatë viteve 2002-2005 (në përqindje).

Totali i shpenzimeve	T1 - 03/02	T1 - 04/03	T1 - 05/04	T1 - 06/05	Mesatare 2002-06	Real. Planit T1 - 06
Shpenzime korente	8.6	9.2	7.9	-8.9	4.2	87.6
Personeli	9.8	7.8	8.0	-6.0	4.9	92.5
Paga	11.1	8.9	11.7	-0.2	7.9	100.0
Kontributi për sigurime shoq.	12.1	9.0	11.1	-1.2	7.8	100.2
Interesat	7.6	8.5	13.9	3.5	8.4	99.3
Të brendshme	31.1	4.8	-7.0	-9.0	5.0	93.4
Të huaja	32.7	5.3	-7.0	-10.2	5.2	95.4
Shpenzime op. mirëmbajtje	4.8	-6.2	-5.4	20.3	3.4	67.4
Shpenzime për sig.sociale dhe transferime të tjera	37.6	-6.5	10.2	-30.7	2.7	78.1
Shpenzime kapitale	12.8	-4.0	12.1	5.7	6.7	96.0
Financimi i brendshëm	-1.6	23.2	7.5	-33.7	-1.2	55.6
Financimi i huaj	21.8	28.5	-19.0	5.3	9.1	75.8

Burimi: Ministria e Financave.

2.3.3 Deficiti fiskal

Si pasojë e prurjeve të larta dhe e tkurrjes së shpenzimeve qeveritare gjatë tremujorit të parë të këtij viti, u akumulua një suficit fiskal prej 10.3 miliardë lekësh.

Tabelë 7. Ritmet e rritjes së deficitit gjatë viteve 2002-2005 (në përqindje).

Deficiti	T1 - 03/02	T1 - 04/03	T1 - 05/04	T1 - 06/05	Mesatare 2002-06	Real. Planit T1 - 06
Financim i brendshëm	4.7	-53.5	-30.0	-829.1	-227.0	922.2
Financim i huaj	46.0	-82.6	-148.5	3334.0	787.2	482.1

Burimi: Ministria e Financave.

Huamarrja e qeverisë parashikon një shpërndarje të dukshme asimetrike gjatë vitit 2006. Në projektbuxhetin e vitit 2006, 92.5 për qind e deficitit parashikohet të rezultojë në gjashtëmujorin e dytë të vitit, ndërkohë që në tre vitet paraardhëse në këtë gjashtëmujor është realizuar vetëm 62.3 për qind e peshës së deficitit vjetor.

Tabelë 8. Shpërndarja e deficitit sipas tremujorëve në projektbuxhetet e viteve 2003-'06.

	T1	T2	T3	T4
2003	31.3	20.6	19.8	28.3
2004	7.3	13.9	26.3	46.4
2005	5.1	28.9	34.2	31.8
2006	-6.7	14.2	29.2	63.4

Burimi: Ministria e Financave.

2.4 SEKTORI I JASHTËM I EKONOMISË

Vëllimi i aktivitetit tregtar me botën gjatë muajit janar 2006, arriti në 205.2 milionë euro, duke shënuar një rritje me 26 për qind në krahasim me një

vit më parë. Rritja e transaksioneve tregtare për këtë periudhë ka ardhur si rezultat i rritjes si në eksporte ashtu dhe në importe. Eksportet në muajin janar arritën në rreth 46 milionë euro ose 21 për qind më shumë, në krahasim me të njëjtën periudhë një vit më parë. Importet shënojnë 159 milionë euro, duke u rritur me rreth 28 për qind në krahasim me një vit më parë.Deficiti tregtar për muajin janar shënoi 113.3 milionë euro, duke u thelluar me 31 për qind në terma vjetorë. Faktori kryesor në thellimin e deficitit tregtar ishte rritja e importeve. Në mungesë të informacioneve mbi llogaritë e bilancit të pagesave për këtë periudhë, por duke u mbështetur në ndikimin e madh të bilancit tregtar mbi llogarinë korente mund të presim thellim të deficitit të llogarisë korente për muajin janar.

Grafik 10. Bilanci tregtar (në milionë euro).



Burimi: Banka e Shqipërisë.

2.4.1 Eksportet

Eksportet shqiptare gjatë muajit janar të këtij viti janë dominuar nga grupmallrat tekstile, këpucë, produkte minerale dhe metale bazë, të cilat së bashku zënë 80 për qind të totalit të eksporteve. Eksporti i produkteve minerale ka shënuar një rritje të ndjeshme gjatë këtij muaji. Kështu, pesha e këtij grupmalli kundrejt totalit të eksporteve për muajin janar të këtij viti ishte 13.5 për qind, nga 0.86 për qind një vit më parë. Pesha e eksportit të grupmallrave tekstile, këpucë dhe metale bazë ndaj totalit të eksporteve ka shënuar një rënie me 12 pikë përqindjeje, në krahasim me të njëjtën periudhë të një viti më parë.

Tabelë 9. Struktura e eksporteve dhe importeve (në përqindje).

		Eksport			Import		
		Jan '05	Dhj '05	Jan '06	Jan'05	Dhj'05	Jan'06
1	Kafshët e gjalla; Produktet me origjinë kafshore	0.27	0.32	0.77	3.34	2.31	3.08
2	Produktet vegjetale	3.11	2.99	2.37	9.67	5.63	6.10
3	Vajra dhe yndyra kafshore apo vegjetale	0.00	0.06	0.08	2.20	1.24	2.24
4	Ushqime të përgatitura, pije alkolike e uthull, duhan	3.92	2.59	3.19	6.97	7.20	7.15
5	Produkte minerale	0.86	3.37	13.48	10.88	14.75	19.02
6	Produktet e industrisë kimike apo industrisë së lidhjes	0.82	0.35	0.03	6.39	6.76	6.80
7	Plastikët; gomat dhe artikuj e tyre	0.43	0.66	1.14	3.43	2.63	2.50
8	Lëkurat e përpunuara e të papërpunuara, artikujt e tyre	1.71	1.86	2.09	2.51	2.14	2.38
9	Druri, tapa artikujt e tyre; prodhime kashte, kallama	1.83	1.28	1.31	1.46	1.39	1.01
10	Brumi i drurit, mbetjet e letrës, letra, kartoni artikuj të tyre	1.28	1.62	2.18	1.71	1.55	1.51
11	Tekstile dhe artikujt tekstilë	33.96	27.67	27.61	11.27	9.28	9.77
12	Veshjet e këmbëve, të kokës, çadra,lule artificiale	29.93	29.60	27.35	2.96	2.64	2.52
13	Artikuj prej guri, allçie, çimentoje; qeramike; qelq	0.37	0.44	0.54	5.16	3.68	3.11
14	Perla; gurë e metalet e çmuara; bizhuteri; monedha	0.13	0.13	0.16	0.04	0.04	0.05
15	Metale bazë dhe artikujt prej tyre	14.52	17.40	11.79	8.54	11.01	8.73
16	Makineri e pajisje mekanike, elektrike, pjesët e tyre	4.24	6.58	3.90	13.79	18.63	14.99
17	Mjete transporti, avionë, anije, pajisje shoqëruese transporti	0.14	0.40	0.09	6.29	4.94	6.57
18	Instrumente e aparate optike; orë; instrumente muzikore	0.37	0.07	0.11	1.53	1.48	0.96
19	Armë e municione; pjesët e plotësuesit e tyre	2.02	0.57	0.00	0.03	0.05	0.02
20	Artikuj të ndryshëm të prodhuar	1.92	2.04	1.82	1.86	2.61	1.51
21	Veprat e artit, copat e mbledhura nga antikat	0.00	0.02	0.00	0.0	0.01	0.00
	TOTALI	100	100	100	100	100	100

Burimi: Banka e Shqipërisë.

2.4.2 Importet

Importet e mallrave paraqiten më të diversifikuara në zëra sesa eksportet. Peshën kryesore në importin e mallrave e zënë grupmallrat e produkteve minerale, makineri e pajisje dhe tekstile me përkatësisht 19, 14.9 dhe 9.7 për qind ndaj totalit të importeve. Pesha e importit të produkteve bujqësore ndaj totalit të importeve, në terma vjetorë, ka rënë me rreth 3.6 pikë përqindjeje duke arritur në 18.6 për qind.

Shpërndarja gjeografike e eksporteve dhe importeve.

Eksportet e mallrave shqiptarë edhe gjatë muajit janar të këtij viti, kanë qenë të orientuara kryesisht drejt vendeve të Bashkimit Evropian. Eksportet me këto vende zënë 95 për qind të totalit të eksporteve. Partnerët kryesorë tregtarë të Shqipërisë për eksporte mbeten Italia me 81 për qind dhe Greqia me 9 për qind. Eksportet me vendet e rajonit[4]për këtë muaj përfaqësojnë 4 për qind të totalit të eksporteve. Partnerët kryesorë në rajon për muajin janar ishin Turqia, Kosova dhe Maqedonia.

Importet e mallrave kanë një shtrirje më të gjerë gjeografike në krahasim me eksportet. Megjithatë, vendet e Bashkimit Evropian përsëri zënë peshën kryesore në importe me 61 për qind të totalit të importeve. Italia dhe Greqia mbeten partnerët kryesorë dhe në importet e mallrave, duke zënë përkatësisht 25 dhe 14 për qind të totalit të importeve. Importet me vendet e rajonit përbëjnë 15 për qind të totalit të importeve. Partnerët kryesorë për këtë muaj midis vendeve të rajonit kanë qenë Turqia, Rumania dhe Bullgaria. Partnerët kryesorë në importet me vendet e tjera për këtë muaj ishin Kina, Rusia dhe Ukraina.

Grafik 11. Pesha e importeve dhe eksporteve sipas vendeve (në përqindje).



Burimi: Banka e Shqipërisë.

2.5 ECURIA E INFLACIONIT GJATË TREMUJORIT TË PARË

Inflacioni vjetor, pasi ra në nivelin 2 për qind në muajin dhjetor 2005, ka qëndruar poshtë kufirit të poshtëm të objektivit të Bankës së Shqipërisë gjatë tre muajve të parë të vitit 2006. Norma mesatare vjetore e inflacionit për tremujorin e parë ishte 1.4 për qind, duke shënuar një ulje prej 0.8 pikësh përqindjeje në krahasim me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar. Kjo rënie u ndikua kryesisht nga ngadalësimi i theksuar i rritjes së çmimeve të grupit "Qira, ujë, lëndë djegëse dhe energji". Megjithëse grupi "Ushqime dhe pije joalkolike" ka kontribuar pozitivisht në normën vjetore të inflacionit për muajin mars 2006 (në ndryshim nga kontributi i tij negativ gjatë të njëjtit muaj të vitit të shkuar), presioni i tij në inflacionin total është zbutur nga kontributi në rënie i grupit "Qira, ujë, energji dhe lëndë djegëse".

	2002	2003	2004	2005	2006
Janar	6.5	0.0	3.3	3.3	1.4
Shkurt	7.6	1.1	4.4	1.8	1.3
Mars	7.5	1.3	4.0	1.6	1.5
Prill	6.5	2.3	3.2	1.3	
Maj	4.6	2.8	2.6	2.0	
Qershor	3.7	2.6	2.9	2.9	
Korrik	4.2	3.0	3.1	1.8	
Gusht	5.5	3.0	2.7	2.3	
Shtator	5.3	2.8	2.0	3.1	
Tetor	5.8	2.9	2.0	3.3	
Nëntor	3.7	3.4	2.2	3	
Dhjetor	1.7	3.3	2.2	2.0	
Mesatar	5.2	2.2	3.0	2.4	1.4

Burimi: INSTAT.

Tabelë 10. Norma vjetore e inflacionit (në përqindje).

Indeksi mujor i çmimeve të konsumit është rritur gradualisht gjatë tre muajve të parë të vitit, por me ritme më të ulta se tremujori i parë i vitit 2005. Norma mesatare e inflacionit mujor në tremujorin e parë ishte 0.25 për qind. Kjo normë është përcaktuar nga kontributet negative të grupeve "Transport" dhe "Qira, ujë, energji dhe lëndë djegëse" dhe nga kontributi pozitiv i grupit "Ushqime dhe pije joalkolike". Këto kontribute kanë patur një kah të kundërt gjatë tremujorit të parë të vitit 2005.

Përveç efektit sezonal më të butë, inflacioni i ulët gjatë këtij tremujori ka reflektuar edhe kontributin pozitiv të stabilitetit makroekonomik, mungesën e faktorëve *shock* si dhe presionet e kontrolluara inflacioniste të ardhura nga rritja e çmimeve të naftës.

Grafik 12. Inflacioni vjetor (në përqindje).



Burimi: INSTAT.

Grafik 13. Kontributi i grupeve kryesore në inflacionin vjetor (në pikë përqindjeje).



Burimi: INSTAT.

2.5.1 Ecuria e inflacionit sipas grupeve përbërëse

Në përgjithësi, grupet e ndryshme të shportës së çmimeve të konsumit kanë ruajtur kahun e kontributit të tyre në inflacionin vjetor gjatë tremujorit të parë të vitit 2006, por kanë ndryshuar intensitetin e këtij ndikimi në krahasim me tremujorin e parë të vitit 2005. Përcaktues të normës vjetore të inflacionit kanë qenë ulja në madhësinë e ndikimit të inflacionit të grupit "Qira, ujë, energji dhe lëndë djegëse" e kundërbalancuar disi nga një efekt zbutës më i moderuar i grupit "Ushqime dhe pije alkolike" dhe rritja e kontributit pozitiv që dhanë grupet "Transporti" dhe "Hotele, kafene, dhe restorante".

Çmimet e grupit "Ushqime dhe pije joalkolike", të cilat kanë luhatshmërinë më të theksuar brenda shportës së çmimeve të konsumit, regjistruan ulje të normës mujore gjatë muajve janar dhe shkurt, dhe

rritje në muajin mars. Norma mesatare vjetore e këtij grupi gjatë tremujorit të parë ishte -0.1 për qind, duke kontribuar me -0.04 pikë përqindje në normën mesatare të inflacionit vjetor. Një vit më parë ky kontribut ishte -0.52 pikë përqindjeje. Kontributi pozitiv gjatë marsit, reflektoi edhe rritjen e çmimeve të grupit ushqime në Greqi dhe zbutjen e mbiçmimit të lekut ndaj euros gjatë muajit mars.

Tabelë 11. Inflacioni i grupit "Ushqime dhe pije joalkolike" dhe pesha e tij në inflacionin total.

	Inflacioni vjetor'05	Kontributi (pp)	Inflacioni vjetor'06	Kontributi (pp)	Itali[5] Inflacioni vjetor'06	Greqi[6] Inflacioni vjetor'06
Janar	-0.7	-0.3	-0.4	-0.2	1.1	1.6
Shkurt	-1.2	-0.5	-0.3	-0.1	0.9	2.1
Mars	-1.7	-0.7	0.4	0.2		

Burimi: INSTAT.

Inflacionit vjetor i grupit "Qira, ujë, lëndë djegëse dhe energji" është luhatur rreth vlerës 3.5 për qind gjatë tre muajve të parë të vitit 2006. Inflacioni vjetor prej 3.2 për qind në muajin mars 2006 është norma më e ulët e regjistruar që prej muajit tetor 2003. Duke qenë grupi i dytë për nga pesha që zë në inflacionin total pas grupit "Ushqime dhe pije joalkolike", rritja në indeksin e tij ka drejtuar normat pozitive të inflacionit. Ngadalësimi i normës së rritjes së indeksit të këtij grupi gjatë tremujorit të parë, solli rënien në 0.9 pikë përqindjeje të kontributit mesatar të tij në normën vjetore të inflacionit. Kontributi mesatar vjetor në tremujorin e parë të një viti më parë ka qenë +2.8 pikë përqindje. Në rënien mujore të indeksit të këtij grupi ka ndikuar rënia e çmimeve të qirasë, rentës së imputuar dhe lëndëve djegëse.

Tabelë 12. Inflacioni i grupit "Qira, ujë, lëndë djegëse, energji" dhe pesha e tij në inflacionin total.

	Inflacioni vjetor'05	Kontributi (pp)	Inflacioni vjetor'06	Kontributi (pp)
Janar	15.2	3.6	3.6	0.9
Shkurt	9.8	2.4	3.5	0.9
Mars	9.8	2.4	3.2	0.8

Burimi: INSTAT.

Grafik 14. Inflacioni vjetor i 4 grupeve kryesore të shportës së IÇK-së (në përqindje).



Burimi: INSTAT.

Inflacioni vjetor i grupit "Transport" ka qëndruar në nivele të larta gjatë tre muajve të parë të vitit 2006, megjithë ndryshimet mujore negative të çmimeve të këtij grupi. Rritja vjetore 23 për qind e çmimeve të naftës në tregjet ndërkombëtare gjatë tremujorit të parë dhe nënçmimi i lekut ndaj dollarit gjatë dy tremujorëve të fundit, kanë ndikuar në rritjen e inflacionit vjetor të nëngrupit "Shërbim ndaj mjeteve të transportit", e cila është rritur me 9.6 për qind.

Grupi "Hotele, kafene dhe restorante" ka kontribuar me të njëjtën masë sa një vit më parë në inflacionin mesatar vjetor, gjatë tremujorit të parë të vitit 2006. Inflacioni mujor gjatë tre muajve të parë të vitit ka qenë pothuaj 0, me përjashtim të muajit

mars gjatë të cilit indeksi i këtij grupi u rrit me 0.6 për qind, duke reflektuar kështu rritjen kryesisht të çmimeve të nëngrupit "Kafene dhe restorante".

Grupet e tjera në përgjithësi nuk e kanë ndryshuar krahun e ndikimit në inflacionin total, gjatë tremujorit të parë të këtij viti në krahasim me një vit më parë. Grupet "Veshje dhe këpucë" dhe "Mobilim, pajisje shtëpie dhe mirëmbajtje" kanë kontribuar me -0.1 dhe -0.07 pikë përqindje, kurse grupet e tjera kanë kontribuar pozitivisht.

2.5.2 Ambienti makroekonomik dhe çmimet e konsumit.

Inflacioni i ulët i regjistruar gjatë tremujorit të parë të vitit është përcaktuar nga presioni i ulët i ushtruar mbi çmimet e konsumit nga kërkesa agregate dhe nga mospërcjellja e presioneve të tepërta inflacioniste nga ana e faktorëve të ofertës. Politikat monetare dhe fiskale kanë kontribuar në ruajtjen e stabilitetit makroekonomik, duke transmetuar sinjale neutrale në tendencat inflacioniste të kahut të kërkesës.

Faktorët e kërkesës

- Politika monetare dhe treguesit monetarë.

Politika monetare e ndjekur gjatë tremujorit të parë të vitit 2006, ka ruajtur stabilitetin e faktorit monetar në ecurinë e normës së inflacionit. Ngadalësimi i ritmeve të rritjes së treguesve monetarë dhe ekuilibri i arritur në tregjet financiare janë në përputhje me dinamikën aktuale të presioneve inflacioniste në ekonomi. Ritmi i rritjes së ofertës monetare është ngadalësuar gjatë tremujorit të parë të vitit, ndërkohë që kursi i këmbimit të lekut paraqitet i qëndrueshëm dhe raportet e likuiditetit të ofertës monetare janë përmirësuar. Struktura kohore e normave të interesit të vërejtura në ekonomi, luhatet në intervale minimale dhe të qëndrueshme kundrejt standardeve historike, duke reflektuar edhe pritshmëritë për norma të ulëta inflacioni në periudhën afatmesme.

Grafik 15. Ecuria e kushteve monetare.



Burimi: Banka e Shqipërisë.

- Politika fiskale dhe treguesit fiskalë.

Sjellja e kujdesshme e politikës fiskale gjatë dy muajve të parë të vitit 2006, ka rezultuar me një suficit më të lartë se parashikimi, duke u reflektuar në një kërkesë më të ulët të qeverisë për para. Shpenzimet e përgjithshme të qeverisë gjatë dy muajve të parë të vitit 2006 u realizuan në masën 85 për qind të planit. Nga ana tjetër, të ardhurat e qeverisë gjatë këtyre dy muajve u rritën në masën 104 për qind të planit, duke rezultuar në një suficit të ndjeshëm fiskal.

Grafik 16. Rritja vjetore e shpenzimeve buxhetore.



Burimi: Ministria e Financave.

Politika fiskale dhe treguesit fiskalë do të kenë një kontribut më të ndjeshëm në inflacion gjatë gjysmës së dytë të vitit, kur shpenzimet buxhetore dhe deficiti buxhetor parashikohet të rriten.

- Tregues të tjerë të kërkesës së brendshme.

Indeksi i shitjeve shënoi një rritje vjetore prej 13.5 për qind gjatë tremujorit të katërt të vitit 2005 dhe një rritje 6.4 për qind nga tremujori paraardhës. Treguesit e tjerë, si konsumi i karburanteve dhe disa nga importet, të cilat na japin informacion të kërkesës së brendshme të ekonomisë shqiptare për konsum, tregojnë në përgjithësi për një gjallërim nga tremujori paraardhës, por gjithsesi paraqiten me ulje në terma vjetorë. "Konsumi i energjisë elektrike për popullatën" dhe "Importet e autoveturave gjithsej" janë ulur në tremujorin e fundit 2006, në krahasim me tremujorin e fundit 2005 përkatësisht 14.7 për qind dhe 35 për qind.

Faktorët e ofertës

- Kursi i këmbimit dhe inflacioni i importuar.

Kursi i këmbimit të lekut paraqitet i qëndrueshëm në terma nominalë efektivë, por gjithsesi me një mbiçmim vjetor me 1.0 për qind. Kursi mesatar i këmbimit të lekut ndaj euros shënoi një mbiçmim vjetor prej 2.9 për qind, gjatë tremujorit të parë të vitit 2006. Megjithatë, tendenca mbiçmuese e lekut ndaj euros ka ardhur në rënie krahasuar me tremujorin paraardhës dhe me të njëjtin tremujor një vit më parë (mbiçmimi i lekut për këto periudha ka qenë përkatësisht 3 për qind dhe 4.4 për qind). Kjo dinamikë ka përcjellë më lehtë rritjen e inflacionit të grupit ushqime në Greqi, gjatë dy muajve të fundit të tremujorit të parë 2006 në inflacionin e grupit "Ushqime dhe pije joalkolike".

Nënçmimi i lekut ndaj dollarit, i nisur që nga tremujori i katërt 2005, ka ardhur duke u zbutur në tre muajt e parë të vitit 2006 krahasuar me tremujorin paraardhës, por në terma vjetorë nënçmimi i lekut është pothuaj në të njëjtat nivele (5.7 për qind). Në terma tremujorë, kursi i këmbimit të lekut ndaj dollarit është vlerësuar gjatë tremujorit të parë me 1 për qind, duke ndikuar dhe në reflektimin e pakët të rritjes së çmimeve të naftës në tregjet ndërkombëtare gjatë tremujorit të parë, në çmimet e naftës në tregun e vendit tonë.

Tabelë 13. Inflacioni vjetor i vendeve partnere dhe ndryshimet në kursin e këmbimit (në përqindje) për vitin 2005.

	Nëntor	Dhjetor	Janar	Shkurt	Mars
Greqi[7]	3.5	3.4	3.2	3.2	3.3
Itali[8]	2.2	2	2.2	2.1	
Lek/Euro	-3.7	-3.2	-2.5	-3.3	-2.9
Lek/Usd	5.9	9.5	5.4	5.4	6.4

Burimi: INSTAT, Banka e Shqipërisë.

- Indeksi i çmimeve të prodhimit.

Indeksi i çmimeve të prodhimit ka ardhur në rënie gjatë tremujorit të katërt të vitit 2005, duke shënuar një rritje prej 0.4 për qind në krahasim me tremujorin paraardhës dhe një ndryshim vjetor +1.9 për qind. Ndryshimi vjetor përbën normën më të ulët rritëse të këtij treguesi që nga tremujori i fundit i vitit 2001, duke

mos përbërë shqetësim për presione inflacioniste, si rezultat i rritjes së kostove të prodhimit.

- Çmimi i naftës.

Ecuria e çmimeve të naftës në tregjet ndërkombëtare, në tre muajt e parë të vitit 2006, dëshmon për një presion të jashtëm në rritje. Rritja vjetore e çmimeve të karburantit në tregjet ndërkombëtare, gjatë tremujorit të parë është 23 për qind. Pesha e vogël që zë ky produkt (nëngrupi ku përfshihet çmimi i naftës ka një peshë prej 1.6 për qind në shportën e indeksit të konsumatorit) bën që efekti direkt në inflacion të jetë i kufizuar. Megjithatë, shqetësim mbeten efektet e raundit të dytë, të cilat mund të ndikojnë në inflacion në formën e rritjes së kostove.

- Papunësia dhe pagat.

I parë në këndvështrimin e presioneve të mundshme mbi inflacionin, tregu i punës paraqitet zbutës gjatë tremujorit të katërt të vitit 2005. Rritja me 9.26 për qind e pagës minimale u shoqërua me një rritje 7.9 për qind të pagës mesatare shtetërore. Megjithatë, kjo rritje mbetet në linjë me rritjen e pagave gjatë së njëjtës periudhë të vitit të kaluar. Treguesit e punësimit gjatë tremujorit të katërt 2005 kanë shfaqur të njëjtën ecuri si dhe në tremujorin e parë të vitit të shkuar; norma e papunësisë është ulur me 0.2 pikë përqindje në krahasim me tremujorin paraardhës, gjë që nuk është shoqëruar me të njëjtin ritëm rritjeje të numrit të personave të punësuar. Këto lëvizje kanë rezultuar në një ulje të forcës së aftë për punë për ekonominë në total me 0.2 për qind ose 2 mijë vetë.

Grafik 17. Ndryshimet vjetore të IÇP-së dhe IÇK-së për vitet 2002-2004.



Burimi: INSTAT.

Grafik 18. Ndryshimi vjetor i çmimit të naftës dhe i kursit të këmbimit (në përqindje).



Burimi: INSTAT, Banka e Shqipërisë.

Ecuria e inflacionit gjatë tremujorit të parë të vitit 2006 paraqitet pozitive, duke u favorizuar nga ecuria e kontrolluar e faktorëve të kërkesës dhe impakti i moderuar i faktorëve të ofertës. Perspektiva e inflacionit mbetet përgjithësisht pozitive edhe për periudhën e mbetur të vitit 2006. Megjithatë, rritja e vazhdueshme e çmimeve të naftës dhe rreziqe të tjera nga kahu i ofertës, mbeten faktorë me një ndikim të mundshëm negativ në ecurinë e çmimeve të konsumit.

3. ZHVILLIMET MONETARE DHE TREGJET FINANCIARE

3.1 POLITIKA MONETARE E BANKËS SË SHQIPËRISË

Politika monetare e Bankës së Shqipërisë ka synuar ruajtjen e kushteve monetare në ekonomi të pandryshuara. Qëndrimi neutral i politikës monetare

është kushtëzuar nga ndikimi i ekuilibruar i faktorëve që pritet të influencojnë dinamikën e presioneve inflacioniste në periudhën afatmesme. Normat aktualisht të ulëta të inflacionit, shprehin mungesën e presioneve inflacioniste në kahun e kërkesës. Rritja e kredisë për ekonominë është shoqëruar me tendenca rritjeje të deficitit të llogarisë korente në tremujorët e fundit, kundrejt një ndikimi të kufizuar në inflacion. Nga ana tjetër, rritja e interesave të monedhave të huaja ka sjellë ngushtimin e normave të interesit ndaj monedhës vendase, duke rritur vëmendjen e Bankës së Shqipërisë ndaj implikimeve të mundshme të këtij faktori mbi inflacionin.

Grafik 19. Ecuria e normës bazë të interesit.



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Në këto kushte, politika monetare e Bankës së Shqipërisë është përqëndruar në administrimin e likuiditetit të sistemit, me qëllim ruajtjen e stabilitetit të treguesve të tregut monetar. Kthimi i parasë *cash* në sistem pas rritjes sezonale të saj në fund të vitit të kaluar, ka rezultuar me ritme më të shpejta se parashikimet. Gjithashtu, bilanci fiskal pozitiv i sektorit publik në muajt e parë të vitit ka kushtëzuar huamarrje të ulët të qeverisë nga sistemi bankar. Të dy këta faktorë kanë krijuar kushte për rritjen e shpejtë të likuiditetit të sistemit gjatë tremujorit të parë.

Teprica e likuiditetit të sistemit bankar ka shfaqur tendencë rritjeje drejt nivelit 9.5 miliardë lekë në fund të tremujorit të parë, ndërsa mesatarja tremujore rezulton rreth 5.8 miliardë lekë. Prania e Bankës së Shqipërisë në tregjet e parasë ka synuar tërheqjen e likuiditetit të sistemit nëpërmjet përdorimit të instrumenteve afatgjata dhe afatshkurtra të politikës monetare. Instrumenti kryesor ka qenë marrëveshja e anasjelltë e riblerjes me maturim njëjavor, me çmim fiks dhe shumë të pakufizuar. Njëkohësisht, që prej muajit shkurt, Banka e Shqipërisë ka tërhequr likuiditet me anë të repove me maturim tremujor, ndërsa likuiditeti i investuar nga bankat në repo me afat maturimi njëmujor ka qenë në nivele minimale. Tërheqja e likuiditetit me anë të repove tremujore dhe njëmujore, ka synuar zbutjen e presioneve rënëse të normave të interesit në tregjet e parasë. Gjithashtu, Banka e Shqipërisë ka tërhequr tepricat ditore të likuiditetit nëpërmjet përdorimit të depozitës njëditore.

Paralelisht, Banka e Shqipërisë ka qenë e pranishme në tregun valutor në përputhje me strategjinë e saj për përmbushjen e objektivave sasiorë. Ndërhyrjet në tregun valutor kanë rezultuar në injektimin e rreth 0.8 miliardë lekëve para në qarkullim. Njëkohësisht, prania e Bankës së Shqipërisë në këtë treg ka përmirësuar pozicionin e rezervës valutore për tremujorin e parë, duke kontribuar në rritjen e nivelit të rezervës në rreth 100 milionë usd mbi objektiv. Në kushtet e kontraktimit të bazës monetare, është mundësuar respektimi i objektivit të mjeteve të brendshme neto, ndërsa mungesa e nevojës për financim të deficitit fiskal ka lënë të pandryshuar nivelin e kredisë së brendshme neto për qeverinë.

	Shtator '05	Dhjetor '05	Janar '06	Shkurt '06	Mars '06*	Qersh. '06
Rezervat Ndërkombëtare Neto (milionë dollarë)						
Objektivi	1,1195	1,184	1,162	1,139	1,117	1,112
Aktuale	1,1195	1,184	1,201	1,197	1,222	--
Diferenca	-	-	39	58	105	--
Mjetet e Brendshme Neto (miliardë lekë)						
Objektivi	82	82	83	84	85	90.0
Aktuale	82	77	68	66	61	--
Diferenca	-	- 5	- 15	- 18	- 24	--
Kredia e Brendshme Neto për Qeverinë (miliardë lekë)						
Objektivi	--	306.7	309.1	311.4	313.7	318.7
Aktuale	--	306.7	307.1	306.6	--	--
Diferenca	--	-	- 2.0	- 4.8	--	--

Tabelë 14. Realizimi i objektivave sasiorë të Bankës së Shqipërisë[9].

** Të dhëna operative.*

Burimi: Banka e Shqipërisë.

3.2 OFERTA MONETARE DHE AGREGATËT MONETARË

Trendi i përgjithshëm i agregatëve monetarë ka shprehur ngadalësimin sezonal që karakterizon ofertën monetare dhe përbërësit e saj në fillim të vitit. Megjithatë, në ndryshim nga vitet e mëparshme, tendenca rënëse e ritmeve të rritjeve vjetore ka qenë relativisht më e theksuar, si rezultat i shpërndarjes jolineare të kërkesës për financimin e deficitit fiskal. Ndërsa, faktorët e kërkesës së ekonomisë për mjete monetare dhe pozicioni i jashtëm i sistemit bankar manifestojnë ritme të qëndrueshme rritjeje. Në këto kushte, ritmi i rritjes vjetore të ofertës monetare ka reflektuar trendin e kërkesës së qeverisë për mjete monetare dhe madhësinë e ritmit të mjeteve valutore dhe të kërkesës së ekonomisë. Ritmi i rritjes vjetore të ofertës monetare është ngadalësuar në 11.6 për qind në muajin shkurt, kundrejt 14.0 për qind në fund të vitit 2005. Ndërsa në vlerë absolute, gjatë periudhës janar-shkurt, agregati M3 është rritur vetëm me 2.2 miliardë lekë. Ritmi i ulët i rritjes mujore të ofertës monetare është kryesisht rezultat i efekteve me kah të kundërt të faktorëve të kërkesës.

Grafik 20. Ecuria e normave vjetore të treguesve monetarë.



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Struktura valutore dhe ajo kohore e ofertës monetare kanë ruajtur trendin historik të vërejtur në vitet e fundit. Përbërësi valutor i ofertës monetare ka vazhduar të rritet me ritëm më të shpejtë në raport me përbërësin në lekë të ofertës monetare. Niveli i depozitave në valutë në muajin shkurt rezulton 157.8 miliardë lekë. Rritja vjetore e këtij treguesi rezulton 25.7 për qind. Raporti i depozitave në valutë ndaj M3 në muajin shkurt u rrit në 27.2 për qind nga 24.1 për qind, në muajin shkurt të një viti më parë.

Burimi kryesor i rritjes së depozitave në valutë janë prurjet valutore nga jashtë, ndërsa burimet financiare të krijuara në monedhën vendase nga

Grafik 21. Ecuria e raportit të depozitave në valutë ndaj M3.



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Grafik 22. Struktura kohore e depozitave në valutë dhe norma bazë e interesit të usd.



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Grafik 23. Raporti i parasë jashtë bankave ndaj M2 dhe norma reale mesatare e interesit[11].



Burimi: Banka e Shqipërisë.

kërkesa e qeverisë dhe e ekonomisë, vazhdojnë të investohen në formën e depozitave në lekë. Gjithashtu, një burim shtesë të krijimit të depozitave në valutë përbën qarkullimi i aseteve valutore të sistemit bankar në ekonominë shqiptare, nëpërmjet financimit që i bëhet sektorit privat të ekonomisë. Ritmet e larta të kreditimit në valutë të ekonomisë nga sektori bankar shtojnë, krahas prurjeve valutore, ofertën valutore në treg dhe çojnë në investimin e tepricave valutore në sistemin bankar.

Struktura kohore e depozitave në valutë ka reaguar ndaj ndryshimeve të normave të interesit të monedhave të huaja. Raporti i depozitave me afat në valutë ndaj depozitave pa afat në valutë në muajin shkurt arriti në 212 për qind, kundrejt 170 për qind në muajin shkurt të një viti më parë. Ecuria e tij ka ecur kryesisht në linjë me shtrëngimin e politikës monetare të Fed nëpërmjet rritjes së normës bazë të interesit të monedhës usd[10]. Në muajin qershor të vitit 2004, kur filloi rritja e normës së interesit të monedhës usd, raporti i depozitave me afat në valutë ndaj depozitave pa afat në valutë ishte 142 për qind ose rreth 70 pikë përqindje më i ulët se raporti aktual.

Tendenca e zhvendosjes së strukturës kohore të ofertës monetare në lekë drejt mjeteve më pak likuide ka vazhduar gjatë tremujorit të parë të vitit, pas një rritjeje sezonale në muajin dhjetor. Raporti i parasë jashtë bankave ndaj M2 në muajin shkurt rezultoi 32.9 për qind ose 0.5 pikë përqindje më pak se në të njëjtën periudhë të një viti më parë. Kjo ecuri është në përputhje me tendencën historike të viteve të fundit dhe ndikon pozitivisht në perspektivën e normës së inflacionit në ekonomi. Në raport ndaj agregatit M3, paraja jashtë bankave në muajin shkurt rezulton 24.0 për qind, kundrejt 25.4 për qind në muajin shkurt të një viti më parë. Zhvendosja e strukturës kohore të M2 drejt depozitave, i ka lejuar politikës monetare uljen e normave reale të interesit në ekonomi në sajë të normave më të ulëta të normës së inflacionit. Ruajtja e ekuilibrave makroekonomikë në kushtet e normave më të ulëta të normës reale të interesit, përbën një zhvillim pozitiv për ekonominë. Zhvendosja e strukturës kohore drejt mjeteve më pak likuide redukton presionet inflacioniste. Në këtë mënyrë, ruajtja e trendit rënës të këtij raporti mundëson rritjen e ekonomisë pa cënuar objektivin e inflacionit.

	Shkurt	Ndryshimi 2-mujor		Ndryshimi vjetor	
	2005	Absolut	Përqindje	Absolut	Përqindje
Para jashtë bankave	139.1	-10.6	-7.1	7.1	5.4
Depozita totale	441.1	12.8	3.0	53.2	13.7
- në lekë	283.4	6.9	2.5	20.9	7.9
- në valutë	157.8	5.9	3.9	32.3	25.7
Depozita pa afat	130.7	1.2	0.9	44.9	52.4
- në lekë	80.0	2.0	2.6	40.6	103.1
- në valutë	50.6	-0.8	-1.6	4.3	9.2
Depozita me afat	310.4	11.5	3.9	8.3	2.7
- në lekë	203.3	4.9	2.4	-19.8	-8.9
- në valutë	107.1	6.7	6.7	28.0	35.4
M1	219.2	-8.5	-3.7	47.7	27.8
M2	422.5	-3.7	-0.9	27.9	7.1
M3	580.2	2.2	0.4	60.2	11.6
Baza monetare	188.9	-9.3	-4.7	14.5	8.3

Burimi: Banka e Shqipërisë.

Tabelë 15. Treguesit monetarë për periudhën janar-shkurt (në miliardë lekë).

3.3 KËRKESA PËR MJETE MONETARE

Ecuria e treguesve monetarë për periudhën janar – shkurt, ka ruajtur të njëjtat karakteristika sikurse edhe në vitin 2005. Kreditimi i ekonomisë përbën nxitësin kryesor të ekspansionit monetar, ndërkohë që kërkesa e ulët e qeverisë për para ka frenuar rritjen e agregatit M3.

Tabelë 16. Ecuria e disa treguesve kryesorë.

	2002	2003	2004	T1 '05	T2 '05	T3 '05	T4 '05	Shkurt '06
Oferta e parasë (në miliardë lekë)	416.7	448.4	507.2	521.6	541.8	566.2	578.0	580.2
Mjetet valutore neto (në % ndaj M3)	38.9	35.7	36.9	37.5	36.4	37.5	36.1	37.1
Kredi e brendshme (në % ndaj M3)	70.8	71.5	68.9	68.7	69.9	69.1	70.0	70.4
- Kredi për qeverinë (në % ndaj M3)	61.5	60.2	55.1	53.4	52.2	50.3	48.9	48.1
- Kredi për ekonominë (në % ndaj M3)	9.3	11.3	13.8	15.3	17.7	18.7	21.1	22.2
Kredi për ekonominë (% ndaj totalit të aktiveve)	11.5	13.7	16.9	17.9	20.8	22.2	25.1	25.6
Kredi për ekonominë (në % ndaj PBB)	5.7	6.8	8.4	9.5	11.5	12.7	14.6	15.2
Depozita gjithsej (në % ndaj PBB)	42.2	43.4	44.1	46.9	48.5	50.7	51.2	52.0
Raporti kredi/depozita (në %)	13.5	15.7	19.0	20.3	23.6	25.0	28.5	29.2

Burimi: Banka e Shqipërisë.

Në terma vjetorë kontributi i qeverisë në fund të shkurtit 2006 paraqitet negativ, ndërkohë që kontributi i kërkesës së ekonomisë në rritjen e kërkesës për para ka arritur vlera maksimale, në 88 për qind. Rritja e mjeteve valutore të sistemit, si një burim i rritjes së parasë paraqet një kontribut të qëndrueshëm me atë të fundvitit 2005.

Grafik 24. Ecuria e kontributit të përbërësve të kërkesës për para.



Burimi: Banka e Shqipërisë.

3.3.1 Kredia për ekonominë

Ecuria e kredisë në periudhën janar - shkurt të vitit 2006 ka ruajtur tendencën rritëse të dëshmuar gjatë vitit 2005. Teprica e kredisë është rritur me 7 miliardë lekë ose me një normë vjetore mesatarisht 71.4 për qind nga 74.3 për qind në fundin e vitit



Grafik 25. Raporti i kredisë ndaj PBB (shkalla majtas), norma vjetore e rritjes së kredisë dhe kontributi vjetor ndaj rritjes së M3 (shkalla djathtas).

Burimi: Banka e Shqipërisë.



Grafik 26. Normat vjetore të rritjes së kredisë sipas monedhës.

Burimi: Banka e Shqipërisë.

2005. Ndërkohë, në terma realë kredia shënoi për dy muajt e parë një rritje mesatare prej 69 për qind. Gjatë kësaj periudhe janë akorduar gjithsej 18 miliardë lekë kredi e re ose 31 për qind më e lartë se kredia e dhënë për të njëjtën periudhë një vit më parë. Në fund të muajit shkurt 2006, kredia për ekonominë përbënte 22.2 për qind të M3 dhe 15.2 për qind të PBB-së së parashikuar për vitin 2006.

Nga ana tjetër, rritje të mëtejshme kanë pasqyruar edhe treguesit e ndërmjetësit bankar. Raporti i kredisë ndaj aktiveve totale të sistemit bankar arriti në 25.6 për qind, ndërsa ndaj totalit të depozitave në 29.2 për qind.

Krahasuar me një vit më parë bie në sy interesimi në rritje i bankave për kreditimin në lek. Kredia në lekë gjatë muajve janar dhe shkurt është mesatarisht 121 për qind më e lartë sesa një vit më parë. Rritja e kreditimit në lek duket të jetë ndikuar njësoj si nga rritja e kredisë për individët ashtu edhe për bizneset.

Megjithë, zhvillimet pozitive në segmentin e kredisë në lek, portofoli i bankave dominohet nga kredia në valutë. Për periudhën janar- shkurt kredia në valutë shënoi një normë vjetore rritjeje mesatare prej 59 për qind.

Raporti i kredisë afatshkurtër ndaj totalit të kredisë ka ruajtur një tendencë zbritëse, në dy muajt e parë të vitit 2006. Ndryshimet në strukturën kohore të kredisë së re (në 44.2 për qind të totalit të kredisë nga 53.2 për qind një vit më parë) tregojnë për një angazhim në rënie të bankave në kredi afatshkurtra. Nga ana tjetër, vihet re që kredia me afat maturimi mbi 5 vjet vazhdon trendin e saj rritës duke dëshmuar në fund të muajit shkurt, një rritje të konsiderueshme në 38 për qind të portofolit të kredisë.

Tabelë 17. Tregues të tepricës së kredisë në përqindje ndaj totalit (në përqindje).

			2005				2006	
	2002	2003	T-1	T-2	T3	Dhjetor	Janar	Shkurt
Teprica e kredisë (në mld lekë)	50.7	69.3	79.0	95.9	106.0	121.9	124.8	128.5
Kredi afatshkurtër	46.0	34.0	34.1	33.7	31.6	32.8	32.5	31.9
Kredi afatmesme	33.3	36.0	34.5	33.1	31.2	30.3	30.0	30.3
Kredi afatgjatë	20.7	30.0	31.4	33.1	36.9	37.0	37.5	37.8
Kredi për individët	24.5	30.6	31.0	30.8	31.4	31.6	31.5	31.7
Kredi për sektorin privat	75.5	69.4	69.0	69.2	68.6	68.4	68.5	68.3
Lekë	19.6	19.5	20.1	22.9	23.7	25.5	25.4	25.7
Valutë	80.4	80.5	79.9	77.1	76.3	74.5	74.6	74.3

Burimi: Banka e Shqipërisë.

Kreditimi i degëve të ekonomisë kryesisht ka ruajtur të njëjtën shpërndarje si dhe në fund të vitit 2005. Sektori i tregtisë mbetet dega më e kredituar me 18.7 për qind të portofolit të kredisë edhe pse ka shfaqur një rënie të moderuar krahasuar me fundin e vitit 2005. Po kështu, një rënie të lehtë ka shënuar dhe portofoli për bujqësinë dhe pasuri të paluajtshme.

Ndërkohë, kredia për sektorët prodhues të ekonomisë ka pasqyruar rritjen më të ndjeshme, duke arritur në 14.3 për qind. Kredia për sektorin e ndërtimit ka mbetur në të njëjtat nivele me fundin e vitit 2005, në 13 për qind të portofolit të kredisë.

Grafik 27. Ecuria e normave vjetore të rritjes së kredisë sipas monedhës dhe subjektit.



Burimi: Banka e Shqipërisë.

	2002	2003	2004	T1 '05	T2 '05	T3 '05	T-4 '05	Shkurt '06
Bujqësia, gjuetia dhe silvikultura	0.8	1	1.5	1.5	1.5	2.4	2.7	2.3
Industria përpunuese	17	17	17.1	16.7	15.6	13.9	13.8	14.3
Ndërtimi	8.6	10	9.8	11.2	11.2	12.8	13.0	12.9
Tregtia, riparimi i automobilave dhe artikujve shtëpiakë	40.0	34	23.3	20.6	19.1	20.0	18.9	18.7
Hotele dhe restorante	6.0	6	8.3	5.2	4.7	4.4	4.2	4.2
Pasuritë e patundshme	9.1	13	9.8	14.7	13.5	13.9	14.2	13.9
Të tjera	18.1	19	30.2	30.1	34.3	32.6	33.2	33.7
Totali	100	100	100	100	100	100	100	100

Tabelë 18. Teprica e kredisë sipas degëve të ekonomisë (në përqindje).

Burimi: Banka e Shqipërisë.

3.3.2 Mjetet valutore neto

Niveli i mjeteve valutore neto të sistemit bankar ka njohur rritje përgjatë dy muajve të parë të vitit. Rritja e këtyre mjeteve për këtë periudhë llogaritet 74.4 milionë usd, e ndikuar pozitivisht nga mjetet valutore neto të Bankës së Shqipërisë dhe të bankave tregtare, përkatësisht me 25.1 milionë usd dhe 49.3 milionë usd. Hyrjet valutore si rezultat i disbursimeve nga institucionet e huaja, të shoqëruara me efektin e mbiçmimit të euros kundrejt dollarit kanë ndikuar në rritjen e rezervës valutore të Bankës së Shqipërisë. Mjetet valutore të bankave tregtare janë ndikuar nga ritmet më të larta të rritjes së depozitave në valutë se ritmet e rritjes së kredisë në valutë. Gjithashtu, gjatë dy muajve të parë të vitit është vënë re dhe ulje e detyrimeve valutore të bankave tregtare, kryesisht në zërin depozita pa afat të jorezidentëve, duke ndikuar në rritjen e mjeteve valutore neto të këtyre bankave.

Grafik 28. Mjetet valutore neto të sistemit bankar.



Burimi: Banka e Shqipërisë.

3.3.3 Kërkesa e qeverisë për mjete monetare

Qeveria ka prezantuar një bilanc fiskal pozitiv për dy muajt e parë të vitit. Suficiti buxhetor ka ardhur në rritje nga njëri muaj në tjetrin, duke shënuar nivelin 3.7 miliardë lekë në muajin shkurt. Kjo sjellje e qeverisë ka ndikuar në një kërkesë të ulët për financim të brendshëm. Huamarrja e brendshme bruto në muajin shkurt arriti në nivelin 5.7 miliardë lekë, duke shënuar një rritje të lehtë krahasuar me një muaj më parë. Kjo huamarrje është mbuluar nga emetimi i obligacioneve qeveritare dy dhe trevjeçare, si dhe nga emetimi i bonove të thesarit. Niveli i obligacioneve dy dhe trevjeçare për këtë periudhë u rrit përkatësisht me 3.5 miliardë lekë dhe 1.9 miliardë lekë, ndërsa niveli i bonove të thesarit të blera në tregun primar arriti në 0.3 miliardë lekë. Rritja e portofolit të individëve, të Bankës së Shqipërisë dhe të institucioneve me përkatësisht 2.4, 1.7 dhe 0.6 miliardë lekë ka kompensuar uljen e portofolit të bankave tregtare me 4.7 miliardë lekë.

Grafik 29. Ecuria kumulative e financimit të deficitit buxhetor (në miliardë lekë).



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Në llogaritë e qeverisë për muajin shkurt vihet re se qeveria ka dhënë likuiditet për bankat tregtare në formën e repos së anasjelltë, në masën 1.8 miliardë lekë dhe ka kaluar një shumë prej 1.7 miliardë lekësh si kapitalizim i Bankës Kombëtare Tregtare. Gjithashtu, qeveria kishte një depozitë prej 5.9 miliardë lekësh në fund të muajit shkurt. Financimi i brendshëm për vitin 2006 është parashikuar të jetë në nivelin 26.8 miliardë lekë. Niveli i ulët i financimit të brendshëm në fillim të vitit nënkupton përqëndrimin e tij në pjesën e dytë të vitit, duke zhvendosur për këtë periudhë dhe kërkesën për mjete monetare nga ana e qeverisë.

Grafik 30. Ecuria e normave të interesit në tregje, në përqindje.



Burimi: Banka e Shqipërisë.

3.4 TREGU I PARASË, NORMAT E INTERESIT DHE KURSI I KËMBIMIT

Tregu i parasë ka operuar në kushtet e rritjes së tepricës së likuiditetit në sistemin bankar, gjatë tremujorit të parë të vitit 2006. Ndryshe nga një tremujor më parë, kur sistemi bankar tregoi raste të mungesës së likuiditetit, ky tregues është rritur si pasojë e kthimit të depozitave në sistem dhe uljes së kërkesës së qeverisë për financim nga sistemi bankar, një prirje normale për këtë periudhë të vitit. Rritja e likuiditetit ka ushtruar presion për rënien e vazhdueshme të normave të interesit në lekë, që tentuan të korrigjojnë rritjen që pësuan në mes të vitit të kaluar.

Ankandet e repove kanë qenë mjetet kryesore për investimin e tepricës së likuiditetit. Krahas ankandeve të rregullta njëjavore të repove me çmim

të përcaktuar (5.00 për qind), Banka e Shqipërisë ka ofruar dhe ankande me maturitet njëmujor dhe tremujor të repove me shumë çmime. Norma e interesit për to ka rezultuar përkatësisht 5.24 për qind dhe 5.28 për qind.

Aktiviteti huadhënës në tregun ndërbankar ka treguar rritje të ndjeshme krahasuar me vitin e kaluar. Niveli mesatar ditor i huadhënies, në tremujorin e parë të vitit 2006 është rritur në 1.85 miliardë lekë, nga 1.54 miliardë lekë në tremujorin e kaluar dhe 0.98 miliardë lekë një vit më parë. Ndryshe nga viti i kaluar, pjesa më e madhe e huadhënies përbëhet nga huadhënia me afat 7-ditor, vëllimi mesatar ditor i të cilës arriti në 1.02 miliardë lekë nga 0.36 miliardë lekë në tremujorin e parë 2005.Tregu ndërbankar, si tregu që reflekton më shpejt sinjalet e politikës monetare, gjatë tremujorit të parë të vitit 2006 ka vijuar të luhatet pranë normës bazë të interesit, në varësi të ndryshimit të raporteve kërkesë/ofertë në këtë treg.

Grafik 31. Niveli i likuiditetit dhe huamarrja në tregun ndërbankar (në miliardë lekë).



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Grafik 32. Ecuria e normave të interesit në treg ndërbankar.



Burimi: Banka e Shqipërisë dhe bankat e nivelit të dytë.

Normat e interesit janë rritur përkohësisht në periudhat e llogaritjes së rezervës së detyruar, si rezultat i rritjes së kërkesës për huamarrje në treg ndërbankar në këtë kohë. Sidoqoftë, kufiri i ri simetrik i interesave të lehtësive mbështetëse e ka ngushtuar diferencën midis interesave të huamarrjeve njëditore dhe shtatëditore. Gjatë tremujorit të parë 2006, interesat e huamarrjeve njëditore në treg ndërbankar janë luhatur rreth nivelit 4.5 për qind ndërsa ato për huamarrjet shtatëditore, rreth nivelit 5.4 për qind. Në krahasim me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar, interesi mesatar i huamarrjes njëditore është rritur dukshëm (nga 2.8 për qind në 4.5 për qind), kryesisht, për shkak të ndryshimit të korridorit të interesave. Në tregun primar, likuiditeti i ofruar për blerjen e letrave me vlerë të qeverisë ka rezultuar në të gjitha rastet më i lartë sesa shuma e emetuar (mesatarisht në një raport 1.2:1). Ky faktor, si dhe pritshmëritë për inflacionin dhe normat e interesit, kanë ndikuar në uljen e mëtejshme të *yield*-eve. Gjatë tremujorit të parë 2006, *yield*-i i bonove të thesarit, jo vetëm është kthyer në nivelet e mëparshme të periudhës parazgjedhore, por madje ka prekur nivelet më të ulëta historike. Kështu, *yield*-i i bonove të thesarit tremujor, i arriti nivelet më të ulta historike në muajin shkurt 2006 (4.86 për qind), ndërsa *yield*-et e bonove të thesarit gjashtë dhe dymbëdhjetë mujore i arritën këto nivele në fund të tremujorit të parë 2006 (përkatësisht 5.86 për qind dhe 6.11 për qind). Në tregun e obligacioneve qeveritare dyvjeçare dhe trevjeçare, normat e interesit zbritën në nivelet më të ulta historike, përkatësisht në 7.0 për qind dhe 7.5 për qind[12]. Rënia e *yield*-eve të letrave me vlerë të qeverisë ka ulur koston e borxhit të brendshëm të saj.

Në tregun e depozitave në lekë, tendenca e mëparshme rritëse e interesave ka nisur kthesën rënëse, e cila është më e dukshme në interesat afatgjatë, ndërsa në terma afatshkurtër, bankat kanë qenë ende të interesuara për rritjen e depozitave.

Tabelë 19. Normat e interesit dhe ndryshimi i tyre në tregun e depozitave në lekë (në përqindje)

	Shtator-05	Dhjetor-05	Ndryshimi 3-mujor	Shkurt-06	Ndryshimi 2-mujor
Depozita 3-mujore	3.87	4.07	0.20	4.28	0.21
Depozita 6-mujore	4.55	4.77	0.22	4.71	-0.06
Depozita 12-mujore	5.28	5.57	0.29	5.34	-0.23
Depozita 24-mujore	6.62	6.82	0.20	6.37	-0.45

Burimi: Banka e Shqipërisë.

Në kushtet e inflacionit të ulët, interesat realë janë rritur dhe janë afruar me ata nominalë. Sipas të dhënave më të fundit të muajit shkurt 2006, interesat realë të depozitave me afat 12-mujor në lekë, në krahasim me një vit më parë, janë rritur nga 3.88 për qind në 3.99 për qind.

Tregu i kredive në lekë, në dy muajt e parë të vitit 2006, është karakterizuar nga përafrimi dhe luhatja e normave të interesit brenda kufijve relativisht të ngushtë (12.3 – 13.8 për qind), me përjashtim të kredisë me afat 1-3-vjeçar, e cila luhatet rreth nivelit 18.0 për qind.

Grafik 33. Ecuria e interesit mesatar të ponderuar të kredive në lekë.



Burimi: Banka e Shqipërisë dhe bankat e nivelit të dytë.

Gjatë dy muajve të parë të vitit 2006, normat e interesit të kredive në lekë janë rritur në të gjitha afatet, me përjashtim të interesave të kredive me afat nga 1 në 3 vjet, të cilat u ulën me 0.04 pikë përqindjeje.

Me gjithë rritjen e interesave të kredive në lekë, në një nivel mesatar prej 0.9 për qind, vërejmë se nuk kanë munguar dhe rastet e uljes së tyre, nga banka të veçanta, në të gjitha llojet e kredive. Luhatjet e normave të interesit janë ndikuar nga faktorë si, ndryshimi i peshës së bankave në kredidhënie dhe ndryshimi i politikave të bankave në drejtim të kredidhënies.

Në dy muajt e parë të vitit 2006, në tregun e depozitave në dollarë, ka patur rritje vetëm në interesat 1, 3 dhe 6-mujorë, ndonëse politika monetare e Rezervës Federale ka qenë shtrënguese dhe interesat libor kanë vazhduar të rriten.

Tabelë 20. Normat e interesit në tregun e depozitave në valutë dhe ndryshimi i tyre (në përqindje).

	Shtator-05	Dhjetor-05	Ndryshimi 3 mujor	Shkurt-06*	Ndryshimi 2 mujor
Usd					
Depozita 3-mujore	2.32	2.81	0.49	2.87	0.06
Depozita 6-mujore	2.55	2.99	0.44	3.06	0.07
Depozita 12-mujore	3.02	3.56	0.54	3.35	-0.21

Depozita 24-mujore	3.18	4.15	0.97	3.93	-0.22
Euro					
Depozita 3-mujore	1.79	2.01	0.22	2.19	0.18
Depozita 6-mujore	1.91	2.20	0.29	2.30	0.10
Depozita 12-mujore	2.09	2.49	0.40	2.66	0.17
Depozita 24-mujore	3.53	3.27	-0.26	2.84	-0.43

**Të dhënat më të fundit i përkasin muajit shkurt 2006.*
Burimi: Banka e Shqipërisë dhe bankat e nivelit të dytë.

Pas një tendence të fortë dhe të vazhdueshme rritëse që kishte nisur që në mars 2004, në depozitat afatgjata në dollarë po shfaqen ulje të normave të interesit. Krahas faktorëve të tjerë, këtu ka ndikuar dhe rritja e ndjeshme e depozitave me afat dhe ulja e depozitave pa afat në usd.

Ndërkohë, interesat e depozitave me afat në euro, kanë vazhduar trendin e tyre rritës në të gjitha afatet, me përjashtim të atyre dyvjeçare. Këtu ka ndikuar politika monetare shtrënguese e Bankës Qendrore Evropiane dhe rritja e interesave euribor në tregjet ndërkombëtare, ndërkohë që në uljen e interesave dyvjeçarë ka ndikuar rritja e ndjeshme e depozitave me afat në euro.

Spread–i i interesave të depozitave lekë-valutë ka vazhduar të ngushtohet edhe në dy muajt e parë të vitit 2006. Megjithatë, ende nuk janë arritur nivelet e ulëta të muajit qershor 2005, pasi, në dy muajt e parë të vitit 2006, ka patur tendenca rënëse si në depozitat në lekë dhe në ato në dollarë.

Në muajin shkurt 2006 *spread*-i i interesave me afat 12-mujor lekë-usd arriti në 1.99 për qind nga 2.01 për qind në fund të vitit të kaluar; ai lekë-euro arriti në 2.68 për qind nga 3.08 për qind.

Tregu i kredive në valutë gjatë dy muajve të parë të vitit 2006, është karakterizuar nga një tendencë rritëse, në të gjitha llojet e kredive, me përjashtim të interesave të kredive me afat mbi tre vjet në euro, të cilat janë ulur. Në ecurinë e interesave të kredive në valutë ka ndikuar rritja e interesave libor dhe euribor në tregjet ndërkombëtare, rritja e interesave të depozitave në valutë, ndryshimi i strukturës së kredidhënies nga njëri muaj në tjetrin, shkalla e rrezikut të kredidhënies, politikat që ndjekin bankat për kredidhënien në valutë etj.. Sidoqoftë, në këtë treg vërejmë përafrim të interesave të kredive me afate të ndryshme dhe luhatje të tyre brenda kufijve më të ngushtë se më parë (7-9 për qind për kreditë në euro dhe 8.5 -10.5 për qind, për kreditë në usd), të cilat janë tregues të stabilitetit në këtë treg dhe të rritjes së konkurrencës.

Grafik 34. *Spread*-i midis interesave të depozitave në lekë me ato në valutë.



Burimi: Banka e Shqipërisë dhe bankat e nivelit të dytë.

Kursi i këmbimit

Leku ka ruajtur një ecuri relativisht të qëndrueshme kundrejt dy valutave kryesore, përgjatë tremujorit të parë të vitit 2006. Forcimi i pozitave të

Grafik 35. Ecuria e kursit nominal efektiv (NEER[13]).



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Grafik 36. Ndryshimi vjetor i kursit mesatar të këmbimit të lekut*.



Burimi: Banka e Shqipërisë.
* Ndryshimi negativ do të thotë mbiçmim.

euros kundrejt dollarit në tregun ndërkombëtar është pasqyruar dhe në sjelljen e lekut gjatë kësaj periudhe. Krahasuar me fundin e vitit, leku është mbiçmuar ndaj dollarit me 2.0 për qind dhe është nënçmuar kundrejt euros me 0.2 për qind.

Rritjet e normave të interesit në tregun ndërkombëtar kanë ngushtuar më tej diferencën ndërmjet normave të interesave në lekë dhe interesave në valutë, duke zbehur mbështetjen për lekun. Gjithsesi, normat e ulëta të inflacionit të vërejtura sidomos gjatë këtij tremujori, kanë mbajtur në nivele pozitive normat reale të interesit në lekë duke ruajtur kërkesën për lekë. Nga ana tjetër, tremujori i parë i vitit paraqet një situatë të qetë në aktivitetin e jashtëm tregtar, duke mos krijuar presione të forta në tregun valutor. Situata e qëndrueshme në tregun e brendshëm valutor ka bërë që këmbimi i lekut në tremujorin e parë të reflektojë më së shumti zhvillimet valutore të tregut ndërkombëtar.

Në terma vjetorë leku ka vazhduar të ruajë tendencën mbiçmuese kundrejt valutës euro, tendencë e vënë re që nga mesi i vitit 2003. Leku kundrejt dollarit ka vazhduar të jetë i mbiçmuar edhe për muajin mars duke ruajtur këtë tendencë të vërejtur që nga muaji tetor i vitit të kaluar. Nënçmimi vjetor i lekut kundrejt dollarit llogaritet rreth 6.41 për qind për muajin mars, ndërsa mbiçmimi vjetor kundrejt euros rreth 2.94 për qind. Në terma nominalë efektivë leku paraqitet i qëndrueshëm por gjithësesi me një mbiçmim vjetor me 1.0 për qind. Në fund të muajit mars, nivelet e këmbimit të lekut janë 122.95 lek/euro dhe 101.53 lek/usd.

SHËNIME

[1] Ende nuk ka të dhëna zyrtare për forcën e punës dhe nivelin e punësimit në vend, informacion që do të bënte më të plotë analizën mbi tregun e punës.

[2] Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta.

[3] Forca e punës është marrë nga të dhënat e fundit të dhjetorit 2005.

[4] Në vendet e rajonit përfshihen: Kosova, Serbia dhe Mali i Zi , Maqedonia, Kroacia, Bosnje-Herzegovina, Bullgaria, Rumania dhe Turqia.

[5] Burimi: ISTAT; faqja e internetit http://www.istat.it

[6] Burimi: Sekretariati i Përgjithshëm i Shërbimit Statistikor Kombëtar i Greqisë; faqja e internetit: http://www.statistics.gr

[7] Burimi: Sekretariati i Përgjithshëm i Shërbimit Statistikor Kombëtar i Greqisë; faqja e internetit: http://www.statistics.gr

[8] Burimi: ISTAT; faqja e internetit http://www.istat.it

[9] Tabela përfshin kuadrin e ri të objektivave sasiorë të përfshirë në marrëveshjen e re me FMN, nënshkruar në muajin shkurt 2006. Viti 2005 përbën bazën e përcaktimit të flukseve të objektivave sasiorë për tre vitet që mbulon kjo marrëveshje.

[10] FED: Autoriteti monetar i cili ka përgjegjësitë dhe kryen funksionet e një banke qendrore në SHBA (Federal Reserve Bank).

[11] Norma e ponderuar e interesit të pranimit të depozitave të sistemit e skontuar ndaj normës së inflacionit.

[12] Në fillim të muajit prill 2006, sipas të dhënave më të fundit.

[13] NEER – kursi nominal efektiv i këmbimit i llogaritur kundrejt dy monedhave, sipas një peshe të përafërt që zënë në tregtinë me jashtë, euro (80 për qind) dhe usd (20 për qind).

DISKUTIM I GUVERNATORIT TË BANKËS SË SHQIPËRISË Z.ARDIAN FULLANI

në Forumin e 11-ë të Euromoney: "Zgjerimi i kufijve: Përforcimi i konkurrencës në Evropën Qendrore dhe Lindore"
Vjenë, 18 janar 2006

Rruga drejt tregjeve të reja ka zgjeruar kufijtë e industrisë në drejtim të vendeve të Evropës Qendrore dhe Lindore. Vendet e ish-Bashkimit Sovjetik aktualisht po përjetojnë një rritje të menjëhershme, ndërkohë që shumë prej vendeve të "Evropës së Vjetër" janë karakterizuar nga një mungesë e zhvillimit të mëtejshëm të ekonomisë së tyre. Kohët e fundit ka patur një rritje të menjëhershme në tregjet e brendshme, investimet e huaja direkte, pronën e patundshme, zhvillimin tregtar etj.

A do të vazhdojë ky nivel i lartë investimi dhe në cilat rrethana? Ç'mund të bëjnë guvernatorët e bankave qendrore për të nxitur më tej këtë rritje të re? A ka disavantazhe? Si arrijnë guvernatorët të mbajnë ekuilibrin ndërmjet rritjes dhe stabilitetit?

A DO TË VAZHDOJË KY NIVEL I LARTË INVESTIMI DHE NË CILAT RRETHANA?

Ekonomia shqiptare ka patur një ecuri të mirë edhe gjatë vitit 2005, me një ngadalësim të lehtë gjatë fundvitit, për shkak të problemeve të energjisë. Zhvillimet pozitive përfshijnë si veprimtarinë ekonomike ashtu edhe stabilitetin makroekonomik. Vlerësimi ynë për ecurinë e shëndoshë ekonomike bazohet në rritjen e vëllimit të shitjeve, në përmirësimin e të ardhurave nga taksat dhe TVSH-ja, rritjen e kredidhënies për ekonominë, si dhe në rënien e papunësisë.

Krijimi i 13400 vendeve të reja pune në sektorin privat gjatë 4 tremujorëve të fundit, tregon për një rritje të fuqishme dhe gjithashtu, shërben si një tregues tjetër i rritjes së kapaciteteve të prodhimit të brendshëm gjatë këtij viti. Përveç sektorit të shërbimeve, vrojtimet e Bankës së Shqipërisë lidhur me besimin e bizneseve tregojnë një rritje të numrit të punonjësve në sektorët e prodhimit dhe të ndërtimit, për tremujorin e dytë. Të dhënat paraprake tregojnë se niveli i punësimit gjithashtu është rritur gjatë tremujorit të tretë, ndryshe nga rënia që pritej nga tremujori i kaluar.

Ndonëse është e vërtetë se kohët e fundit ka pasur një rritje të ndjeshme në tregjet vendase, tabloja është më komplekse nëse shohim segmente të veçanta. Kështu, investimet e huaja direkte ende mbeten në nivele të ulta, edhe pse Shqipëria ofron mundësi të mira për tërheqjen e tyre me vendndodhjen e favorshme gjeografike, me pagat konkurruese dhe me burimet natyrore.

Edhe investimet vendase, bazuar në disa vrojtime të Bankës së Shqipërisë, duket se kanë hapësira për t'u rritur më tej. Një burim i rëndësishëm i investimeve vendase mbeten remitancat. Vlerësimet e Bankës së Shqipërisë tregojnë se remitancat totale kanë arritur në rreth 1,028 milionë (një miliard)

dollarë amerikanë ose 13.5 për qind e PBB-së. Kjo shifër është sa dyfishi i të ardhurave nga eksporti i mallrave, gjë që e bën "forcën e punës" eksportin kryesor për vendin tonë. Është vlerësuar se remitancat janë tre herë më të larta se investimet e huaja direkte dhe vlera e tyre tejkalon dukshëm ndihmën zyrtare nga jashtë. Gjatë fazës së parë të tranzicionit nuk ka patur një politikë të qartë lidhur me optimizimin e administrimit dhe shfrytëzimin e remitancave për qëllime zhvillimi. Disa masa sporadike kanë synuar dërgimin e remitancave nëpërmjet kanaleve zyrtare dhe përmirësimin e kursimeve si dhe nxitjen e emigrantëve për të investuar në vend, por këto masa kanë qenë të pamjaftueshme. Kohët e fundit i është treguar më tepër vëmendje remitancave dhe kontributit të tyre potencial në financimin e rritjes dhe zhvillimin e vendit. Më konkretisht, po punohet në tre fusha kryesore (1) përmirësimi i statistikave; (2) dërgimi i remitancave nëpërmjet kanaleve zyrtare; (3) drejtimi i remitancave për nevoja të zhvillimit të vendit.

Ndërkohë, ka patur një rritje të ndjeshme në fushat e tjera të ekonomisë si huatë tregtare dhe ndërtimi. Kredia për ekonominë vlerësohet të jetë rritur, rreth 60-70 për qind gjatë vitit që lamë pas. Në terma të PBB-së, kredia për ekonominë është rritur me 3 pikë përqindje gjatë vitit 2005, duke iu afruar nivelit prej 11 për qind të PBB-së. Rritja e kredisë për ekonominë ka shërbyer si burimi kryesor i zgjerimit monetar gjatë kësaj periudhe, duke sjellë një zhvendosje nga huamarrja e qeverisë dhe aktivet në valutë. Huatë në valutë vazhdojnë të jenë të preferuara për shkak të normave të ulëta të interesit, duke u llogaritur kështu në rreth 75 për qind të totalit të huave në fund të korrikut. Rritja e shpejtë e kredisë deri tani nuk ka ndikuar në cilësinë e përgjithshme të kredisë. Raporti i huave me probleme u ul në 3.5 për qind të totalit të huave në mars, nga 4.2 për qind që ishte në muajin dhjetor të vitit të kaluar.

Aktualisht, bankat e huaja në Shqipëri zotërojnë rreth 95 për qind të totalit të aktiveve. Pjesa më e madhe e aktiveve zotërohet nga banka që vijnë nga Zona e Bashkimit Evropian. Kjo pjesëmarrje e gjerë e bankave të huaja sigurisht që ka pasur implikime pozitive si për qeverisjen e bankave ashtu edhe për cilësinë e shërbimeve. Kjo e fundit është përmirësuar dukshëm gjatë viteve të fundit me privatizimin e ish-Bankës së Kursimeve, e cila vazhdon të jetë banka më e madhe në Shqipëri. Si rezultat, kemi hasur një zgjerim të rrjetit bankar në të gjithë territorin e vendit, një ristrukturim gradual të bilancit të sistemit bankar, përfshirë një rritje të shpejtë të kredisë për ekonominë, si dhe futjen e ATM-ve dhe të produkteve të tjera të reja bankare etj.. Bankat private me kapital shqiptar, që janë licencuar gjatë tre viteve të fundit, kanë qenë mjaft aktive në përpjekjen e tyre për t'u pozicionuar në këto tregje në ndryshim. Ato ofrojnë një gamë të plotë shërbimesh bankare, pasi kanë përparësinë e të kuptuarit më mirë të mjedisit vendas.

Krahas arritjeve të mësipërme, ekonomia është ende e brishtë dhe nevojiten akoma shumë përpjekje për të krijuar një kuadër tërheqës për investime dhe rritje të qëndrueshme, dhe zhvillim të sektorit privat. Procedurat doganore, administrimi i taksave, lejet për truall dhe për ndërtim, rregullat e licencimit dhe sistemi gjyqësor vazhdojnë të karakterizohen nga elemente jo shumë nxitëse për investimet në Shqipëri.

Ç'MUND TË BËJNË GUVERNATORËT E BANKAVE QENDRORE PËR TË NXITUR MË TEJ KËTË RRITJE TË RE? A KA DISAVANTAZHE?

Reformat për konsolidimin institucional mbeten kritike përsa i përket zhvillimit të një klime biznesi të bazuar në rregulla dhe për të tërhequr rritjen e investimeve. Në këtë kuadër, Banka e Shqipërisë është e angazhuar të ecë përpara në drejtim të reformave strukturore, me qëllim përmirësimin e ndërmjetësimit bankar dhe ofrimin e shërbimeve financiare. Në bashkëpunim të ngushtë me bankat tregtare, me institucionet qeveritare dhe me sektorin privat, Banka e Shqipërisë ndërmori një plan veprimi për rritjen e përdorimit të rregullt të sistemit bankar nga bizneset.

Lidhur me një aspekt të rëndësishëm të bankës sonë qendrore, stabilitetin e sistemit bankar, është punuar mjaft mirë për të nxitur zhvillimin dhe konsolidimin e një sistemi të shëndoshë bankar e financiar, me qëllim përparimin ekonomik të vendit. Masat e mbështetura nga Banka e Shqipërisë përfshijnë privatizimin e Bankës së Kursimeve, zhvillimin e një sistemi për sigurimin e depozitave, përmirësimin e kuadrit të falimentimit dhe zbatimin e kolateralit, dhe forcimin e rregullimit dhe të mbikëqyrjes bankare, të cilat gjithashtu do të ndihmojnë në përpjekjet e qeverisë kundër pastrimit të parave. FMN-ja ka ofruar ndihmesë teknike për Bankën e Shqipërisë. FMN-ja gjithashtu, ka financuar një këshilltar rezident për të mbështetur zbatimin e programit të zhvillimit institucional për mbikëqyrjen bankare të zhvilluar nga Banka e Shqipërisë. Në vazhdën e privatizimit të Bankës së Kursimeve, sektori financiar po bëhet më dinamik dhe Banka e Shqipërisë po përmirëson mbikëqyrjen e saj të kujdesshme. Ushtrimi i programit të FSAP sigurisht që do të ndihmojë në përparimin e mëtejshëm të reformave në sektorin financiar.

Gjithashtu, Banka e Shqipërisë është e përkushtuar të përmirësojë marrëdhëniet reciproke me të gjithë partnerët ndërkombëtarë. Ne po përpiqemi që të jemi një partner real në tryezën e diskutimit, duke prezantuar politikat ekonomiko-financiare përmes paraqitjes së alternativave që çojnë drejt zgjidhjes së tyre e duke i shtjelluar ato, jo vetëm në bazë të logjikës ekonomike, por edhe duke u bazuar në realitetin shqiptar. Për këtë arsye, ndihem i lumtur që Shqipëria është pranë arritjes së një marrëveshjeje të re PRGF/EFF me FMN-në. Kjo marrëveshje do të përmbushë nevojat aktuale të vendit. Duke marrë parasysh të kaluarën e vështirë të Shqipërisë, si dhe rënien e krijuar nga ngjarjet e vitit 1997, vendit i nevojitet një përshpejtim i axhendës së reformave, me qëllim futjen në Bashkimin Evropian. Kjo kërkon investime të konsiderueshme, përmirësime të institucioneve publike dhe asistencë teknike në të gjitha fushat. Marrëveshja e PRGF-së i jep mundësi Shqipërisë, që jo vetëm të përfitojë shumë prej këtyre fondeve të organizatave të FMN-së dhe BB-së, por edhe të mund të përvetësojë fondet e disponueshme të Bashkimit Evropian, në mënyrë sa më efektive.

Ne gjithashtu, jemi duke punuar për institucionalizimin e bashkëpunimit ndërmjet bankave qendrore të rajonit. Nisur nga takimet e organizuara prej nesh kohët e fundit me disa autoritete bankare rajonale, nisma e bashkëpunimit

rajonal është mirëpritur mjaft. Megjithatë, unë besoj se kjo është koha e duhur për të marrë disa masa konkrete në këtë drejtim, nëpërmjet krijimit të një klubi të bankave rajonale, i cili do të bënte të mundur shkëmbimin e përvojave dhe konsolidimin e bashkëpunimit, kryesisht në fushën e zhvillimit të mëtejshëm të sektorit financiar dhe bankar në Evropën Juglindore. Banka e Shqipërisë do të vazhdojë të mbështesë dhe të promovojë fuqimisht krijimin e këtij klubi në të ardhmen. Do të doja gjithashtu të përmendja "Programin e Konvergjencës", i cili është një program i ri mbi zhvillimin financiar, sponsorizuar nga Banka Botërore për të promovuar politikën e dialogut publik-privat në Evropën Juglindore. Ky program do të shërbente si një instrument i frytshëm për të intensifikuar përpjekjet tona në krijimin e urave lidhëse ndërmjet shoqatës së bankave dhe homologëve të tjerë në rajon.

SI ARRIJNË GUVERNATORËT TË MBAJNË EKUILIBRIN NDËRMJET RRITJES DHE STABILITETIT?

Teorikisht, përgjigja do të ishte zbatimi i "Rregullit Taylor" duke vendosur pesha të barabarta në të dyja, në diferencën (gap-in) e prodhimit dhe inflacionin. Megjithatë, për një ekonomi të vogël, të hapur e në zhvillim, përvoja empirike mund të mos jetë edhe aq e thjeshtë. Një problem do të ishte se sa janë në gjendje ekonomitë e vogla si ne të ndjekin politika të pavarura monetare.

Një argument që unë e përkrah është se ekonomia shqiptare është një ekonomi relativisht fleksible, pasi ajo arrin të sjellë inflacionin në nivele normale brenda një periudhe kohore relativisht të shkurtër. Ngurtësitë e vërejtura në disa ekonomi të tjera duket se nuk aplikohen në rastin e Shqipërisë. Këtu kam parasysh procedurat e gjata për punësim dhe shkurtime apo shumëllojshmërinë e rregullave lidhur me tregjet e mallrave dhe të shërbimeve. E rëndësishme mbetet mbajtja e një regjimi lirisht të luhatshëm të kursit të këmbimit, i cili ka qenë dhe vazhdon të jetë një ndër kontribuesit kryesorë në fleksibilitetin ekonomik, që ndikon drejtpërsëdrejti në përqindjen e lartë të fleksibilitetit të ekonomisë shqiptare.

Prej këtij fleksibiliteti, Shqipëria ka shfaqur rezultate mjaft të mira në drejtim të stabilitetit të çmimeve. Inflacioni përgjithësisht është karakterizuar nga norma më të ulëta krahasuar me ekonomitë e tjera në tranzicion. Në pesë vitet e fundit, inflacioni ka qëndruar në nivele mesatare, me shifra të matura në fund të periudhës dhe në periudhën mesatare, edhe pse ndonjëherë ai zhvendoset nga objektivi për shkak të *shock*-eve të paparashikuara dhe faktorëve spekulativë, të cilët janë përtej kontrollit të bankës qendrore. Ne do të vazhdojmë të synojmë mbajtjen e normës së inflacionit në nivelin rreth 3 për qind. Megjithatë, disa kërcënime të jashtme mund ta pengojnë bankën në arritjen e objektivit të saj gjatë ruajtjes së rritjes ekonomike. Si fillim, fuqia sinjalizuese e agregatëve monetarë synuar nga Banka e Shqipërisë mund të fillojë të përkeqësohet. Kjo mund të përfshijë ndryshime në çmimet administrative dhe reformat strukturore në përgjithësi, çështjet lidhur me pasiguritë fiskale, impaktin e dollarizimit mbi efikasitetin e politikës monetare, uljen e mundshme

të remitancave nga jashtë dhe implikimin e tyre në paqëndrueshmërinë e kursit të këmbimit, zhvillimin dhe stabilitetin e sistemit financiar etj..

Gjithashtu, çka është edhe më e rëndësishme, ndërkohë që ekonomia kalon drejt formalizimit, fleksibiliteti i hasur deri tani mund të bjerë, duke e vështirësuar detyrën tonë të ruajtjes së inflacionit në nivele të ulëta, me pak kosto reale.

Për të ardhmen ne po konsiderojmë kalimin në regjime alternative, siç është ai i shënjestrimit të inflacionit, që mund të përçojë më mirë sinjalet e politikës monetare dhe të jetë më i përshtatshëm në mbajtjen e një ekuilibri ndërmjet *shock*-eve ekonomike dhe inflacionit. Në krye të listës së përfitimeve teorike të një regjimi të shënjestrimit të inflacionit krahasuar me regjimet e tjera (përmbledhur në një seri materialesh diskutimi nga Mishkin et al. (1997, 2000, 2002)) është baza më e gjerë e informacionit që ai përdor, elasticiteti relativisht më i lartë i tij përsa i përket *shock*-eve të ofertës, fakti që kuptohet lehtë nga publiku, referenca e një zhvendosjeje të suksesshme të regjimit në ekonomitë e tjera evropiane në tranzicion e në zhvillim, si për shembull në Republikën Çeke, në Hungari, në Islandë, në Poloni dhe në Turqi.

Duke pasur parasysh çështjet e mësipërme, Banka e Shqipërisë gjykon se kalimi në shënjestrimin e inflacionit gjatë periudhës afatmesme do të na vendosë në një pozicion më të mirë, për të arritur ekuilibrin e duhur ndërmjet rritjes dhe stabilitetit. Për rrjedhojë, së bashku me asistencën teknike të FMN-së, Banka e Shqipërisë ka filluar hapat e saj drejt përmirësimit të strukturës së drejtimit dhe përforcimit të kapaciteteve të saj analitike. Për këtë qëllim, në fund të vitit të kaluar u organizua një forum i hapur, ku ekspertët më të mirë diskutuan në pjesën më të madhe të çështjeve lidhur me zbatimin e shënjestrimit të inflacionit. Motivimi kryesor për kalimin drejt një regjimi të shënjestrimit të inflacionit është vendosja e pritshmërive inflacioniste në periudhën afatmesme deri në atë afatgjatë, duke krijuar hapësira për përgjigjen ndaj *shock*-eve.

Jam i ndërgjegjshëm se adoptimi zyrtar i regjimit të shënjestrimit të inflacionit është një proces që kërkon mjaft punë dhe plotësimin e disa parakushteve. Forumi i organizuar prej nesh tregoi qartë se ky nuk është një vendim i njëhershëm, por më tepër ai duhet të jetë një proces gradual. Kjo vlen sidomos për një vend në tranzicion siç është Shqipëria, pasi vendi ynë përballet me sfida dhe situata të ndryshme krahasuar me ato të vendeve të zhvilluara.

FJALA E GUVERNATORIT TË BANKËS SË SHQIPËRISË, Z.ARDIAN FULLANI

në konferencën për shtyp të organizuar në kuadër të nënshkrimit të marrëveshjes së re me FMN
Tiranë, 30 janar 2006

Banka e Shqipërisë, vlerëson se arritja e Marrëveshjes së re 3-vjeçare me Fondin Monetar Ndërkombëtar përbën një moment të rëndësishëm në zhvillimin e mëtejshëm ekonomik dhe financiar të vendit. Mbështetja e re që FMN po i jep Shqipërisë është në të njëjtën kohë një obligim për institucionet përgjegjëse që janë të angazhuara në përmbushjen me sukses të detyrimeve që rrjedhin prej saj, institucione ku bën pjesë dhe Banka e Shqipërisë. Në këtë kontekst, në emër të institucionit që unë drejtoj, dëshiroj të theksoj se Banka e Shqipërisë do të përmbushë detyrimet e saj me seriozitet dhe angazhim maksimal. Ky angazhim i yni buron edhe nga bindja e plotë se axhenda e reformave strukturore të propozuara dhe trajektorja e parashikuar e politikave makroekonomike, përbëjnë përgjigjen e duhur për sfidat që ka ekonomia shqiptare.

Rëndësia e marrëveshjes është e madhe pasi ajo:

Së pari, konturon qartë drejtimet kryesore se ku do të përqendrohet puna e institucioneve tona në tre vitet e ardhshme, duke krijuar një shtrat të sigurt në rrugën e vështirë të konsolidimit të mëtejshëm makroekonomik të vendit, të rritjes ekonomike dhe të reduktimit të varfërisë.

Së dyti, vendos objektiva të qartë për reformat e nevojshme strukturore që duhen ndërmarrë në periudhën afatshkurtër dhe atë afatmesme, duke identifikuar institucionet përgjegjëse dhe afatet konkrete për materializimin e tyre.

Së treti, krijon premisat për më shumë disiplinë financiare dhe koordinim më të mirë në të gjitha nivelet vendimmarrëse, duke u kthyer në këtë mënyrë në një faktor garancie për investitorët vendas dhe ata të huaj, përfshirë dhe organet e rëndësishme ndërkombëtare.

Për këtë qëllim, kemi marrë masat e duhura për të mishëruar në strategjinë e politikës monetare dhe programin monetar të Bankës së Shqipërisë, të gjitha kushtëzimet dhe treguesit bazë për të cilat paraprakisht kemi rënë dakord me Misionin e FMN-së, të kryesuar nga zoti Szekely.

Duke mbyllur këtë prononcim të shkurtër do të shtoja edhe një herë se miratimi i kësaj marrëveshjeje ka dhe një rëndësi tjetër të veçantë, pasi në përfundim të saj në qoftë se çdo gjë shkon sipas parashikimit, mundësohet lëvizja e ekonomisë shqiptare "me këmbët e veta".

Për këtë qëllim, është e rëndësishme që të fillojmë të mendojmë që tani për ardhmërinë e politikave bazë ekonomike të vendit pas skadimit të kësaj marrëveshjeje. Duke përfituar nga rasti, dëshiroj të theksoj se ne po

punojmë në këtë drejtim dhe në bashkëpunim dhe me asistencën e FMN-së dhe të bankave të tjera qendrore, kemi intensifikuar përpjekjet për ndërtimin e strategjive të duhura monetare, të cilat do të mundësojnë kontrollin e presioneve inflacioniste dhe do të orientojnë zhvillimin e qëndrueshëm të vendit drejt integrimit evropian.

FJALA E GUVERNATORIT TË BANKËS SË SHQIPËRISË, Z.ARDIAN FULLANI

në takimin me komunitetin e biznesit, me përfaqësues të pushtetit lokal dhe të sektorit bankar dhe me akademikët e qytetit të Shkodrës
Shkodër, 17 shkurt 2006

PËRMIRËSIMI I INFORMACIONIT MBI EKONOMINË - ELEMENT-KYÇ PËR ECJEN PËRPARA

Qëllimi i vërtetë i ardhjes sonë këtu është i shumëfishtë dhe para së gjithash është në linjë me vizionin tonë për përafrimin e Bankës së Shqipërisë me standardet dhe praktikat më të mira ndërkombëtare të bankës qendrore. Kjo vjen logjikshëm jo vetëm me nevojat për rritjen e kapaciteteve tona njerëzore, por edhe me domosdoshmërinë për të rritur shkallën e monitorimit dhe të pranisë së ekspertizës së Bankës së Shqipërisë në të gjitha rajonet e vendit. Besoj se ky takim i përvitshëm i Guvernatorit të Bankës së Shqipërisë me degët e saj dhe me komunitetet më të spikatura të rajonit, ku ne ushtrojmë aktivitetin tonë është kthyer në një traditë, që ka si qëllim jo vetëm evidentimin e problemeve tona operacionale, por edhe identifikimin dhe dhënien e këshillave për një zhvillim sa më proporcional dhe të harmonizuar të rajoneve të ndryshme gjeografike të vendit.

Gjatë vitit 2005, ne si institucion i rëndësishëm në fushën e vendimmarrjes së politikave ekonomike dhe të sigurimit të stabilitetit financiar të vendit, kemi shumëfishuar përpjekjet tona për një kontroll më të mirë të inflacionit, duke besuar se ky kontribut është i një rëndësie vitale për ecurinë e aktivitetit ekonomik në përgjithësi, përfshirë edhe atë të rajonit tuaj.

Nga ana tjetër, jemi munduar që konsolidimin e mëtejshëm të ekuilibrave makro në ekonomi ta shoqërojmë me një sistem bankar të stabilizuar financiarisht, në mënyrë që të jetë i aftë të financojë gjithmonë e më shumë zhvillimin ekonomik të vendit.

E shohim dhe e prekim biznesin shkodran, të rritet dhe të integrohet me sistemin bankar dhe ky fakt më bën të ndihem optimist për të ardhmen. Ky interes i biznesit bankar për t'u shtrirë në rajonin tuaj, mendoj se pasqyron zhvillimet specifike që ky rajon ka, në raport me zona të tjera të vendit. Unë personalisht jam i mendimit se ky rajon ka potencial të madh ekonomik, dhe për më tepër theksoj se ky rajon është nga të paktët që ka një potencial shumësektorial, përfshirë dhe atë bujqësor. Po kështu, gjykoj se edhe marrëdhëniet ndërkufitare janë një oportunitet i mirë për zhvillimin intensiv të tij dhe duke përgjithësuar sa thashë më sipër, do ta inkurajoja sistemin bankar që të jetë më agresiv në këtë rajon, me plane dhe objektiva konkretë për të mbështetur ekonominë tuaj.

Pavarësisht sa thashë më sipër, ne si Bankë e Shqipërisë jemi të ndërgjegjshëm se procesi i rritjes dhe i konsolidimit të sistemit bankar është një sfidë e përhershme. Për këtë qëllim, në programet tona të punës për vitin 2006 kemi përfshirë hapa të tjerë konkretë që do të kontribuojnë në këtë drejtim.

Më konkretisht, jemi duke ideuar dhe vënë në zbatim masa të reja, të cilat do të rrisin aktivitetin e sistemit bankar jo vetëm në drejtim të mobilizimit të fondeve të lira në formën e depozitave, por do ta bëjnë atë më aktiv në alokimin e fondeve në ekonomi, në administrimin më efektiv të fondeve të lira, në administrimin më të mirë të rreziqeve që shoqërojnë investimin e fondeve, në rritjen e konkurrencës për të minimizuar kostot dhe për rrjedhim, komisionet që bankat aplikojnë, në krijimin e lehtësive të tjera për të ndihmuar sistemin në dhënien e kredive, në përsosjen e mëtejshme të sistemit të pagesave duke synuar pakësimin e mëtejshëm të parasë *cash*, përfshirë dhe përmirësimet e duhura ligjore dhe rregullatore, që lidhen me veprimtarinë e përditshme të sistemit bankar.

Dua t'ju siguroj se për ne, qëndrueshmëria e sistemit bankar po merr një rëndësi gjithnjë e më të madhe. Për këtë qëllim, ne jemi të angazhuar që të zbatojmë me përpikmëri të gjitha rekomandimet e lëna nga raporti i Vlerësimit të Sektorit Financiar (FSAP) të FMN-së gjatë vitit 2005, vënia në jetë e të cilave do të rriste ndjeshëm eficiencën dhe sigurinë e sistemit bankar dhe të atij financiar, në një kontekst më të gjerë. Dua të theksoj se Banka e Shqipërisë si autoriteti mbikëqyrës i bankave tregtare, e ndien për detyrë të tërheqë vëmendjen se rritja e madhe e vëllimit të kredive gjatë vitit 2005 si dhe rritja e mëtejshme gjatë viteve në vazhdim, duhet të shoqërohet me masa efektive për rritjen e kapaciteteve monitoruese, analizuese dhe kontrolluese të vetë bankave për të shmangur përkeqësimin e portofolit të kredive. Nga ana tjetër, ne do të forcojmë kapacitetet tona mbikëqyrëse, sidomos inspektimin në vend duke ndërtuar plane masash, të cilat do të synojnë një kontroll të kujdesshëm për çdo bankë anëtare të sistemit.

Sigurisht, ideja jonë për të ftuar në takimet tona komunitetin e biznesit nuk është e re. Në filozofinë tonë ne mendojmë se biznesi është një partner i rëndësishëm, që me vendimet dhe sjelljen e tij ndikon në suksesin e politikave tona por gjithashtu, edhe në një zhvillim të qëndrueshëm dhe harmonik të sistemit bankar.

Në këtë kontekst, dëshiroj të parashtroj disa teza, ndonjëren prej të cilave e kam përmendur edhe në raste të tjera, por të cilat, falë edhe zhvillimeve aktuale dhe të perspektivës, i shoh me vend që t'i ritheksoj përsëri.

Një çështje e parë, të cilën do të doja ta ndaja me ju, ka të bëjë me rolin e degës së Bankës së Shqipërisë në rajonin ku ajo vepron. Roli i degës së Bankës së Shqipërisë duhet të jetë i ndryshëm nga ai që ne jemi mësuar të shohim. Një hap të parë në këtë drejtim e kemi hedhur gjatë vitit 2005, kur pas përpjekjesh dhe takimesh të shumta, arritëm të vjelim nëpërmjet një pyetësori specifik disa të dhëna mbi ekonominë e rajonit tuaj.

Megjithatë, filozofia ime për degën e Bankës së Shqipërisë është pak më avangarde pse jo, shumë më ambicioze. Nuk dua ta fsheh pikësynimin tim për shndërrimin e degëve të Bankës së Shqipërisë në qendra të fuqishme dhe profesionale të grumbullimit, të përpunimit dhe të analizës ekonomiko – financiare të rajonit. Mendoj se dega e Bankës së Shqipërisë duhet të jetë

e hapur për bashkëpunim me grupe të ndryshme interesi, duke bërë çmos që në këtë "vorbull" analizash dhe studimesh të përfshijë elitën intelektuale të rajonit, ku sigurisht në pararojë do të jenë qarqet akademike vendore.

Megjithatë, duke kaluar në këtë mënyrë dhe në çështjen time të dytë, si mund ta luajë një rol të tillë dega jonë nëse ajo nuk zotëron informacionin e duhur për këtë qëllim?

Informacioni mbi tregjet dhe zhvillimet më të fundit ekonomike, mund të konsiderohet si çelësi i suksesit për bizneset në kohët moderne të zhvillimeve të vrullshme të teknologjisë dhe informacionit. Megjithëse në pamje të parë mund të mos duket problemi më akut që bizneset shqiptare po hasin aktualisht, jo shumë larg prej tani do të lindë nevoja e njohjes dhe e analizave të tregut në kohë reale- informacion i freskët, për t'u përballur me sfidat e globalizimit. Parë në një aspekt më të gjerë, ekonomia e një vendi nuk mund të arrijë të jetë konkurruese në rrafshin ndërkombëtar, nëse politikat e zhvillimit mbështeten në një bazë të dobët informacioni real.

Për Bankën e Shqipërisë, informacioni mbi zhvillimet më të fundit ekonomike dhe pritshmëritë është i pazëvendësueshëm për vendimmarrjen e politikës monetare. Prej kohësh është bërë e qartë, që procesi i ruajtjes së stabilitetit të çmimeve - objektivit tonë kryesor - është një proces që duhet të shikojë përpara në kohë. Me gjendjen aktuale të statistikave kombëtare, të cilat dalin me vonesa ndonjëherë dhe deri në dy vjet, kuptohet që detyra jonë bëhet mjaft e vështirë.

Ndërkohë që reformat në fushën e statistikave si në shumë fusha të tjera janë në proces, rezultatet mund të duan kohë të realizohen. Nga ana tjetër, vendimet tona duhet të mbështeten mbi baza sa më të shëndosha. Në këtë "boshllëk" informacioni, një prej zgjidhjeve të përdorura prej nesh është anketimi i agjentëve të ndryshëm ekonomikë. Prej gati katër vjetësh, Banka e Shqipërisë ka filluar vlerësimin e indekseve të besimit të bizneseve dhe të konsumatorëve. Këto anketime që bëhen çdo tremujor me ndihmën e INSTAT-it, përfshijnë mbi 600 biznese të sektorëve të prodhimit, të ndërtimit dhe të shërbimeve, dhe 1500 konsumatorë. Informacioni i mbledhur lidhet me ecurinë e çmimeve, të konsumit, të të ardhurave, të prodhimit, të punësimit, të investimeve e të shumë treguesve të tjerë të cilët na ndihmojnë mjaft në vendimmarrjen e politikës monetare.

Rezultatet e anketimeve tona për vitin që lamë pas, dëshmojnë për një ecuri të mirë të ekonomisë mbështetur nga një kërkesë e fortë, reflektuar në përmirësim të prodhimit, investimeve dhe punësimit. Këto rezultate konfirmohen dhe nga të dhënat reale mbi rritjen vjetore të vëllimit të shitjeve, nga rritja e numrit të të punësuarve, nga rritja mjaft e shpejtë e kreditimit të ekonomisë dhe nga rritja e të ardhurave fiskale. Kjo rritje ekonomike është zhvilluar në kushtet e një inflacioni të ulët rreth objektivit tonë 3 për qind dhe të deficitit buxhetor brenda vlerave të programuara, duke mos cënuar ekuilibrat dhe raportet kryesore makroekonomike. Ecuria normale e inflacionit, ka bërë që Banka e Shqipërisë të ndjekë një politikë monetare neutrale, duke e lënë të pandryshuar normën bazë të interesit, në nivelin 5 për qind.

Pritshmëritë për këtë vit mbeten pozitive. Ne presim që inflacioni të luhatet brenda intervalit që ne synojmë 2-4 për qind, ndërkohë që rritja ekonomike me përmirësimin e situatës energjitike, duket të jetë kthyer në prirjen e saj normale.

Megjithëse deri më sot, rezultatet e pyetësorëve tanë janë pasqyruar indirekt në analizat dhe raportet tona periodike dhe në studime të ndryshme të bankës, shumë shpejt banka mendon të fillojë publikimin e rregullt të këtyre rezultateve. Fillimisht, kemi menduar të zhvillojmë disa takime si ky i sotmi me biznese dhe akademikë në bashkëpunim me dhomat e tregtisë dhe universitetet, ku do të mund të marrim sugjerime mbi vlefshmërinë e këtyre pyetësorëve.

Përgjatë të njëjtës linjë të përmirësimit të burimeve të informacionit ekonomik, një tjetër iniciativë e re, e ndërmarrë prej nesh mëse një vit më parë, ka të bëjë me aktivizimin e degëve të Bankës së Shqipërisë, në mbledhjen dhe analizimin e zhvillimeve ekonomike në rajone të ndryshme të Shqipërisë. Deri më tani, janë realizuar dy anketime të cilat, me gjithë vështirësitë e fillimit, kanë dhënë rezultate mjaft interesante, që i kemi sjellë për t'i ndarë me ju sot. Qëllimi kryesor i vrojtimit të ndërmarrjeve në rrethe është mbledhja e të dhënave sasiore mbi ekonominë reale të vendit, me një periodicitet tremujor. Pyetësori synon të marrë një informacion sa më të plotë dhe të vazhdueshëm në kohë mbi gjendjen e tregut të punës, ecurinë e çmimeve, prodhimin dhe mbi marrëdhëniet e biznesit me bankat. Ky informacion do të përdoret për të llogaritur disa tregues të rëndësishëm si produktiviteti, kosto për njësi e punës etj., të cilët janë shpesh mjaft të nevojshëm në punët studimore të Bankës së Shqipërisë. Aktualisht, këta tregues nuk ofrohen nga statistikat aktuale zyrtare.

Një tjetër objektiv është shmangia e problemeve që dalin nga vonesa në kohë e të dhënave statistikore zyrtare. Gjithashtu, informacioni i marrë mendohet të përdoret për të plotësuar informacionin cilësor që vilet nga vrojtimi i tendencës së besimit të biznesit.

Zhvillimi në mënyrë periodike i këtij vrojtimi nga degët e Bankës së Shqipërisë, synon të rrisë praninë e saj në rrethe. Përfshirja e drejtpërdrejtë e punonjësve të degëve në procesin e intervistimit, ka për qëllim të shfrytëzojë dhe njohjet ndërpersonale të tyre me drejtuesit apo me financierët e kompanive. Kjo gjë do të bëjë të mundur marrjen e përgjigjeve mbi disa probleme delikate si: tregu joformal i punës, evazioni fiskal, fitimi etj..

Punonjësit e degëve janë angazhuar drejtpërdrejt në hartimin e listave të bizneseve, në zonat ku operojnë degët e Bankës së Shqipërisë si dhe në procesin e intervistimit të tyre. Megjithë përpjekjet e mira, duhet thënë se vështirësitë nuk kanë munguar. Problemet kryesore të raportuara nga punonjësit e degëve kanë qenë: mungesa e bashkëpunimit nga ana e firmave për të kryer intervistën, vështirësi në kontaktimin e personave kompetentë, mungesë e sinqeritetit në shifrat e deklaruara etj.. Përfitoj nga rasti për të sensibilizuar bizneset për rëndësinë e këtyre anketimeve, jo vetëm në aspektin makroekonomik por edhe në nivel kompanie. Në këtë iniciativë, bizneset nuk do të konsiderohen thjesht dhënës informacioni por dhe përdorues të analizave

finale, që do t'i ndihmonin ata në njohjen më të mirë të tregut. Duke qenë se bizneseve pjesëmarrëse rezultatet finale iu shpërndahen ato mund të përbëjnë një informacion me vlerë për planet e tyre për të ardhmen.

Përsa i përket vështirësive të tjera që kanë hasur degët, sidomos në lidhje me mbingarkesën e zhvillimit të këtyre intervistave, duke qenë se objekti i tyre kryesor është ai operacional, kam mendimin se një alternativë efektive ndaj zgjerimit të kushtueshëm të degëve me struktura të reja, për të përballuar ngarkesën e këtyre anketimeve, mund të jetë nxitja e bashkëpunimit me universitetet lokale si ai i Shkodrës. Kjo do të lehtësonte mjaft punën e degëve për mbledhjen e informacionit dhe do t'u krijonte mundësi studentëve, për t'u aktivizuar dhe familiarizuar me analizat ekonomike. Këtu do të ftoja pjesëmarrësit nga universiteti të diskutojmë për mundësitë e bashkëpunimit në këtë drejtim.

Duke kaluar në iniciativat e tjera tradicionale të Bankës së Shqipërisë, ato mbi marrëdhëniet bankë-biznes apo konsumator-sistem bankar, do të doja të tërhiqja vëmendjen në disa oportunitete të tjera të bashkëpunimit biznes-bankë.

Pas përfundimit të sistemit të pagesave në vlerë të madhe dhe të atij të kryqëzimit të pagesave në vlerë të vogël, Banka e Shqipërisë gjykon se është siguruar infrastruktura e duhur për të kanalizuar të gjitha pagesat periodike për shërbimet utilitare nëpërmjet sistemit bankar. Nga ana tjetër, funksionimi i këtij sistemi të ri do të rrisë ndjeshëm shpejtësinë e pagesave midis përdoruesve të bankave, një element mungesa e të cilit i ka mbajtur larg bizneset prej bankave.

Përfitoj nga rasti për të sensibilizuar bizneset për avantazhet që shoqërojnë funksionimin e këtij sistemi, pasi ndërmjet të tjerash, të dyja sistemet së bashku do të ndihmojnë arritjen e standardeve ndërkombëtare të ATM dhe POS për numër popullsie. Sfida për sistemin bankar dhe bizneset, por dhe për Bankën e Shqipërisë mbetet nxitja e publikut në përdorimin e tyre.

Për ta bërë realitet këtë që thashë më sipër, do të nxis sistemin bankar që të jetë më aktiv, që do të thotë se bankat duhet të shkojnë drejt popullsisë dhe bizneseve me produkte të qarta dhe të gatshme, me shërbime të shpejta dhe efikase.

Sigurisht që hapat në këtë drejtim do të jenë më kompleksë dhe natyrshëm, që disa prej tyre kërkojnë dhe bashkëveprim ndërinstitucional. Banka e Shqipërisë tashmë po shtron rrugën drejt përdorimit të gjerë të kartave në Shqipëri. Shërbimi me karta krediti, jo vetëm që do të kontribuojë në reduktimin e *cash*-it në ekonomi por do të japë një ndikim pozitiv edhe në uljen e ekonomisë informale.

Mendoj që e rëndësishme për këtë takim, është nxitja që i bëj sistemit bankar, për të rritur nivelin e shërbimeve, kudo ku bankat ushtrojnë veprimtarinë e tyre. Vetëm në këtë mënyrë do të krijojmë shanse reale për një zhvillim të harmonizuar gjeografikisht, duke dhënë një kontribut të vërtetë në rritjen e mirëqenies në shkallë vendi.

FJALA E GUVERNATORIT TË BANKËS SË SHQIPËRISË, Z.ARDIAN FULLANI

"Remitancat: Një mundësi për rritje. Emigracioni shqiptar në Itali si rast studimi."
Bari, 3-4 mars 2006

Zonja dhe zotërinj,

Jam shumë i kënaqur të flas para jush sot me rastin e Konferencës mbi Remitancat. Dëshiroj të përgëzoj Bankën Botërore dhe Rajonin e Pulias për organizimin e përbashkët të kësaj ngjarjeje të rëndësishme ndërkombëtare. E vlerësoj mjaft partneritetin tuaj dhe këtë mundësi për të gjetur bashkë me ju rrugët e mundshme për një rritje të qëndrueshme, formalizim dhe efikasitet të lartë të remitancave.

Dëshiroj të hap fjalën time duke bërë një pyetje të thjeshtë. Pse remitancat janë për ne çështja kryesore e ditës?

Remitancat përfaqësojnë përfitimin e drejtpërdrejtë dhe të menjëhershëm për familjet e emigrantëve dhe për ekonominë. Flukset e remitancave për vendet në zhvillim janë vlerësuar sa dyfishi i ndihmës për zhvillim që përfitojnë këto vende. Në disa vende si Shqipëria, ato tejkalojnë ndjeshëm investimet e huaja direkte. Rrjedhimisht, qeveritë aktualisht po u kushtojnë gjithnjë e më shumë vëmendje flukseve të remitancave në strategjitë e tyre të zhvillimit, pasi ato përbëjnë një burim të rëndësishëm financiar për rritjen e zhvillimit ekonomik, veçanërisht në zona të pazhvilluara, ku kushtet ekonomike i detyrojnë njerëzit të emigrojnë. Kuadri ekonomik dhe logjistik që qëndron pas emigrimit dhe remitancave është një element-kyç për këto politika. Kjo konferencë dhe ky rast studimi i rëndësishëm, japin një kontribut të madh ndaj këtyre përpjekjeve në zhvillim.

Që në fillim të tranzicionit, vëllimi i remitancave në Shqipëri është rritur me shpejtësi. Në të vërtetë, flukset e remitancave janë mjaft të rëndësishme lidhur me aktivitete të tjera fitimi – këmbimi valutor, duke përfaqësuar rreth 14 për qind të PBB-së, 70 për qind të eksporteve dhe 33 për qind të importeve. Italia është vendi ku shqiptarët emigrojnë më shumë. Nga ana tjetër, Shqipëria është vendi i parë që përfiton më shumë nga flukset e remitancave që Italia dërgon në vendet e tjera. Rrjedhimisht, shërbimet e remitancave nga Italia për në Shqipëri janë bërë një çështje me interes të lartë. Korridori i remitancave Itali- Shqipëri është një rast për të studiuar efektet e remitancave në komunitete lokale dhe për të diskutuar rrugët që i bëjnë këto flukse më efikase dhe më pak të kushtueshme.

Një vrojtim i kohëve të fundit i bërë prej Bankës së Shqipërisë tregon se remitancat kanë ndikuar pozitivisht në gjithë rajonet e Shqipërisë. Ndikimi është pak më i lartë në rajone më pak të zhvilluara, duke lehtësuar disi pabarazinë në të ardhurat mesatare për frymë. Remitancat janë bërë një burim i rëndësishëm i të ardhurave për individët, duke arritur në 33 për qind e të ardhurave të disponueshme të një familjeje mesatare dhe pothuajse 40 për qind në zonat

rurale. Përfituesit e remitancave janë nga të gjitha grupet sociale, përfshirë klasën me të ardhura mesatare (60 për qind) si dhe klasën me të ardhura të ulëta (27 për qind). Vlerësimet tona tregojnë se niveli dhe ashpërsia e varfërisë janë ulur ndjeshëm ndërmjet familjeve që marrin remitanca, duke ndikuar më tepër në ashpërsinë e varfërisë sesa në nivelin e saj.

Remitancat janë përdorur kryesisht për mallra konsumi të importuar, për shërbime dhe për blerjen apo ndërtimin e shtëpive. Një pjesë e vogël është kursyer ose është investuar në biznese, kryesisht në sektorin e bujqësisë. Për rrjedhojë, ndikimi i remitancave në krijimin e punëve të reja ka qenë i kufizuar. Në këtë këndvështrim, nuk dua që të nënvlerësoj rëndësinë e remitancave, por të tërheq vëmendjen në shtimin e reformave strukturore me qëllim rritjen e ndikimit të tyre në ekonomi. Nuk është rastësi fakti që pas arritjes së nivelit prej 14 për qind të PBB-së, norma e rritjes së remitancave ka qenë po aq konstante sa ajo e investimeve të huaja direkte në Shqipëri. Kjo tregon se në periudhë afatmesme, nuk ka dallim ndërmjet vendimeve të investitorëve të huaj dhe remitancave për të investuar në Shqipëri. Sigurisht, emigrantët mund t'i njohin më mirë tregjet vendase. Ata janë më të lidhur me vendlindjen e tyre dhe reagojnë më shpejt sesa investitorët e huaj. Megjithatë, ata kërkojnë po aq garanci për investimet e tyre sa edhe investitorët e huaj. Rrjedhimisht, si vëllimi i remitancave, ashtu edhe efikasiteti i tyre varen shumë nga përmirësimet e klimës së biznesit në Shqipëri.

Ndërkohë që po bëhen përpjekje për të përshpejtuar reformat që synojnë përmirësimin e biznesit, veçanërisht tashmë që është firmosur kohët e fundit edhe Marrëveshja e Stabilizim-Asocimit, ende mbetet pyetja: a ka ndonjë masë tjetër që mund të rrisë kontributin e remitancave për zhvillim? Banka e Shqipërisë, në bashkëpunim me institucionet e tjera qeveritare dhe joqeveritare, ka marrë në konsideratë disa masa konkrete, të cilat tashmë i kam nxjerrë në pah në një konferencë të organizuar nga BERZH-i mbi këtë çështje, mbajtur në shtator të vitit të kaluar. Dëshiroj të përmend shkurtimisht disa prej tyre, nisur nga këndvështrime të reja.

Së pari, përmirësimi i njohurive tona rreth remitancave është i rëndësishëm për vlerësimin e politikave, të cilat ndikojnë drejtpërsëdrejti në rolin zhvillues të remitancave në ekonomi. Përmirësimi i informacionit duhet jo vetëm për të ndihmuar politikat mbi remitancat por edhe infrastrukturën financiare (për shembull, duke ulur koston e transaksioneve), si dhe për të kuptuar ndikimin e tyre mbi varfërinë. Banka e Shqipërisë ka theksuar vazhdimisht rëndësinë e vlerësimit të saktë të flukseve të kapitalit që hyn në vend në formën e remitancave nga emigrantët. Për statistika më të mira jemi ndihmuar nga misionet e FMN-së për ta sjellë metodologjinë e përcaktimit të remitancave më afër standardeve ndërkombëtare. Gjithashtu, ka një bashkëpunim të ngushtë me partnerët tanë ekonomikë kryesorë, Italinë dhe Greqinë, që janë destinacioni kryesor i emigrantëve shqiptarë, për të harmonizuar metodologjitë tona me qëllim përmirësimin e saktësisë në vlerësimin e remitancave. Raporti i Bankës Botërore mbi korridorin italo-shqiptar është gjithashtu një kontribut i madh për të përmirësuar të kuptuarit tonë për remitancat, dhe në emër të autoriteteve shqiptare shpreh mirënjohjen tonë për këtë mbështetje.

Së dyti, formalizimi i flukseve hyrëse të remitancave është një moment shumë i rëndësishëm. Më shumë se gjysma e remitancave hyjnë në vend nëpërmjet kanaleve jozyrtare. Vrojtimet tona tregojnë se shumica e remitancave që hyjnë në Shqipëri kanalizohen nëpërmjet burimeve jozyrtare; të sjella fizikisht nga emigrantët (59 për qind), nëpërmjet miqve dhe të afërmve (23 për qind). Kjo është pjesërisht një pasqyrim i distancave të shkurtra gjeografike midis dy vendeve. Megjithatë, ky fluks i lartë remitancash nëpërmjet kanaleve jozyrtare kërkon gjithashtu veprime për t'i bërë kanalet zyrtare më tërheqëse në drejtim të efikasitetit, sigurisë, kostos dhe anonimitetit. Siç ka arritur në përfundim grupi i studimit, sistemi bankar në Itali përdoret nga një përqindje e lartë emigrantësh – më shumë se 50 për qind kanë llogari bankare. Në aspektin e Shqipërisë, kjo shifër bie në më pak se 20 për qind. Përdorimi i bankave nga ana e familjeve të emigrantëve është nën nivelin optimal, pavarësisht nga shtrirja e konsiderueshme gjeografike e bankave tregtare gjatë viteve të fundit. Ndryshe nga vendet e tjera që marrin remitanca, bankat në Shqipëri ende kanë një pjesë të vogël tregu në shërbimet e remitancave. Megjithatë, ka shenja inkurajuese lidhur me kërkesën për teknologji të re, partneritete novatore dhe pika hyrëse për të arritur grupet në nevojë.

Komisionet e larta për transfertat e parave, të aplikuara nga bankat shpesh bëhen një motiv që individët të mos e preferojnë këtë shërbim. Megjithatë, tashmë ka një bankë tregtare shqiptare, e cila ofron transferta nga Italia për në Shqipëri, pa zbatuar komision për shuma deri në 250 euro në ditë, në një kohë kur dërgesa mujore mesatare e emigrantëve varion nga 100 deri në 150 euro. Ndërkohë, ka disa banka të tjera që ofrojnë të njëjtin shërbim për transferta nga Greqia. Aktualisht, po studiojmë mundësitë për të ulur kostot e transfertave nëpërmjet marrëveshjeve dypalëshe ndërmjet vendeve.

Edhe pse kompanitë e transfertave të parave ofrojnë shërbime transfertash me komisione të arsyeshme, duke mbuluar një shtrirje të mirë gjeografike, ende vëmë re se një pjesë e madhe e parasë *cash* hyn në vend me çanta. Mendoj se ky është më shumë një problem rregullator sesa preferencë e emigrantëve për të qenë informalë. Ndryshimi ndërmjet dy vendeve tona në drejtim të lehtësisë për të përdorur llogari bankare, qëndron në faktin se në Itali nuk mund të merret rroga pa paraqitur numrin e llogarisë bankare. Programi për reduktimin e *cash*-it i iniciuar nga Banka e Shqipërisë tregon qartë se, për të pakësuar paranë *cash* në ekonomi, duhet të heqim opsionin e pagesave me para në dorë, përfshirë këtu edhe pagat e sektorit privat, pagesat utilitare etj.. Banka jonë është plotësisht e angazhuar për ta mbështetur këtë proces në të gjitha nivelet, qofshin këto rregullatore apo teknike.

Sigurisht, kjo kërkon pak kosto, që në rastin e remitancave shkon nga normat zero të ofruara prej kanaleve joformale apo *cash*-it, në disa komisione pozitive që kërkohen prej kanaleve zyrtare. I kuptoj shqetësimet e ngritura nga disa analistë se legjislacioni mbi kontrollin e kursit të këmbimit apo luftën kundër pastrimit të parave mund t'i rrisë më tej komisionet për transfertat dhe t'i shtyjë njerëzit të veprojnë me fshehtësi. Kjo kërkon rishikimin e rregullores që nuk penalizon vëllimin e remitancave. Siç e përmenda edhe më lart, formalizimi i ekonomisë është një komponent kryesor për të përmirësuar mjedisin e biznesit

në Shqipëri. Për rrjedhojë, "detyrimi" i individëve për të kaluar nëpërmjet kanaleve formale, ndërkohë që kjo gjë realizohet me një kosto afatshkurtër të disa normave pozitive, ka shumë mundësi të japë përfitimin afatgjatë të sinjalizimit të synimeve serioze që tregojnë se ne po ecim në drejtimet e duhura, si për emigrantët ashtu edhe për investitorët e huaj.

Për familjet që marrin remitanca, lehtësia e përdorimit të institucioneve financiare luan një rol më të rëndësishëm, për shkak të përqindjes së lartë të të ardhurave të dërguara direkt në derën e përfituesit/marrësit. Në fakt, shkëputja ndërmjet marrjes fizike të fondeve dhe vendndodhjes së institucionit financiar mund të ndikojë mjaft në mosndërmjetësimin e bankave, largimin e fondeve të përfituesve nga bankat dhe përdorimin e tyre në investime direkte më përfituese. Duke pranuar se përfituesit mund të ushtrojnë kontroll mbi mënyrën dhe vendin ku merret remitanca, afërsia gjeografike e një dege ose mundësia për të marrë një remitancë në një zyrë (siç kërkohet nga Western Union) mund të përcaktojë mundësinë e një institucioni për të konkurruar në tregun e remitancave në Shqipëri, pa përmendur mundësinë e përdorimit të kursimeve nga klientë të rinj potencialë.

Remitancat mund të jenë një pikë hyrjeje për shumë dërgues të remitancave dhe për familjet e tyre në sistemin formal financiar. Shumë familje të emigrantëve ose nuk janë familjarizuar me bankat ose i përdorin pak ato. Banka e Shqipërisë, nëpërmjet strategjisë së saj të komunikimit me publikun, synon të afrojë publikun me produktet dhe shërbimet bankare, përfshirë edhe transfertat, pavarësisht nga sa e vogël mund të jetë shuma e transfertës. Edhe pjesa e vogël, e lënë nga familjet përfituese në llogaritë bankare, mund të ndihmojë në zhvillimin ekonomik, pasi bankat do të kenë më shumë fonde në dispozicion për të dhënë kredi ndaj sektorit privat. I njëjti shqetësim ishte shprehur fillimisht për pagat e administratës publike. Tashmë ky shërbim ofrohet nga sistemi bankar dhe e shohim fuqinë e grumbullimit të shumave të vogla. Për bankat tregtare, aftësia e tyre për të tregtuar shërbime shtesë me vlerë të shtuar, si produkte kursimesh, hua apo lloje të tjera kredish ndaj përfituesve të remitancave, do të kërkojë arritjen e një mase të konsiderueshme klientësh, si dhe një mekanizëm dërgimi me teknologji të lartë, për të ulur koston mesatare të investimit që kërkohet në shërbim të klientit.

Programet e mikrokredisë dhe përmirësimet cilësore të infrastrukturës bankare, të kombinuara me futjen e instrumenteve të reja financiare, do të ndihmojnë gjithashtu për të tërhequr më shumë remitanca. Promovimi i organizatave të mikrofinancës si pjesëmarrëse në tregun e remitancave, mund të ofrojë përparësi të caktuara për sektorin e mikrofinancës, për qeverinë dhe për përfituesit e remitancave. Kostoja e kësaj shtrirjeje do të binte fillimisht në autoritetet mbikëqyrëse dhe rregullatore. Tashmë kemi bërë një hap të rëndësishëm në vënien e këtyre institucioneve nën mbikëqyrjen e Bankës së Shqipërisë dhe presim të përmirësojmë pozicionin e tyre në treg, duke rritur besimin për të operuar me to. Institucionet e mikrofinancës tashmë japin hua në shuma të vogla për klasën shoqërore me të ardhura të ulëta. Programet e tyre ekzistuese i lejojnë ato të kontrollojnë rrjetin e tyre dhe shtrirjen gjeografike për të ndihmuar dërguesit e remitancave dhe përfituesit e tyre për të pasur

lehtësi hyrëse në shërbimet financiare me kosto të ulët, si dhe lehtësi hyrje në produkte mikrokursimi dhe investimi.

Drejtimi i tretë i përpjekjeve ka të bëjë me kanalizimin e remitancave të emigrantëve drejt nevojave të vendit për zhvillim. Formalizimi është një hap i nevojshëm, por nuk siguron rolin e remitancave si një instrument zhvillimi. Shpesh pretendohet se emigrantët nuk janë klientët më të preferuar të bankave, pasi kjo kategori konsiderohet se ka më shumë punë të paqëndrueshme dhe nivel të ulët të ardhurash. Para së gjithash, ky konceptim nuk është plotësisht i saktë dhe rezultatet e ekipit italian mbështesin faktin se grumbullimi i kursimeve të emigrantëve po bëhet mjaft i rëndësishëm për t'u shndërruar në një biznes fitimprurës. Banka Italiane e Zhvillimit, që ka hyrë kohët e fundit në tregun shqiptar është një dëshmi tjetër e këtij realiteti. Megjithatë, do të doja që sa më shpejt edhe bankat e tjera që operojnë në Shqipëri të jenë po aq agresive sa bankat italiane në konkurrimin për këtë grup kursimesh. Ka edhe shërbime të tjera financiare që mund të ofrohen për përfituesit e remitancave. Për shembull, lidhja e remitancave me investimet, duke kanalizuar flukset e remitancave drejt projekteve apo huave të mikrokredisë; ose duke mbështetur kontributin e emigrantëve dhe komunitetet e emigrantëve në zhvillimin e vendit.

Nga analiza jonë ka dalë një sinjal shqetësues, që tregon synimin e ulët të emigrantëve për të investuar në sipërmarrje private dhe/apo në projekte publike për zhvillim. Kjo na tregon se çështja e remitancave shkon përtej kuadrit financiar. Prandaj, ne duhet të gjejmë rrugë të reja për të përmirësuar motivimet ndaj emigrantëve që ata të investojnë në Shqipëri, siç është edhe iniciativa e ndërmarrë kohët e fundit nga qeveria për t'u ofruar emigrantëve mundësinë që të kthehen dhe të investojnë në vendin e tyre, duke u përjashtuar për një periudhë trevjeçare nga tatimi mbi fitimin dhe mbi të ardhurat personale.

Si përfundim, do të shtoja se një tipar i dallueshëm, që i bën remitancat një instrument veçanërisht të rëndësishëm për zhvillimin ekonomik, është stabiliteti i tyre relativ, krahasuar me flukset private financiare dhe të kapitalit. Ndryshe nga flukset financiare që treguan një luhatshmëri të lartë gjatë viteve `90, remitancat vazhdojnë të rrjedhin në mënyrë shumë më të qëndrueshme. Në drejtim të kohëzgjatjes së "ciklit të jetës" të remitancave individuale, teoria tregon se sa më i gjatë të jetë vazhdimi i statusit të emigrantit, aq më i ulët është probabiliteti për flukse të mëdha remitancash. Kjo na shtyn që të përshpejtojmë përpjekjet tona për të shfrytëzuar potencialin e remitancave sa më shpejt të jetë e mundur. Roli i tyre i rëndësishëm kërkon rrugë të reja për arritjen e një rritjeje të qëndrueshme, formalizim të plotë dhe efektivitet më të lartë të remitancave. Duket qartë se kjo nuk është një betejë të cilën mund ta fitojmë sot. Ajo kërkon shumë vëmendje, vullnet të mirë, por edhe një strategji të plotë realizimi.

Faleminderit!

FJALA E GUVERNATORIT TË BANKËS SË SHQIPËRISË, Z.ARDIAN FULLANI

në takimin me Kryeministrin e Republikës së Shqipërisë dhe Shoqatën e Bankave
Tiranë, 20 mars 2006

I nderuar zoti Kryeministër,

Të nderuar bankierë,

Besoj se qëllimi i takimit të sotëm ka të bëjë me një problem madhor, atë të rritjes së qëndrueshme afatgjatë ekonomike të vendit. Të gjithë aktorët e pranishëm në këtë sallë kanë një rol-kyç në këtë drejtim, prandaj mendoj se takime të tilla janë të dobishme, me kontribute të prekshme në aktivitetin ekonomik të vendit.

Fillimisht, dëshiroj të theksoj se gjatë vitit 2005 ekonomia shqiptare pati zhvillime pozitive në këtë drejtim.

- Politika monetare, duke qëndruar neutrale për pjesën më të madhe të vitit ka siguruar një furnizim konstant të ekonomisë me para, në përputhje me nevojat për zhvillimin ekonomik të vendit;
- Presionet inflacioniste mbetën nën kontroll në kushtet e një stabiliteti më të qëndrueshëm të kursit të këmbimit;
- Në fund të vitit, kushtet monetare reflektuan zgjerimin e financimit të ekonomisë me kredi ndërkohë që rezervat valutore të Bankës së Shqipërisë u rritën më tej;
- Sistemi bankar rriti në mënyrë të konsiderueshme mbështetjen e tij financiare për ekonominë në formën e kredisë bankare. Portofoli i kredisë u rrit me 74 për qind ose 52 miliardë lekë në vlerë absolute. Në fund të vitit, teprica e kredisë shënoi 14,6 për qind të PBB-së nga 8.4 për qind në vitin 2004. Po kështu, në programin afatmesëm të zhvillimit ekonomik të vendit, për vitin 2006 është parashikuar një rritje e mëtejshme e tepricës së kredisë në masën 50 për qind, që do thotë stimuj të mëtejshëm për aktivitetin ekonomik të vendit. Kjo ka bërë që biznesi vendas të ketë garanci më shumë për të investuar në ekonomi, duke ftuar njëkohësisht edhe investitorët e huaj për më shumë investime të huaja direkte në Shqipëri.

Me cilësinë e guvernatorit, jam i detyruar të ndaj me ju një shqetësim të natyrshëm që zakonisht lidhet me cilësinë e portofolit të kredive, veçanërisht kur përballemi me situata të rritjes kaq të shpejtë të aktivitetit kreditues. Edhe pse teprica e kredisë për ekonominë është ende e ulët, rreth 15 për qind të PBB-së, një ekspansion i ngjashëm gjatë vitit 2006 me atë të vitit të kaluar, do të rriste potencialin e ekspozimit të bankave ndaj rreziqeve që lidhen me cilësinë e portofolit të kredive.

Për këtë qëllim, nga ana e sistemit bankar duhet të merren të gjitha masat për të përmirësuar kapacitetet monitoruese, analizuese dhe kontrolluese me

synim shmangien e një përkeqësimi të mundshëm të portofolit të kredive. Nga ana tjetër, ne do të forcojmë kapacitetet tona mbikëqyrëse, sidomos inspektimin në vend duke ndërtuar plane masash, të cilat do të synojnë një kontroll të kujdesshëm për çdo bankë anëtare të sistemit. Theks i veçantë do t'i vihet kontrollit të praktikave të veçanta të kredidhënies si dhe shqyrtimit të riklasifikimeve të bëra dhe ecurisë së provigjonimit për kreditë me probleme. Për më tepër, Banka e Shqipërisë në prioritetet e saj për vitin 2006 ka përfshirë dhe projektin e krijimit të regjistrit të kredive, një lehtësi kjo që do të ndihmojë procesin e kontrollit dhe verifikimit të kredikërkuesve.

Dua t'ju siguroj se për ne, qëndrueshmëria e sistemit bankar është prioritet i rëndësisë së veçantë, prandaj mbetemi të angazhuar në zbatimin me përpikmëri të rekomandimeve të lëna nga raporti i Vlerësimit të Sektorit Financiar (FSAP) të FMN-së gjatë vitit 2005.

Koncepti bankë mendoj se është i lidhur në mënyrë të pashmangshme me konceptin e besimit. Dhe për mua besimi është transparencë, transparencë dhe vetëm transparencë. Unë gjykoj se rritja e transparencës është kusht parësor që çon në shtimin e aksesit të popullatës në biznesin tuaj. Kjo rritje nënkupton shtim të depozitave, zgjerim të kreditit, konkurrencë më të madhe dhe ndërmjetësim financiar më efektiv. Mbi të gjitha, rritja e transparencës do të thotë më shumë oportunitete, kosto më të ulura nga ana e klientelës.

Mendoni për një moment se sasia e parasë që qarkullon dhe fle jashtë kanaleve bankare është ende shumë e madhe. Duke iu kthyer diskutimit tim në takimin e fundit të organizuar nga Banka Botërore dhe Rajoni i Pulias dëshiroj të theksoj se më shumë se gjysma e remitancave hyjnë në vend nëpërmjet kanaleve jozyrtare. Sipas statistikave të bilancit të pagesave të vitit 2005, bëhet fjalë për një potencial afër shifrës 700 - 800 milionë euro. Besoj se ky fakt nuk ka nevojë për koment. Nga vrojtimet e bëra prej nesh shkaqet janë të ndryshme. Megjithatë, motivimi i pakët për përdorimin e sistemit bankar ndërmjet të tjerash si shkak të rëndësishëm ka aplikimin e komisioneve relativisht të larta.

Nga ana tjetër, shtimi i qarkullimit monetar nëpërmjet kanaleve bankare kërkon rritjen e kujdesit për parandalimin e pastrimit të parave dhe të financimit të terrorizmit. Lufta për parandalimin e pastrimit të parave është një sfidë e vazhdueshme që lidhet me problemet madhore me të cilat po përballet ky vend siç janë: ekonomia *cash*, evazioni fiskal dhe informaliteti në ekonomi. Për këtë arsye, në fillim të vitit ne kryem një inspektim të pjesshëm në 7 banka. Nga kontrolli rezultoi se në përgjithësi, bankat kanë strukturat dhe politikat e duhura për luftën kundër pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit. Megjithatë, ne konstatuam dhe mangësi që kishin të bënin me trainimin e stafit dhe njohjen më të mirë të kuadrit rregullativ.

Duke marrë shkas nga çfarë thashë më sipër, besoj se e kuptoni që mesazhi që dua të përcjell tek ju sot, është jo vetëm shtimi i biznesit bankar, por edhe kontributi i prekshëm në drejtim të reduktimit të *cash*-it në ekonomi dhe për rrjedhim, zvogëlimi i informalitetit në ekonomi.

Kohët e fundit kemi hedhur hapa konkretë në këtë drejtim. Si rrjedhim, sistemi bankar është më i shtrirë gjeografikisht dhe më i pasur me produkte. Rritja e aktiveve, shtimi i klientelës, infrastruktura moderne e pagesave si dhe zhvillime të tjera, kanë bërë që kontributi ynë në reduktimin e *cash*-it në ekonomi të jetë i prekshëm. Besoj se arritjet e mësipërme të kombinuara me masa të vendosura administrative, do të kontribuojnë në mbylljen një nga një të portave të informalitetit në ekonomi. Gjithsesi, konstatoj se ka hapësira të pashfrytëzuara veçanërisht në drejtim:

- të rritjes së oportuniteteve për më shumë pagesa elektronike; viti i fundit përmbysi raportin në favor të pagesave elektronike kur niveli i tyre arriti shifrën 320 mijë në krahasim me numrin prej 300 mijë të pagesave në sportel. Kjo është një shenjë inkurajuese që na nxit të fokusohemi më mirë në këtë drejtim;

- të kanalizimit masiv të likuidimit të detyrimeve periodike për shërbimet utilitare nëpërmjet llogarisë bankare; më konkretisht, KESH, Albtelekom dhe Ujësjellësi duhet të lidhen me sistemin bankar për të likuiduar në mënyrë elektronike shërbimet e tyre;

- të transferimit të detyruar të pagave të punonjësve të sektorit privat nëpërmjet sistemit bankar; eksperienca e deritanishme me sektorin publik rezultoi e suksesshme, ndërkohë që edhe disa nga operatorët e mëdhenj privatë janë duke aplikuar këtë metodë me eficiencë. Mendoj se detyrimi për të transferuar pagat në sistemin bankar do të ulë ndjeshëm dhe evazionin që ekziston në lidhje me tatimin nga të ardhurat dhe kontributet e sigurimeve shoqërore.

Unë personalisht mendoj se ka ardhur koha për të rritur popullaritetin, për të imponuar krijimin e një edukate dhe kulture bankare. Detyrimi i çdo individi për çeljen e një llogarie bankare në shtesë të një shërbimi të rëndësishëm masiv që shteti i bën popullatës, është mëse i nevojshëm. Më konkretisht, propozoj që kartat e reja të shoqërohen me një numër llogarie bankare.

Në përfundim, kuptohet se në mënyrë që të jemi të suksesshëm për periudha të gjata kohe, duhet përqendrim i madh në të gjithë problematikën që shkurtimisht ekspozova më sipër. Më shumë kredi, më shumë kujdes në mbikëqyrjen e saj, më shumë shërbime cilësore, çmime më të lira, më pak *cash* në ekonomi, më shumë biznes bankar, që në fund të fundit do të thotë më shumë akses nga ana e popullatës në biznesin tuaj.

Unë gjykoj se kjo është një prerogativë thelbësore që siguron zhvillimin e qëndrueshëm e afatgjatë të ekonomisë shqiptare.

FJALA E GUVERNATORIT TË BANKËS SË SHQIPËRISË, Z.ARDIAN FULLANI

në leksionin e parë të Serisë së Leksioneve të Bankës së Shqipërisë
Tiranë, 23 mars 2006

Të nderuar zonja dhe zotërinj,

Është një kënaqësi e veçantë që gjendem para jush sot, me rastin e leksionit të parë të Bankës së Shqipërisë, pjesë e një serie leksionesh publike që institucioni ynë synon të realizojë gjatë këtij viti. Përfitoj nga ky rast që të falenderoj Zyrën e GTZ-së në Tiranë si dhe Prof. Michael Bolle dhe Prof. Helge Berger për ndihmën dhe mbështetjen e tyre për realizimin e kësaj serie leksionesh.

Seria e leksioneve publike është pjesë e masave që institucioni ynë po ndërmerr për promovimin dhe inkurajimin e kërkimit shkencor në fushën e zhvillimeve ekonomike, monetare dhe financiare në vendin tonë, në rajon dhe më gjerë.

Leksioni i sotëm shërben për të na kujtuar se Banka e Shqipërisë ka edhe një profil të rëndësishëm kërkimor, përveç profilit të saj operacional të lidhur me përmbushjen e detyrave ligjore që i janë ngarkuar asaj si ruajtja e stabilitetit të çmimeve, mbikëqyrja e sistemit financiar, sigurimi i funksionimit të sistemeve të pagesave apo hartimi i një pjese të rëndësishme të të dhënave statistikore në vend.

Ne jemi të angazhuar seriozisht për përmirësimin e kërkimeve ekonomike brenda Bankës së Shqipërisë duke qenë të vetëdijshëm se pavarësisht arritjeve, në këtë fushë ka ende vend për përmirësim dhe progres të mëtejshëm. Sidoqoftë, unë jam i bindur se për të qenë sa më të suksesshëm në arritjen e këtij objektivi, bashkëpunimi me aktorët e tjerë të interesuar në këtë proces mbetet i një rëndësie thelbësore.

Në këtë kuadër, Banka e Shqipërisë është e interesuar për një intensifikim të bashkëpunimit me fakultetet ekonomike të universiteteve si dhe me qendrat e tjera të specializuara në kërkimet ekonomike në vendin tonë. Ky bashkëpunim, sigurisht që do të mundësojë thithjen e mendimit të specializuar akademik nëpërmjet pjesëmarrjes së stafit të universiteteve në projekte të ndryshme kërkimore së bashku me stafin e institucionit tonë. Në të njëjtën kohë, dëshiroj të shpreh bindjen time se një bashkëpunim më i ngushtë do të siguronte një shfrytëzim optimal të burimeve njerëzore të të dyja palëve dhe do t'i shërbente gjithashtu edhe rivitalizimit të kërkimit shkencor në universitetet tona, gjë për të cilën jemi të gjithë të ndërgjegjshëm që ka shumë nevojë.

Një dimension tjetër të rëndësishëm të bashkëpunimit me institucionet akademike e përbën edhe krijimi i marrëdhënieve më të ngushta me studentët e dalluar të fakulteteve ekonomike në vend, duke synuar nxitjen e interesit të këtyre studentëve për ta përqendruar kualifikimin e tyre të mëtejshëm akademik në çështjet që kanë të bëjnë me bankingun qendror.

Përfitoj nga ky rast për t'ju komunikuar lançimin e projektit të "Çmimit të Guvernatorit – Governor's Award". Ky projekt konsiston në zhvillimin e një konkursi të hapur, ku të gjithë studentët e interesuar mund të konkurojnë me temat e tyre të diplomës, që fokusohen në çështje të lidhura me fushën e veprimtarisë së Bankës së Shqipërisë. Temat më të mira të diplomës do të përzgjidhen nga një komision i posaçëm dhe për to do të ketë edhe shpërblime materiale.

Unë shpreh besimin tim se këto nisma të Bankës së Shqipërisë do të mirëpriten nga komuniteti akademik dhe ai studentor dhe së bashku me angazhimin serioz të stafit të Bankës së Shqipërisë, do të kontribuojnë në arritjen e objektivit madhor të përmirësimit të kërkimeve ekonomike në vendin tonë.

Ju faleminderit!

FJALA E GUVERNATORIT TË BANKËS SË SHQIPËRISË, Z.ARDIAN FULLANI

në takimin me komunitetin e biznesit, pushtetin lokal, qarqet akademike etj., të Prefekturës së Gjirokastrës
Gjirokastër, 31 mars 2006

Të nderuar pjesëmarrës,

Është një kënaqësi e madhe të ndodhem sot mes jush, përfaqësuesve të pushtetit lokal të Qarkut të Gjirokastrës, sektorit bankar, komunitetit të biznesit dhe akademikëve të Universitetit të Gjirokastrës. Takimi i sotëm është në vazhdim të takimeve që Banka e Shqipërisë ka zhvilluar në rajone të tjera të vendit dhe në linjë me objektivin tonë për të rritur e përmirësuar komunikimin me publikun.

Një bankë qendrore e pavarur duhet të komunikojë me shoqërinë në tërësi në mënyrë të tillë që të krijojë besimin dhe prestigjin e duhur, në kuadër të transparencës, e cila lehtëson procesin e llogaridhënies. Përveç ligjeve dhe rregulloreve të cilat sigurojnë llogaridhënien ndaj organeve të zgjedhura nga populli si parlamenti, një element i rëndësishëm është komunikimi i drejtpërdrejtë me publikun, biznesin dhe qarqet akademike.

Unë besoj se komunikimi i hapur i objektivave, mënyrave dhe mjeteve për arritjen e tyre përmirëson efektivitetin e punës sonë. Duke shmangur paqartësinë e pritshmërive që shkakton përgjithësisht zbatimi i politikave "surprizë", publiku dhe bizneset kthehen nga agjentë që mundohen të minimizojnë kostot e "të papriturave", në bashkëpunëtorë që mbështesin arritjen e objektivave tanë.

Qëllimi kryesor i Bankës së Shqipërisë është arritja dhe ruajtja e stabilitetit të çmimeve. Përcaktimi i qartë i asaj çfarë ne kuptojmë me stabilitet të çmimeve përbën hapin e parë të rëndësishëm në transparencën e komunikimit tonë. Prej kohësh, Banka e Shqipërisë publikon normën e inflacionit që ajo synon me politikën e saj monetare, që aktualisht është 2 deri në 4 për qind në terma vjetorë. Ne po përpiqemi që këtë gjë ta institucionalizojmë më tej, duke shqyrtuar mundësinë e adoptimit të regjimit të inflacionit të shënjestruar (IT), i cili ka në qendër të tij pikërisht shpalljen dhe ndjekjen e një norme të mirëpërcaktuar inflacioni. Por ky regjim i ri është më shumë se thjesht shpallja e normës së inflacionit që banka, siç e përmenda, e ka bërë tashmë. Ai konsiston dhe në njohjen publike të modeleve dhe analizave ku bazohet vendimmarrja jonë si dhe në rritjen e përgjegjësisë dhe transparencës për rastet kur objektivi nuk arrihet. Kjo do t'i japë një mundësi reale publikut dhe biznesit, për të kuptuar mënyrën se si banka reagon ndaj zhvillimeve ekonomike dhe për të gjykuar më saktë politikën e ndjekur. Për këtë qëllim, po punohet në disa fronte që nga përmirësimi i bazës statistikore, përgatitja e modeleve të nevojshme për parashikimin e inflacionit dhe funksionimin e ekonomisë, e deri te baza ligjore e nevojshme që do të bëjnë të mundur zbatimin me sukses të këtij regjimi të ri bashkëkohor dhe transparent.

Filozofitë moderne të qeverisjes së bankave qendrore, i japin një rendësi shumë të madhe komunikimit. Por komunikimi i Bankës së Shqipërisë nuk kufizohet thjesht tek transparenca e politikës monetare për arritjen e stabilitetit të çmimeve. Po aq i rëndësishëm është dhe shkëmbimi i informacionit me agjentë të ndryshëm ekonomikë, për të siguruar sinjalet e nevojshme për parandalimin e krizave të mundshme ekonomike dhe financiare. Në këtë aspekt, marrëdhëniet e rregullta me sistemin bankar dhe bizneset janë të pazëvendësueshme. Këtu mund të përmendim indekset e besimit të biznesit dhe konsumatorit, indekse të cilat po përpunohen në bazë të informacionit të marrë në nivel rajonal.

Tashmë, ne kemi një traditë pozitive të takimeve periodike me bankat e nivelit të dytë për probleme të ndryshme që mund të dalin apo iniciativa të reja që ndërmerren në sektorin bankar. Diskutimet e fundit janë përqendruar kryesisht tek cilësia e kredive me zgjerimin e vrullshëm të aktivitetit kreditues që po karakterizon sistemin bankar. Viti 2005 u shoqërua nga një rritje e shpejtë e kreditimit të ekonomisë. Kjo rritje ka qenë burimi kryesor i përdorimit të fondeve dhe ekspansionit monetar, duke postuar për herë të parë financimin e deficitit buxhetor nga ky rol. Në fund të muajit nëntor, kredia për ekonominë arriti në gati 14 për qind të PBB-së. Vetëm gjatë periudhës korrik-nëntor kredia është rritur me 2.5 pikë përqindjeje ndaj PBB-së, ndërkohë që ritmet e rritjes vjetore të kredisë janë luhatur rreth nivelit 70 për qind. Kredia është kanalizuar në të gjithë sektorët e ekonomisë, duke treguar lidhjen e ngushtë të bizneseve me bankat. Banka e Shqipërisë vlerëson se sistemi bankar deri më sot i ka përballuar këto zhvillime të vrullshme me një shkallë të kënaqshme sigurie. Megjithatë, si autoriteti mbikëqyrës i bankave tregtare, ndjejmë detyrimin të theksojmë se rritja e vëllimit të kredive duhet të jetë në linjë me përmirësimin e kapaciteteve monitoruese të tyre, për të shmangur përkeqësimin e portofolit të kredive. Për këtë arsye, po marrim masa për të iniciuar Byronë e Informacionit të Kredive, që do të kontribuojë shumë në këtë drejtim.

Banka e Shqipërisë vlerëson se stabiliteti monetar dhe ai financiar janë të lidhur në mënyrë të pazgjidhshme. Kur janë premisat për të patur instabilitet financiar, ai ndiqet nga instabiliteti monetar.

Gjerësia e ekonomisë joformale vazhdon të mbetet një problem shqetësues për Shqipërinë. Ajo rrit ndjeshëm rrezikun e investimeve dhe kreditimit. Në këto kushte, formalizimi i ekonomisë mbetet një detyrë parësore në programin e masave të autoriteteve qeveritare, duke patur parasysh ndikimin shumë negativ që ka ajo mbi konkurrencën e ndershme dhe mbi intensitetin e evazionit fiskal. Ekonomia joformale në Shqipëri shfaqet në forma të ndryshme që gjeneron krimin dhe korrupsionin; ekonomi paralele, e cila lulëzon dhe funksionon si pasojë e mungesës së efikasitetit të ekonomisë formale.

Rritja e gamës dhe e cilësisë së shërbimeve bankare, ulja e kostove të këtyre shërbimeve, kryerja e shërbimeve utilitare nëpërmjet sistemit bankar si dhe shoqërimi i kartave të identitetit me llogari bankare dhe me një adresë postare, do të ndikojnë në formalizimin e ekonomisë. Formaliteti është baraz me një llogari bankare.

Bashkëpunimi me sistemin bankar ka qenë i rëndësishëm në përpjekjet tona për reduktimin e ekonomisë së *cash*-it, si pjesë e procesit të formalizimit të ekonomisë si edhe të rritjes së rolit ndërmjetësues që ai duhet të ketë në ekonomi. Futja e pagave në sistemin bankar të punonjësve publikë ka mbaruar, ndërkohë që po mendojmë dhe mënyrat për përfshirjen e sektorit privat. Zbatimi i sistemit elektronik të pagesave të mëdha dhe ai i kryqëzimit të pagesave të vogla, kanë ulur ndjeshëm kostot e transaksioneve financiare ndërmjet bankave. Në këtë kuadër, ne mendojmë gjithashtu se janë të gjitha mundësitë që bankat e nivelit të dytë të rishikojnë shpenzimet që lidhen me shërbimet bankare.

Banka e Shqipërisë në zbatim të politikës së saj për daljen graduale nga roli i ndërmjetësuesit që ajo u ofron individëve për të marrë pjesë në tregun primar të bonove të thesarit, së fundi ka vendosur të mos pranojë *cash* në sportelin e saj në Tiranë. Ky vendim do të shtrihet edhe në sportelet e tjera të Bankës së Shqipërisë, brenda dhjetëditorit të parë të muajit prill.

Keqkuptimet e disa qytetarëve dhe mediave, lidhur me rolin e Bankës së Shqipërisë në procesin e emetimit të bonove të thesarit, e kanë bërë të pashmangshëm adresimin e disa problemeve në lidhje me këtë proces. Do të doja të risqaroja edhe një herë që Banka e Shqipërisë vepron thjesht si agjente e Ministrisë së Financave në emetimin e bonove të thesarit.

Në njërën anë, banka vlerëson rëndësinë që ka pjesëmarrja e drejtpërdrejtë e qytetarëve në këto ankande por, mendojmë se ekzistojnë mënyra më eficiente për të realizuar këtë proces. Një alternativë do të ishte shitja e bonove të thesarit përmes rrjetit të Postës Shqiptare. Ristrukturimi i postës do të kishte përfitime të mëdha jo vetëm për procesin e shitjeve të bonove të thesarit që do të vijë gjithmonë e duke u rritur, por dhe për shumë shërbime të tjera që sistemi bankar mund të mos jetë shumë fleksibël për t'i ofruar, si transfertat e emigrantëve deri në zonat më të thella të vendit.

Lehtësimi i kanaleve të dërgesave nga jashtë është një temë tjetër diskutimi me sistemin bankar. Jashtë bankave sot qarkullojnë sasi të konsiderueshme të parasë. Më shumë se gjysma e dërgesave nga emigrantët hyjnë në vend nëpërmjet kanaleve jozyrtare. Këto të ardhura përbëjnë rreth 14 për qind të Prodhimit të Brendshëm Bruto (PBB), 70 për qind të eksporteve dhe 33 për qind të importeve. Italia dhe Greqia janë destinacionet kryesore ku emigrantët shqiptarë jetojnë e për rrjedhojë, ato janë vendet kryesore prej të cilave kanë origjinën dërgesat nga jashtë. Rritja e mëtejshme e vëllimit të dërgesave dhe efektiviteti i tyre, mbështeten në lehtësimin e shërbimit të transfertave nga sistemi bankar si dhe në përmirësimin e mjedisit të biznesit.

Siç e kam theksuar në një takim të ngjashëm me këtë të sotmin në Shkodër, komunikimi ynë me bizneset është forcuar mjaft nëpërmjet anketimeve që ne realizojmë mbi ecurinë e aktivitetit ekonomik të vendit. Megjithatë, pranoj se deri më tani ky komunikim ka qenë i njëanshëm nga bizneset tek ne. Ka ardhur koha që marrëdhëniet të bëhen të plota. Për këtë arsye, kemi menduar që bizneset të jenë të parat në prezantimin dhe diskutimin e rezultateve

të anketimeve tona. Kjo do të realizohet përmes takimeve periodike në bashkëpunim me dhomat e tregtisë.

Në të njëjtën kohë, këto takime do të shërbejnë si një dritare për marrjen më të drejtpërdrejtë të shqetësimeve aktuale të bizneseve, siç ishin ato të fundvitit të kaluar lidhur me problemet e energjisë. Një pjesë e konsiderueshme e bizneseve u detyruan të punojnë nën kapacitetet prodhuese. Kjo reflektoi në ulje të prodhimit dhe të investimeve. Kufizimi i aktivitetit ekonomik, për shkak të ndërprerjeve të energjisë elektrike, vlerësohet të ketë shkaktuar ritme më të ulëta rritjeje rreth gjysmë pikë përqindje, në krahasim me parashikimet për të. Për të përballuar vështirësitë e mungesës së energjisë, shumica e bizneseve iu drejtua përdorimit të burimeve alternative, të cilat vlerësohet të kenë shkaktuar kosto jo të vogël për aktivitetin e tyre. Afër 57 për qind e bizneseve të intervistuara, pohojnë se rritja e kostos është luhatur nga 10 deri në 30 për qind. Sektori i prodhimit është ai që ka ndjerë më shumë pasojat e krizës energjitike, sepse atij, mbi të gjitha, i është dashur të përballet me kosto më të larta shtesë, për shkak të përdorimit të alternativave të tjera zëvendësuese të prodhimit të energjisë elektrike. Sidoqoftë, bizneset besojnë në një rikuperim të aktivitetit ekonomik, brenda tremujorit të parë të vitit 2006.

Komunikimi i Bankës së Shqipërisë me universitetet e qarqet e ndryshme akademike, përgjithësisht është kufizuar në leksione speciale rreth politikës monetare dhe tregjeve financiare. Duke vlerësuar rëndësinë e këtij komunikimi, ne kemi menduar t'i ngremë marrëdhëniet tona me universitetet në një stad më të lartë partneriteti, përmes përfshirjes së drejtpërdrejtë të studentëve në anketimet dhe analizat që zhvillojnë degët. Ndërkohë, për të nxitur kërkimet shkencore, ne njohëm publikun, për herë të parë javën e kaluar me projektin e "Çmimit të Guvernatorit".

Unë besoj se rritja dhe përmirësimi i komunikimit me të gjitha grupet e interesit, me sistemin bankar, komunitetin e biznesit, pushtetin lokal dhe qarqet akademike, do të ndikojë pozitivisht në arritjen e objektivave tanë të përbashkët, për një ekonomi më të shëndoshë e mirëqenie më të mirë sociale.

Faleminderit!

INVESTIME TË HUAJA DIREKTE. SHËNIME METODOLOGJIKE.*

ABSTRAKT

Njohja e vlerave të Investimeve të Huaja Direkte (IHD) si mjet për nxitjen e investimeve, nënvizon nevojën për matje të saktë dhe statistika të detajuara të IHD-ve për vlerësimin e lidhjes së tyre me rritjen ekonomike si dhe impaktin në sektorë të ndryshëm ekonomikë. Përmes një kuadri gjithëpërfshirës teorik ky material ofron njohjen me konceptet dhe përkufizimet e IHD-ve, përbërësit e tyre, format me të cilat prezantohen e deri tek burimet dhe metodat e mbledhjes së informacionit. Gjithashtu, në të diskutohen mekanizmat institucionalë lidhur me raportimin e të dhënave, të cilët janë thelbësorë në garantimin e cilësisë të të dhënave. Disa probleme në matje janë përmbledhur.

Matja dhe regjistrimi i IHD-ve në vendin tonë ka qenë dhe mbetet një sfidë në arritjen e niveleve bashkëkohore të vendeve të zhvilluara për ofrimin e statistikave cilësore dhe të krahasueshme.

AKRONIME DHE SHKURTIME

IHD	Investim i Huaj Direkt
OECD	Organizata për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim (Organisation for Economic Co-operation and Development)
FMN	Fondi Monetar Ndërkombëtar
PNI	Pozicioni Ndërkombëtar i Investimeve
BP	Bilanci i Pagesave
SPK	Sistemi Plotësisht i Konsoliduar
M&A	Shkrirje dhe Përvetësim (Mergers and Acquisitions)
SPE	Njësitë për Qëllime të Veçanta (Special Purpose Entities)
ITRS	Sistemi i Raportimit të Transaksioneve me Jashtë (International Transactions Reporting System)
BSH	Banka e Shqipërisë

1. HYRJE

Roli i Investimeve të Huaja Direkte (IHD) në zhvillimin ekonomik të një vendi është debatuar gjerësisht, shoqëruar me qëndrime pro dhe kundër. Shumë vende i kanë mirëpritur IHD-të si një kontribut thelbësor në proceset e zhvillimit dhe të lehtësimit të hyrjes në ekonominë botërore, duke i vlerësuar në një kontekst të gjerë reformash strategjike për ristrukturim ekonomik dhe zhvillim.

Studime empirike pranojnë rolin e IHD-ve në rritjen ekonomike dhe zhvillimin e vendeve pritëse, sidomos për ekonomitë në zhvillim. Gjatë dhjetëvjeçarit të fundit fluksi i investimeve të huaja direkte ka luajtur një rol të rëndësishëm

në rritje të produktivitetit, të prodhimit, të punësimit dhe të eksporteve të ekonomive në tranzicion.

Edhe në kontekstin e ekonomive në tranzicion drejt një ekonomie tregu dhe në prirjet e integrimit ekonomik dhe globalizimit, zgjerimit të flukseve ndërkombëtare të kapitalit, lëvizjes së lirë të individëve, të mallrave e shërbimeve dhe të zhvendosjes së teknologjive, investimet e huaja janë parë me përparësi në të mirë të ekonomisë në tërësi.

Efekte të shumta pozitive lidhen me këto transferta të kapitalit, të cilat i dallojnë ato dukshëm nga forma të tjera të flukseve private të kapitalit. Importimi i teknologjive të reja dhe i strategjive të drejtimit, ofrimi i lehtësive hyrëse në tregjet financiare ndërkombëtare, janë ndër përparësitë gjerësisht të pranuara lidhur me investimet e huaja direkte. Veç kësaj, IHD është gjithashtu i prirur të jetë relativisht një angazhim i qëndrueshëm afatgjatë në interes të kompanisë së huaj. Të gjitha këto së bashku janë të dobishme për rritjen ekonomike të vendeve pritëse dhe për pakësimin e rrezikut nga jashtë. Në këto kushte, deficitet e larta korente janë më të qëndrueshme për sa kohë ato financohen në masën më të madhe nga IHD, në vend të huamarrjes bankare ose investimeve të portofolit, të cilat së bashku njihen të jenë tepër të paqëndrueshme.

IHD janë një tregues kritik edhe për integrimin e Shqipërisë në ndarjen globale të punës si dhe për nivelin e përgjithshëm të zhvillimit. Megjithatë, analizat e procesit të integrimit kërkojnë procedura të harmonizuara në hartimin dhe shpërndarjen e tyre.

Në Shqipëri, përveç përparësisë për hartimin e një kuadri institucional për nxitjen e investimeve të huaja në vend, një domosdoshmëri e kohës është matja e saktë e tyre.

Në përputhje me standardet ndërkombëtare, IHD vlerësohen si për stokun ashtu edhe për flukset e kapitalit që sjellin në ekonomi. Ndërsa stoku jep informacion për shkallën e prezencës së një firme apo një vendi në një ekonomi të huaj, fluksi i IHD-ve përdoret për vlerësimin e qëndrueshmërisë së zhvillimeve të bilancit të pagesave.

Investimet e Huaja Direkte nga këndvështrimi i Bilancit të Pagesave dhe i Pozicionit Ndërkombëtar të Investimeve ndajnë të njëjtët kuadër konceptualë të përcaktuar nga Fondi Monetar Ndërkombëtar. Në këtë kontekst, Bilanci i Pagesave është një paraqitje statistikore e cila në mënyrë sistematike dhe për një periudhë të caktuar kohore, pasqyron transaksionet ekonomike të një ekonomie me pjesën tjetër të botës (transaksionet ndërmjet rezidentëve dhe jorezidentëve) dhe Pozicioni Ndërkombëtar i Investimeve përpilon për një ditë të caktuar, siç është dita e fundit e vitit, vlerën e stokut për secilin mjet dhe detyrim financiar të përcaktuar në përbërësit standardë të bilancit të pagesave.

Më poshtë, kemi një pamje të përgjithshme të bilancit të pagesave në nivel makroekonomik. IHD ndodhen në kategorinë e detyrimeve, meqë ato përfaqësojnë pronësinë e huaj në kontrollin e kompanisë, në një vend të

caktuar. Në krahasim me huamarrjen bankare ose me investimet e portofolit jashtë, IHD janë përgjithësisht më të qëndrueshme.

Grafik 1. Bilanci i Pagesave dhe IHD.



Materiali është organizuar si në vazhdim: seksionet 2, 3 dhe 4 japin një përmbledhje të përkufizimeve, koncepteve dhe të rekomandimeve të pranuara nga FMN (në Manualin e Bilancit të Pagesave – Botimi i 5-të) dhe nga OECD – "Benchmark Definition of Foreign Direct Investment (1996)" mbi Investimin e Huaj Direkt. Të dyja këto botime ofrojnë një udhërrëfyes operacional si dhe standarde të detajuara për regjistrimin e flukseve dhe stokut që lidhen me IHD-të. Seksioni 5 trajton dhe përshkruan format e investimit direkt, të hasura më shpesh si dhe raste të veçanta, të cilat kërkojnë plotësimin e disa kushteve për t'u klasifikuar si IHD. Identifikimi dhe njohja e formave të IHD-ve janë të rëndësishme për hartimin e statistikave të investimeve të huaja direkte në përputhje me standardet. Në seksionin 6 përshkruhen mënyra të ndryshme të mbledhjes së të dhënave për statistikat e IHD-ve. Zgjedhja ndërmjet metodave të ndryshme për sigurimin e informacionit është vendimtare për shkallën e saktësisë të statistikave të IHD-ve si dhe në zbatimin e standardeve ndërkombëtare.

2. ÇFARË ËSHTË NJË INVESTIM I HUAJ DIREKT?

Koncepti i IHD ka pësuar ndryshime në vite. Historikisht, një kufi i caktuar pjesëmarrjeje me kapital dhe ideja që investitori planifikon të shfaqë influencë kontrolli në kompani, kanë qenë ngushtësisht të lidhura me kuptimin e IHD.

Me qëllim harmonizimin e dallimeve në konceptin e IHD-ve, OECD dhe FMN kanë zhvilluar një përcaktim të përbashkët: "...investimi i huaj direkt reflekton qëllimin e sigurimit të një interesi të qëndrueshëm nga një njësi rezidente e një ekonomie (investitor direkt) në një njësi rezidente të një tjetër ekonomie (ndërmarrje e investimit direkt)". "Interesi i qëndrueshëm" nënkupton ekzistencën e një marrëdhënieje afagjatë ndërmjet investitorit direkt dhe ndërmarrjes së investimit direkt si dhe një shkallë të rëndësishme influence në drejtimin e kësaj të fundit (OECD 1999, shtojca IV, fq.88).

Përkufizimi i mësipërm në vetvete nuk specifikon se çfarë përbën në të vërtetë një interes të qëndrueshëm. Megjithatë, ky i fundit vihet në dukje në zbatimin e rekomandimeve të OECD-së. OECD rekomandon "....një pjesëmarrje reale në drejtim, si tregues i pronësisë në të paktën 10%, nënkupton që investitori direkt ndikon ose merr pjesë në drejtimin e ndërmarrjes; ajo nuk kërkon kontroll absolut nga investitori i huaj[1]...". Në përputhje më këtë, marrëveshjet e pashoqëruara me zotërimin e të paktën 10%, por që lejojnë ushtrimin e kontrollit (si për shembull, nënkontraktimet, licencat dhe eskluzivitetet) nuk përfshihen në përkufizimin e OECD-së dhe FMN-së.

Investimi direkt përfshin së bashku transaksionin fillestar për vendosjen e marrëdhënies ndërmjet investitorit dhe ndërmarrjes, dhe të gjitha transaksionet kapitale pasuese ndërmjet tyre dhe ndërmjet filialeve, pavarësisht formës ligjore në të cilën janë regjistruar – si persona juridikë apo persona fizikë. Duhet patur parasysh që transaksionet kapitale të cilat nuk iniciojnë asnjë marrëveshje të mirëfilltë, për shembull, një ndërkëmbim i aksioneve ndërmjet kompanive simotra, duhet gjithashtu të regjistrohet në BP dhe PNI.

Botimi i Pestë i Manualit të Bilancit të Pagesave të FMN-së përcakton si investitor direkt pronarin e 10% ose më shumë të kapitalit të një kompanie. FMN rekomandon përdorimin e kësaj përqindjeje si kufi ndarjeje ndërmjet investimit direkt dhe investimit të portofolit si pjesëmarrje në aksione. Kështu, kur një jorezident, i cili nuk ka pjesëmarrje të mëparshme në kapitalin e një ndërmarrjeje rezidente, blen 10% ose më shumë aksione të kësaj ndërmarrjeje, çmimi i aksioneve të siguruara duhet të regjistrohet si investim direkt. Nga ky moment, transaksionet e kapitalit të mëpastajme ndërmjet këtyre dy kompanive duhet të regjistrohen si investim direkt. Në rastet kur një jorezident zotëron më pak se 10% të aksioneve të një ndërmarrjeje si investim portofoli, dhe më pas siguron (blen) aksione shtesë duke kaluar kështu në një pozicion investimi direkt (10% ose më shumë), si investim direkt në bilancin e pagesave do të regjistrohet vetëm blerja e aksioneve shtesë. Në këtë rast, titujt e siguruar më parë nuk duhet të riklasifikohen nga investim portofoli në investim direkt në bilancin e pagesave, por për vlerën totale të titujve duhet të këtë një riklasifikim në Pozicionin Ndërkombëtar të Investimeve.

Termat "investitor direkt" dhe "ndërmarrje e investimit direkt", FMN-ja dhe OECD-ja i përkufizon kështu: Një investitor direkt mund të jetë individ, person juridik[2], person fizik[3], ndërmarrje publike, një qeveri, një grup individësh ose një grup personash juridikë dhe/ose personash fizikë, të cilët zotërojnë një ndërmarrje investimi direkt, me aktivitet në një vend jashtë vendit të rezidencës së investitorit direkt. Një ndërmarrje investimi direkt është një person juridik apo person fizik, në të cilën një investitor i huaj ka në pronësi 10% ose më shumë të aksioneve ose të fuqisë votuese të një shoqërie tregtare ose ekuivalentin te një ortakëri.

Ndërmarrjet e investimit direkt mund të jenë filiale[4], shoqëri simotra ose degë. Një filial është në vetvete një shoqëri tregtare në të cilën investitori i huaj kontrollon direkt ose indirekt (nëpërmjet një tjetër filiali), më shumë se 50% të fuqisë votuese në aksione. Një shoqëri simotra, është një kompani në të cilën investitori direkt dhe filialet e tij kontrollojnë ndërmjet 10-50% të fuqisë votuese. Një degë (shoqëritë e kontrolluara) është një kompani me pronësi totale ose bashkërisht të huaj. Duhet theksuar që zgjedhja ndërmjet krijimit të një nga formave të lartpërmendura në një shtet të huaj, varet mbi të gjitha nga baza rregullative e vendit pritës (në disa raste edhe nga baza rregullative e vendit të origjinës).



Boks 1. Investimet e huaja direkte në legjislacionin shqiptar.

Bazuar në kuadrin ligjor shqiptar, ndërmarrje të investimit direkt mund të jenë personat juridikë (ligji nr. 7638, datë 19.11.1992 "Për shoqëritë tregtare") dhe personat fizikë (neni 2 i ligjit nr. 7632, datë 4.11.1992 "Për dispozitat që rregullojnë pjesën e parë të kodit tregëtar)".

Personat juridikë janë në formën e përcaktuar në nenin 2 të ligjit nr. 7638, datë 19.11.1992 "Për shoqëritë tregtare": shoqëritë kolektive, shoqëritë komandite, shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar dhe shoqëritë anonime, të cilat fitojnë personalitetit juridik me regjistrimin e tyre në gjykatë.

Një formë tjetër e këtyre ndërmarrjeve mund të konsiderohet edhe shoqëria e thjeshtë, forma e të cilës përcaktohet në nenin 1074 të Kodit Civil dhe në vazhdim. Në bazë të nenit 1075 të Kodit Civil, shoqëria është e thjeshtë kur nuk paraqitet në cilësitë dalluese të shoqërisë tregtare, të rregulluara në ligjin nr. 7638 të lartpërmendur. Dallimi kryesor ndërmjet tyre është se pavarësisht emërtimit të saj me termin "shoqëri", ajo nuk ka personalitet juridik pasi është një kontratë me të cilën dy a më shumë persona merren vesh për të ushtruar aktivitet ekonomik, me qëllim që të ndajnë fitimet që rrjedhin prej tij.

Format e zotërimit të aksioneve në rastin e shoqërive tregtare janë filiali (neni 217), shoqëritë pjesëmarrëse apo simotra (neni 218) dhe shoqëritë e kontrolluara.

Investimi ditrekt i huaj në këto shoqëri në bazë të ligjit "Për shoqëritë tregtare" mund të kryhet:

- *me pjesëmarrje në kapitalin themeltar që në krijimin e shoqërisë;*
- *me transferim të pjesëve të kapitalit themeltar në përputhje me kërkesat e këtij ligji në rastin e çdo forme të shoqërive tregtare (për shembull, nenet 23, 33, 45, 47 etj.);*
- *me zmadhim të kapitalit;*
- *në raste të bashkimit ose të ndarjes (neni 243) dhe në vazhdim.*

Në rastet e shoqërive të thjeshta, bazuar në nenin 1076, investimi direkt mund të kryhet kur në kontratë parashikohet që anëtarët e saj do të kontribuojnë në pjesë jo të barabarta me para, sende apo shërbime (neni 1074).

Në rastin e shitblerjes së tokës nga rezidentët shqiptarë, bazuar në legjislacionin shqiptar dhe në kuptimin e investimit direkt të lartpërmendur, personat fizikë a juridikë të huaj që kryejnë ose kanë kryer investime në territorin e Republikës së Shqipërisë, në përputhje me ligjin nr.7764 , datë 2.11.1993 "Për investimet e huaja", kanë të drejtë të blejnë truall për investime, pronë shtetërore ose private, ose truallin e investimeve të kryera ose në kryerje e sipër. Personave fizikë a juridikë të huaj iu lind e drejta të blejnë truall pasi të kenë arritur kryerjen e investimit në përputhje me lejen e ndërtimit, deri në një vlerë jo më të vogël se tre herë vlera e truallit, sipas përcaktimit të Këshillit të Ministrave (Neni 5 i ligjit nr. 7980, datë 27.07.1995 "Për shitblerjen e trojeve".).

Pasi janë bërë pronarë të truallit sipas kushteve të mësipërme, atëherë kemi të bëjmë me transferimin e pronësisë një njësie rezidente imagjinare. Personi fizik a juridik i huaj (jorezidenti) si pasojë ka një investim financiar në këtë njësi rezidente (përveç investimit të kryer mbi truall), e cila presupozohet të jetë një ndërmarrje me investim direkt.

Duhet përmendur që në rastet e bankave filiale (institucione depozituese) dhe filialeve të ndërmjetësimeve financiare si agjentë të letrave me vlerë, transaksionet e regjistruara nën investime direkte, janë të shoqëruara me borxh të vazhdueshëm (dhënie hua e kapitalit duke përfaqësuar një interes të qëndrueshëm) dhe me investim kapital (kapitali aksionar) ose, në rastin e degëve, me mjete fikse. Depozitat, huatë dhe të tjera pretendime dhe detyrime të lidhura me transaksionet e zakonshme bankare të institucioneve depozituese dhe të të tjerëve ndërmjetësues financiarë, janë të klasifikuara nën zërat "investime portofoli" ose "investime të tjera", dhe jo si investim direkt. Gjendja (stoku) e mjeteve dhe e detyrimeve të huaja të bankave dhe ndërmjetësve të tjerë financiarë, duhen trajtuar paralelisht.

Për marrëdhëniet e investimit direkt OECD, rekomandon zbatimin e "sistemit plotësisht të konsoliduar" (shih boksin më poshtë). Me fjalë të tjera, kjo nënkupton përcaktimin e marrëdhënieve në rastet e një pjesëmarrjeje të përshkallëzuar. Kështu, ndërmarrjet e investimit direkt të cilat janë në një marrëdhënie investimi direkt me një investitor direkt gëzojnë, gjithashtu, një marrëdhënie të tillë me njëra - tjetrën (boks 2.) Ky kriter nuk korrespondon me konceptin e konsolidimit në bilancet kontabile.

Boks 2. Sistemi Plotësisht i Konsoliduar (Fully Consolidated System).

Sistemi Plotësisht i Konsoliduar (SPK) përfshin:
- *Degët.*
- *Filialet (më shumë se 50% pronësi direkte nga investitori direkt) për shembull, A dhe K.*
- *Shoqëritë simotra (10% - 50% pronësi direkte nga investitori direkt) për shembull, D dhe F.*
- *Filialet e filialeve për shembull, B dhe L.*
- *Filialet e shoqërive simotra për shembull, E.*
- *Shoqëritë simotra të filialeve për shembull, C.*

Në skemën e mësipërme, ndërmarrjet A, B, C, D, E, F, K dhe L janë të gjitha të ndërlidhura me ndërmarrjen N – edhe pse për shembull, kompania N zotëron në mënyrë indirekte vetëm 4% të kompanisë C.



SPK përjashton:
- *Ndërmarrjet në të cilat investitori direkt zotëron më pak se 10% për shembull, H.*
- *Ortakëritë e atyre ndërmarrjeve ku investitori direkt zotëron më pak se 10%, për shembull, J.*
- *Ortakëritë e ortakërive të investitorit direkt, për shembull, G.*

Në shembullin e mëposhtëm:
- *Ndërmarrjet H dhe J nuk janë në marrëdhënie investimi direkt me ndërmarrjen N, sepse kjo e fundit zotëron më pak se 10% të ndërmarrjes H.*
- *Ndërmarrja G nuk është marrëdhënie investimi direkt me ndërmarrjen N, sepse ndërmarrja G është ortake e ortakes së N.*

Kujtojmë se, nëse një ndërmarrje ka një marrëdhënie investimi direkt me N, ajo është gjithashtu, në marrëdhënie investimi direkt me të gjitha ndërmarrjet e tjera që kanë një lidhje të tillë me N. Për shembull, C ka marrëdhënie direkte me A, B, D, E, F, K, dhe L, ashtu si edhe me N.

Një përfundim i rëndësishëm i këtij rregulli është se të dhënat e IHD-ve duhet të përfshijnë të gjitha transaksionet/pozicionet direkte ndërmjet ndërmarrjeve në ekonomi të ndryshme, të cilat kanë marrëdhënie investimi direkt - duke përfshirë këtu edhe ndërmarrjet që kanë të njëjtin investitor direkt, por që nuk kanë lidhje pronësie me njëra-tjetrën.

3. KLASIFIKIMI I INVESTIMIT DIREKT, PËRBËRËSIT DHE SHPËRNDARJA SEKTORIALE.

Klasifikimi i investimit direkt bazohet së pari, në drejtimin e investimit – si për mjetet ashtu edhe për detyrimet; së dyti, në instrumentet e përdorura për investimin (aksione, hua etj.) dhe së treti, në shpërndarjen sektoriale.

Sipas drejtimit, ai shqyrtohet nga këndvështrimi i vendit të origjinës dhe i vendit pritës. Nga këndvështrimi i vendit të origjinës, çdo financim jashtë kufijve i bërë nga kompania-mëmë rezidente për filialet e saj jorezidente, përfshihet si investim direkt jashtë. Në të kundërt, çdo financim jashtë kufijve nga filialet, shoqëritë simotra dhe degët jorezidente për kompaninë-mëmë rezidente, klasifikohet si një rënie në investimet direkte jashtë, dhe jo si një investim i huaj direkt. Nga këndvështrimi i vendit pritës, financimet e ndërmarra nga kompanitë mëma jorezidente për filialet, për shoqëritë simotra dhe për degët e tyre rezidente do të regjistrohen, në vendin e rezidencës së kompanisë së varur, nën zërin investime të huaja direkte dhe financimet e ndërmarra nga filialet, shoqëritë simotra dhe degët rezidente për kompanitë e tyre mëma jorezidente, do të klasifikohen si një zvogëlim i investimeve të huaja direkte dhe jo si një investim direkt jashtë.

Sipas instrumenteve, kapitali i investimit direkt përfshin kapitalin e siguruar (direkt ose nëpërmjet ndërmarrjeve të lidhura) nga një investitor direkt tek ndërmarrja e investimit direkt dhe kapitalin e pranuar nga një investitor direkt nga një sipërmarrje e investimit direkt. Në transaksionet e kapitalit të një investimi direkt dallojmë tre përbërës bazë: (i) Kapitali i themelimit: përfshirë kapitalin në degë, të gjitha aksionet në filiale dhe shoqëritë simotra, dhe të tjera kontribute kapitali si makineritë etj. (ii) Fitimet e riinvestuara: përbëhen nga përqindja e investitorit direkt (proporcionalisht sipas pjesëmarrjes në kapitalin e nënshkruar) në fitimet e pashpërndara si dividentë, nga filialet, shoqëritë simotra dhe fitimet e degëve jo të dërguara tek investitori direkt. Nëse këto fitime nuk janë të identifikuara, me marrëveshje fitimi i të gjitha degëve do të konsiderohet si i shpërndarë. (iii) Kapitale të tjera të investimit direkt (ose transaksionet e borxhit ndërmjet kompanive): mbulojnë huamarrjen

dhe huadhënien e fondeve, duke përfshirë letrat e borxhit dhe kreditë tregtare, ndërmjet investitorit direkt dhe sipërmarrjes së investimit direkt si dhe ndërmjet dy ndërmarrjeve të investimit direkt që ndajnë të njëjtin investitor direkt. Siç është përmendur edhe më sipër, depozitat dhe huatë ndërmjet institucioneve të varura depozituese regjistrohen si investime të tjera dhe jo si investim direkt.

Një shpjegim më specifik lidhur me përkufizimin dhe përllogaritjen e flukseve të IHD-ve për bilancin e pagesave dhe stokut për PNI do ta gjeni në boksin bashkëngjitur (boks 3.).

Boks 3. Përkufizimi dhe përllogaritja e fluksit dhe stokut të IHD-ve.

Në përcaktimin e fluksit të investimeve të huaja direkte, për periudhë raportuese në bilancin e pagesave, përfshihen:

- *për filialet dhe kompanitë simotra:*

(i) pjesa e investitorit direkt në fitimet e riinvestuara (fitimet e mbartura për vitin pasardhës dhe fitimet e vitit ushtrimor – të cilat nuk janë ndarë si dividentë). Kjo pjesë përcaktohet proporcionalisht në bazë të aksioneve përkatëse të aksionerëve direktë individualë në kapitalin e nënshkruar (kapitali nominal);
(ii) plus blerjen neto të aksioneve të tjera shtesë, letra me vlerë të borxhit dhe huadhënie (përfshirë ato jomonetare, makineri, të drejta për prodhim etj.) për kompaninë nga investitori direkt;
(iii) minus blerjen neto të aksioneve, letra me vlerë të borxhit dhe huadhënie investitorit direkt nga kompania;
(iv) plus rritjen neto të kredisë tregtare dhe të tjera kredi afatshkurtra të dhëna nga investitori direkt për kompaninë.

- *për degët:*

(i) rritja në fitimet e riinvestuara;
(ii) plus rritja neto e fondeve të marra nga investitori direkt;
(iii) plus flukset monetare ndërmjet kompanive të varura, me përjashtim të disa flukseve ndërmjet bankave filiale, filialeve të ndërmjetësimit (për shembull, tregtuesit e letrave më vlerë) dhe Special Purpose Entities (SPE), të cilat kanë si objekt të vetëm ndërmjetësimin financiar.

Pozicionet ndërkombëtare të investimeve përcaktohen si më poshtë:

- *për filialet dhe kompanitë simotra:*

(i) vlera e tregut ose kontabile (në bilancin kontabël) e aksioneve dhe rezevës së detyruar atribut i investitorit direkt;
(ii) plus hua, kredi tregtare dhe letra me vlerë të borxhit të emetuara nga investitori direkt (përfshirë këtu dividentët e përcaktuar dhe jo të shpërndarë);
(iii) minus shlyerjen e huasë, kredisë tregtare dhe letrave me vlerë të borxhit;

- *për degët:*

(i) vlera e tregut ose kontabile e mjeteve fikse, e investimeve dhe e mjeteve qarkulluese, përjashtuar shumat për t'u paguar nga investitori direkt;
(ii) minus detyrimet e degëve ndaj të tretëve.

Regjistrimi i pozicioneve, sipas rekomandimeve të FMN-së duhet të kryhet bazuar në parimin e drejtimit (përkatësisht si mjet/detyrim), i cili merr parasysh statusin e

ndërmarrjes. Në këtë kontekst, vendi (origjina) i investitorëve direktë regjistron të gjitha transaksionet kapitale me ndërmarrjet e investimit direkt nën "investime direkte jashtë", ndërsa vendi i ndërmarrjes së investimit direkt regjistron të gjitha transaksionet e kapitalit me investitorët e huaj nën "investime direkte në ekonominë raportuese". Për më tepër FMN, rekomandon që pozicionet duhet të llogariten bazuar në çmimin e tregut të periudhës përkatëse të raportimit. Pozicionet e dala nga bilancet kontabile të investitorëve direktë dhe ndërmarrjeve të investimit direkt (vlera kontabile), përfaqësojnë një përafrim të kënaqshëm të vlerave të tregut. Kështu, në shumicën e rasteve këto dy grupe të dhënash (vlerat kontabile dhe vlerat e tregut) mund të jenë të përshtatshme.

Përfundimisht, ka disa mënyra të shpërndarjes sektoriale të flukseve të Investimit të Huaj Direkt dhe Pozicionit Ndërkombëtar të Investimeve. FMN ka zgjedhur paraqitjen sipas katër organizmave (shih tabelën 1 më poshtë), nisur nga sektori të cilit i takon grupi rezident. Mëgjithatë, raportimi sipas kësaj ndarjeje sektoriale nuk është i detyrueshëm në Manualin e 5 të FMN-së.

Ndryshe nga klasifikimi sipas organizmave sektoriale, OECD favorizon një shpërndarje sipas sektorëve "industrialë" (shih tabelën 1 më poshtë), e cila përfshin nëntë sektorë ekonomikë. Për këtë klasifikim, OECD rekomandon që IHD-të e ndërmarra nëpërmjet një kompanie rezidente të klasifikohen në atë sektor industrial në të cilin përfshihet kompania-mëmë. Sipas këtij kriteri, kur kompania-mëmë është një bankë, transaksionet e IHD-ve të ndërmarra nga kompani jobanka duhet t'u ngarkohen bankave.

Tabelë 1. Shpërndarja sektoriale e IHD-ve sipas FMN dhe OECD.

Klasifikimi sipas FMN	Klasifikimi sipas OECD
1. Autoriteti Monetar. 2. Bankat. 3. Qeveria e Përgjithshme. 4. Sektorë të tjerë.	1. Bujqësi, pyje, gjueti, peshkim. 2. Shfrytëzim minierash dhe guroresh. 3. Industri përpunuese. 4. Elektricitet, gaz dhe ujë. 5. Ndërtim. 6. Tregti me shumicë dhe pakicë, restorante dhe hotele. 7. Transport, magazinim dhe komunikim. 8. Financim, pasuri e patundshme dhe shërbime biznesi. 9. Bashkësi, shërbime sociale dhe personale.

4. VLERËSIMI I FLUKSEVE DHE I STOKUT TË IHD-VE DHE LIDHJA NDËRMJET TYRE.

Bilanci i pagesave dhe Pozicioni Ndërkombëtar i Investimeve hartohen bazuar në të njëjtin kuadër metodologjik rregullash, të përcaktuar në Botimin e 5-të të Manualit të Bilancit të Pagesave të FMN-së. Sipas këtij të fundit, transaksionet e IHD-ve duhet të regjistrohen në Bilancin e Pagesave në vlera të përllogaritura, "..transaksionet janë të regjistruara kur vlera ekonomike është krijuar, transformuar, këmbyer, transferuar ose fikur..". Në praktikë, është shumë i vështirë zbatimi i parimeve të përllogaritjes në të gjitha transaksionet

dhe si pasojë, shumë nga to janë të regjistruara në kohën kur të ardhurat ose pagesat, janë gjeneruar.

Veç kësaj, FMN rekomandon përdorimin e çmimit të tregut si bazë për vlerësimin e flukseve dhe të stoqeve, ndonëse kjo nënkupton trajtime të ndryshme për të dy këto tipe të dhënash: (i) për flukset, çmimi i tregut i referohet çmimit aktual të rënë dakord ndërmjet palëve në ditën e transaksionit dhe nuk duhet të reflektojë ndryshimet e mundshme, të krijuara nga luhatjet e kursit të këmbimit ose të çmimit të tregut të mjeteve dhe detyrimeve financiare në fjalë. (ii) Për stoqet, rekomandohet çmimi i tregut në kohën e përpilimit të stoqeve. Megjithatë, në praktikë është pranuar përdorimi i vlerave të marra nga bilancet kontabile të kompanive të investimit direkt, si një përafrim i çmimit të tregut për stokun e investimit direkt kur kjo kompani nuk ka një çmim tregu. Këto vlera nëse janë të regjistruara bazuar në vlerën korente të tregut, do të konsiderohen në përputhje me këtë parim. Nëse bazohen në kostot historike ose në rivlerësimin për një periudhë kohore, vlera të tilla kontabile nuk janë konform këtij parimi. Megjithatë, duhet thënë se vlerat kontabile përfaqësojnë burimin e vetëm të mundshëm për vlerësimin e mjeteve dhe detyrimeve në të shumtat e vendeve.

Diferenca ndërmjet stokut në fillim të vitit dhe vlerës së tij në ditën e fundit të vitit duhet të jetë e barabartë me fluksin e regjistruar në bilancin e pagesave, i cili reflekton transaksionet në këto mjete dhe detyrime të zhvilluara gjatë vitit; plus ndryshimet në vlerën e stokut si pasojë e lëkundjeve në kursin e këmbimit; plus ndryshimet e shkaktuara nga modifikimet në çmimet e mjeteve dhe detyrimeve; dhe plus të tjera ndryshime në vëllimin e mjeteve dhe detyrimeve financiare. Në mënyrë të përmbledhur:

Pozicioni në fund të periudhës = pozicioni në fillim të periudhës + flukset e IHD-ve + ndryshimet në çmime + ndryshimet nga kursi i këmbimit + axhustime të tjera.

Përsa i përket "axhustimeve të tjera", megjithëse disa nga ato mund të shpjegohen nga përdorimi i burimeve të ndryshme për përpilimin e këtyre statistikave, më kryesoret janë ato që lidhen me riklasifikimin në Pozicionin Ndërkombëtar të Investimeve (jo në bilancin e pagesave) për shembull, nga investim portofoli në investim direkt, siç u shpjegua në pjesën e dytë.

Megjithë zbatimin e një kuadri të përbashkët metodologjik në përcaktimin e këtyre flukseve, mospërputhjet në krahasimin e të dhënave ndërkombëtare janë të konsiderueshme. Në fakt, në shkallë botërore mospërputhja ndërmjet flukseve hyrëse dhe dalëse të investimeve direkte duhet të jetë zero, nëse këto flukse janë regjistruar totalisht dhe në përputhje në të dyja krahët. Megjithatë, sipas Lipsey (2001) "asimetritë kanë qenë jo më të larta se 8% për çdo vit të studiuar nga viti 1993, në kontrast me 40 ose 50 për qind për investimet e portofolit".

Mospërputhjet lindin kryesisht nga kriteret e ndryshme të përdorura në vlerësimin e flukseve ose shpërndarjen gjeografike të transaksioneve.

Shmangiet më të shpeshta shkaktohen nga mungesa e informacionit për fitimet e riinvestuara. Këto të fundit, ndryshe nga flukset e njëanshme të kapitalit apo shpërndarja e dividentëve, nuk iniciojnë asnjë transaksion valutor, i cili mund të kanalizohet nëpërmjet sistemit bankar. Si pasojë, vendet të cilat përdorin si burim kryesor informacionin bankar dhe jo raportimet direkte nga kompanitë e investimit direkt dhe ndërmarrjet e tyre të varura, nuk kanë të dhëna mbi fitimin e riinvestuar.

Boks 4. Regjistrimi i fitimit të riinvestuar në bilancin e pagesave.

Rëndësia e identifikimit të fitimit të riinvestuar, theksohet nga fakti që kjo përbën mundësinë e vetme për regjistrimin e të ardhurave të kompanive në bilancin e pagesave si dhe në zërat përkatës në PNI. Nga këndvështrimi ekonomik, kontabilizimi i fitimeve të riinvestuara nuk ndikon zhvillimet aktuale dhe ekuilibrin e jashtëm të ekonomisë kombëtare. Megjithatë, ai siguron një kuadër më të detajuar të rolit që luajnë IHD në ekonomi, sasinë e të ardhurave si dhe mënyrën e shpërndarjes.

Standardet ndërkombëtare përkufizojnë dy trajtime të veçanta, duke u bazuar në mënyrën e matjes së të ardhurave të korporatave: të ardhurat mund të (i) përfshijnë të gjithë përbërësit e fitimit, si për shembull, fitimet ose humbjet nga kurset e këmbimit ose humbjet që lidhen me zbritjen e pretendimeve; (ii) përjashtojnë këto të fundit dhe mbështeten vetëm në fitimin e thjeshtë. Metodologjitë ndërkombëtare rekomandojnë trajtimin e fundit.

Regjistrimi i të ardhurave ndaj kapitalit të investimit të huaj direkt në statistikat e bilancit të pagesave kërkon informacionin e mëposhtëm:

- vitin dhe fitimin (ose humbjen) neto të ndërmarrjes me investim të huaj direkt, pas tatimit;
- kohën e regjistrimit dhe dividentin e deklaruar të pagueshëm nga investitorët;
- tatimin e dividentit të pagueshëm;
- kohën e pagesës së dividentit aktual.
Përgjigjet ndaj pyetjeve mbi kohën e regjistrimit mund të ndihmojnë në identifikimin e periudhës së kontabilizimit për shembull, periudha në të cilën transaksioni në fjalë pasqyrohet në bilancin e pagesave.
Sipas kësaj:
-Fitimi (ose humbja) pas tatimit i investitorëve të huaj direktë mund të regjistrohet si fitim i riinvestuar në bilancin e pagesave për vitin në të cilin është fituar realisht.
-Dividentët duhet të regjistrohen si një komponent i të ardhurave në rastin kur ata deklarohen si të pagueshëm. Kur merren së bashku, bëhet një dallim i rëndësishëm ndërmjet fitimit si një përfitim nga aktiviteti i kompanisë dhe futjes së dividentit si rezultat i vendimit të pronarëve. Dividentët e deklaruar si të pagueshëm pakësojnë fitimet e riinvestuara për vitin në fjalë në llogarinë korente dhe atë kapitale. Dividentët e shpërndarë, por akoma të papaguar gjithashtu përfaqësojnë një detyrim afatshkurtër kundrejt investuesit; si rezultat, në llogarinë financiare të bilancit të pagesave ata regjistrohen në zërin "kapitale të tjera" brenda investimeve të huaja direkte.
- Pasi investitorët kanë shpërndarë fitimin pas tatimit, ata duhet të paguajnë taksën për dividentët e deklaruar të pagueshëm. Pas kësaj, pretendimi i qeverisë (zë i bilancit të pagesave) kundrejt investitorit, zëvendësohet me pretendimin e ndërmarrjes kundrejt investitorit në llogarinë financiare, si pasqyrim i të ardhurave (taksat) të regjistruara si transfertë korente.
- Në momentin kur dividentët paguhen, transferta barazon dividentin e deklaruar të pagueshëm neto. Pra, si detyrimi (i lindur si pasojë e dividentit të shpërndarë, por të

papaguar) ashtu edhe pretendimi ndaj investitorit (për shembull, taksa e dividentit paguar qeverisë) likuidohen. Me fjalë të tjera, në momentin kur kryhet pagesa nuk ekzistojnë më komponentë të llogarisë korente, të dyja anët e transfertës ndikojnë vetëm llogarinë financiare.

Regjistrimi i fitimit neto të ndërmarrjeve si fitim i riinvestuar, tregon se si ndikon investimi direkt në bilancin e llogarisë korente nëpërmjet llogarisë së të ardhurave. Megjithatë, vendimi i pronarëve në lidhje me shpërndarjen e të ardhurave (me përjashtim të efektit indirekt të taksës mbi dividentin) dhe pagesës së dividentëve, nuk ka efekt në bilancin e llogarisë korente, pra, nuk ndikon në marrëdhëniet kursime – investime në ekonominë kombëtare.

Statistikat e bazuara në rekomandimet metodologjike ndërkombëtare, mund të kompilohen në bazë vjetore pas përpunimit të pyetësorëve përkatës, të plotësuar nga bilancet kontabël dhe pasqyrat financiare fitim – humbje të ndërmarrjeve. Në këto statistika, të dhënat mbi fitimet e riinvestuara, dividentët dhe të ardhurat e tjera të shpërndara mbi kapitalin, janë vlerësime.

5. FORMAT E INVESTIMIT DIREKT.

Përvetësimi nga investitori direkt i pjesës së kontrollit në një kompani të vendosur në një territor ekonomik të ndryshëm nga vendi i origjinës, mund të marrë forma të ndryshme.

Ka dallim ndërmjet sigurimit të një interesi të qëndrueshëm në një ndërmarrje ekzistuese në formën e shkrirjes apo të përvetësimit, të njohura si Mergers & Acquisitions – (M&A) dhe krijimit të një njësie të re prodhimi (investimet greenfield).

Në realitet, IHD është një fluks heterogjen mjetesh financiare që përfshin së bashku, investimet e reja ("investimet greenfield"), të cilat përfaqësojnë një shtim neto të stokut të kapitalit në vendin pritës dhe investimet direkte në formën e përvetësimit apo shkrirjes, të cilat përfaqësojnë një ndryshim në pronësinë e kapaciteteve ekzistuese të prodhimit në ekonominë pritëse.

Besohet që "investimet greenfield" janë më të dobishme për një ekonomi meqë sigurojnë mjete të reja. Megjithatë, në disa vende si për shembull, ekonomitë në tranzicion, "M&A" mund të jenë më të dëshirueshme. Një arsye për këtë mund të jetë që flukset e "M&A" në këto ekonomi janë të lidhura me programin e privatizimit.

Formë e investimit direkt janë edhe fitimet e riinvestuara nga investitorët ekzistues në fusha të ndryshme nga ajo e fitimeve (aktivitetit) të tyre. Megjithëse nuk përfaqësojnë një fluks të ri kapitali hyrës, kjo formë investimi rrit stokun e kapitalit dhe mjeteve në vend, si dhe rrit kapacitetin e prodhueshmërisë së tij. Huatë ndërmjet ndërmarrjeve janë një tjetër formë e IHD në një ekonomi. Zakonisht ato zëvendësojnë një fluks kapitali nga mëma (jashtë) tek bija. Ky "borxh" meqë ripaguhet nga kjo e fundit së bashku me interesin, përbën një

fluks dalës më të madh se hyrësi. Kjo formë investimi nuk është me interes për vendet e ndryshme edhe pse ndihmon në financimin e biznesit të investitorit direkt, duke mundësuar vazhdimësinë e kontributit të tij në ekonominë vendase.

Ndërkohë që të njohura janë edhe format jokapitale të IHD-ve që përfshijnë licencat, marrëveshjet ekskluzive etj.. Këto forma nuk përmbajnë detyrimisht flukse kapitali nga jashtë, megjithatë kontributi i tyre në zhvillimin ekonomik është i rëndësishëm.

Përveç këtyre formave të investimit, ekzistojnë dhe raste të veçanta të cilat kërkojnë plotësimin e disa kushteve të veçanta për t'u klasifikuar si investime të huaja direkte. Identifikimi dhe njohja e tyre është shumë e rëndësishme për hartimin e statistikave të investimeve të huaja direkte në përputhje me standardet.

Boks 5. Raste të veçanta të Investimeve të Huaja Direkte.

-Offshore – Janë ndërmarrje që merren me montimin ose grumbullimin e artikujve të prodhuar jashtë vendit. Zakonisht ato përpunojnë mallra për eksporte, merren me aktivitet tregtar dhe me veprimtari financiare.

Këto kompani përqëndrohen në "zona të veçanta tregtare", "zona të tregtisë së lirë" ose zona me "parajsë" fiskale (me një nivel shumë të ulët taksash, madje për disa biznese edhe pa taksa).

Në të dhënat e IHD-ve, rezidenca e ndërmarrjeve "offshore" lidhet me ekonomitë në të cilat veprojnë, pavarësisht nëse përfitojnë apo jo privilegje nga autoritetet lokale si për shembull, përjashtimi nga taksat, nga tarifat apo nga detyrimet doganore.

- Pothuajse - korporatat (Quasi – corporations) janë ndërmarrje të cilat ofrojnë mallra dhe shërbime në një vend tjetër, ku nuk kanë status ligjor të veçantë. Këto ndërmarrje të cilat kanë marrëdhënie investimi direkt me mëmën, do të quhen IHD nëse:
1. Prodhimi është i vazhdueshëm për më tepër se një vit.
2. Mbahet libër i veçantë llogarish për veprimtaritë lokale.
3. Taksa mbi të ardhurat paguhet në vendin pritës, jo në vendin e origjinës.

Shembuj për këtë tip ndërmarrjesh janë ato të ndërtimit[1] ose ndërmarrjet[2] e lëvizshme.

- Njësitë për Qëllime të Veçanta (Special Purpose Entities (SPE))[3], në përgjithësi janë të organizuara ose të vendosura jashtë ekonomive në të cilat janë rezidente ndërmarrjet mëmë. Ato merren kryesisht me transaksione ndërkombëtare, me pak ose aspak transaksione lokale. Special Purpose Entities emërohen ato struktura ligjore, të cilat kanë pak ose nuk kanë fuqi punëtore, aktivitete ose prezencë fizike në sistemin juridik të vendit, ku janë krijuar. Ato përdoren përgjithësisht si mekanizma për të zotëruar mjete dhe detyrime dhe nuk janë kompani prodhuese në vetvete. Si mekanizma ligjorë, SPE- të nuk kanë kosto të lartë në themelim, shfrytëzojnë financiarisht detyrimet rregullatore dhe privilegjet konfidenciale. Themelimi i tyre është shpesh i shoqëruar me qendra financiare "offshore" ose sipas rregullave ligjorë specifikë të ekonomisë në të cilën ndodhen.

SPE- të përcaktohen nga struktura (për shembull, kompani bazë, zyrat qendrore rajonale etj.) dhe qëllimi i tyre (për shembull, administrimi i shitjeve, administrimi i rrezikut valutor, ndihmë në financimin e investimit etj.).

SPE-të trajtohen si ndërmarrje me investim direkt dhe përfshihen në të dhënat e IHD, nëse plotësojnë kriterin e 10 përqindëshit të pronësisë.

- Ndërmjetësueset financiare që përkufizohen si: institucione të tjera depozituese (banka të nivelit të dytë); ndërmjetësuese të tjera financiare përveç kompanive të sigurimit dhe fondeve të pensionit; institucione të tjera financiare (për shembull, agjentë sigurimesh); SPE për qëllime ndërmjetësimi financiar dhe/ose për shërbime ndihmëse.

Transaksionet ndërmjet ndërmjetësueseve financiare (për shembull, ndërmjetësueset financiare të cilat janë në marrëdhënie investimi direkt) duhet të përjashtohen nga të dhënat e IHD-ve, përveç transaksioneve në formë kapitali ose borxhi të qëndrueshëm.

- Shitblerja e tokës nga rezidentët[4]. Me marrëveshje, në bilancin e pagesave të gjitha trojet brenda territorit të një ekonomie, përveç atyre të zotëruara nga qeveritë e huaja (si për shembull, ambasadat) konsiderohen si pronë e rezidentëve.

Nëse pronari aktual i një trualli është jorezident, presupozohet se pronësia i është transferuar një njësie institucionale rezidente imagjinare, e cila zotëron këtë truall dhe/ose ndërtesë.
Jorezidenti si pasojë, ka një investim financiar në këtë njësi rezidente imagjinare, e cila presupozohet të jetë një ndërmarrje me investim direkt.
Shitblerja e truallit (ose e një ndërtese mbi këtë truall) nga jorezidentët duhet të përfshihet në IHD si kapital themelimi.

- Eksplorimi i burimeve natyrore[5]. Shpenzimet për zbulime ose kërkime të burimeve natyrore (për shembull, naftës) nga jorezidentët duhet të regjistrohen në IHD si kapital i themelimit. Pagesat e një investitori direkt për të drejtën e eksplorimit të burimeve natyrore të një ekonomie, duhet të regjistrohen në IHD si kapital themelimi, nëse duket qartë synimi për të krijuar një ndërmarrje investimi direkt në këtë ekonomi.

Nëse kërkimet për burime natyrore rezultojnë të pasuksesshme (për shembull, pus i tharë nafte etj.) dhe përfundojnë në mbylljen e ndërmarrjes atëherë:
-nuk duhet të regjistrohen hyrje të mëtejshme në të dhënat e IHD e BOP;
-duhet të bëhen rregullime negative (me shenjë të kundërt) në të dhënat e Pozicionit Ndërkombëtar të Investimeve (PNI) dhe IHD-ve për të dyja vendet.

---

[1] Paragrafet 545 – 548 të BOP Textbook dhe 712 – 717 të BOP Compilation Guide, japin shembuj për ndërmarrjet e ndërtimit. Paragrafi 545: Një punë e marrë përsipër nga një kompani ndërtimi në një ekonomi, mund të jetë (i) punë e kryer nga një ndërmarrje imagjinare rezidente dhe e angazhuar në marrëdhënie investimi direkt me kompaninë-mëmë ose; (ii) shërbim i importuar nga ekonomia vendase. Përcaktimi i ekonomisë të cilës i atribuohet prodhimi është shumë i rëndësishëm. Nëse një kompani ndodhet ose parashikon të jetë në një ekonomi për më shumë se një vit dhe regjistrimet e veprimtarisë së saj janë bërë në këtë ekonomi, atëhere edhe prodhimi i atribuohet po kësaj ekonomie. Pra në këtë rast, në këtë ekonomi krijohet një kompani e re me investim të huaj direkt. Në të kundërt, nuk kemi të bëjmë me ndërmarrje me investim direkt dhe në bilancin e pagesave të ekonomisë në fjalë, transaksionet e kompanisë do të prekin zërin importe në llogarinë korente.
[2] Paragrafet 552 – 554 në BOP Textbook japin shembuj për trajtimin e ndërmarrjeve lëvizëse në bilancin e pagesave.
[3] Paragrafet 542 – 544 në BOP Textbook, japin shembuj për trajtimin e SPE-ve në bilancin e pagesave.
[4] Paragrafet 550-551 nga BOP Textbook dhe 718-722 nga BOP Compilation Guide, japin shembuj për trajtimin e këtyre rasteve në bilancin e pagesave.
[5] Shih http://www.imf.org/external/np/sta/bop/biblio.htm

6. METODA TË MBLEDHJES SË TË DHËNAVE TË INVESTIMEVE TË HUAJA DIREKTE.

Matja e saktë e investimeve të huaja direkte është shumë e rëndësishme në përcaktimin e fluksit dhe të stokun të IHD-ve. Ka tri mënyra për mbledhjen e të dhënave: vrojtimi i ndërmarrjeve, sistemi ndërkombëtar i raportimit të transaksioneve (ku përfshihen transaksionet nëpërmjet sistemit bankar) si dhe të dhënat administrative. Zgjedhja ndërmjet mënyrave të ndryshme të mbledhjes së informacionit, mund të jetë vendimtare për saktësinë e statistikave të IHD-ve dhe për aftësinë e hartuesve në zbatimin e standardeve ndërkombëtare. Çdo burim informacioni ka përparësitë dhe mangësitë e tij specifike.

Tabelë 2. Përparësitë dhe mangësitë e burimeve kryesore të informacionit për IHD.

Përparësitë	Mangësitë
Sistemi i Raportimit të Transaksioneve me Jashtë (ITRS)	
Normalisht ITRS përdoret në mbledhjen e informacionit për zëra të ndryshëm të BP-së si për shembull, import/eksport etj.. Në këtë mënyrë, arrihet shmangia e shpenzimeve për zhvillimin dhe zbatimin e sistemeve të tjera për mbledhjen e informacionit të duhur për hartimin e bilancit të pagesave.	Zakonisht, maten vetëm transaksionet në *cash*. Kjo nënkupton që pjesë nga komponentët e IHD (si për shembull, fitimi i riinvestuar ose borxhi ndërmjet kompanive) nuk përfshihen pa një marrëveshje të veçantë dhe duhen përdorur burime të tjera shtesë. Konceptet e IHD-ve janë të vështira për t'u sqaruar në sistemin e përgjithshëm të raportimit të bankave, sidomos konceptet që i përkasin klasifikimit. Matja e transaksioneve në monedhë vendase ose ndërmjet llogarive me banka jorezidente është e vështirë. Mund të jetë e vështirë për të marrë të dhëna për pozicionin ndërkombëtar të investimeve.
Vrojtimet e ndërmarrjeve	
Vrojtimi i ndërmarrjeve dizenjohet bazuar në kërkesat specifike të statistikave të IHD-ve. Ai siguron një regjistrim të plotë të transaksioneve dhe pozicionit të IHD-ve për secilën nga ndërmarrjet e vrojtuara, duke përfshirë fitimet e riinvestuara. Krijon mundësinë e shpjegimit të koncepteve dhe trajtimit të IHD-ve tek raportuesit e të dhënave. Mund të përfshijë informacion për faktorë të tjerë ndikues ekonomikë, si për shembull, numri i punonjësve, eksportet etj..	Mbajtja e një regjistri për ndërmarrjet me investim të huaj direkt, në të cilin pasqyrohen transaksionet / pozicioni i stokut, mund të jetë i vështirë. Zhvillimi dhe zbatimi i një vrojtimi të specializuar për IHD-të, nga vendet të cilat nuk përdorin vrojtimet për të dhënat e bilancit të pagesave krijon kosto shtesë. Në rastet e vrojtimit me zgjedhje ekstrapolimi mund të çojë në rezultate joreale.
Të dhënat "Administrative"	
Informacioni i nevojshëm mundësohet shpesh në procesin e miratimit të investimeve të reja.	Ky informacion rrallë herë është i hartuar për të përmbushur nevojat e bilancit të pagesave. Hapësira kohore ndërmjet miratimit dhe realizimit të investimeve (ekziston mundësia që investimi të mos realizohet). Mungon informacioni për fitimet e riinvestuara dhe dis-investimet. Nuk përfshin informacionin mbi stokun e investimeve vlerësuar në çmime tregu. Informacioni mbulon një numër të kufizuar industrish. Zakonisht mbulohen vetëm IHD-të hyrëse, jo ato dalëse.

Burimi: FMN (1995); OECD (1999), Bertrand (1999).

Shumë vende të botës bazohen dhe në të dhënat e ITRS-it për krijimin e bazës së të dhënave të IHD-ve. Banka e Shqipërisë siguron një informacion shumë të kufizuar nga raportimet e bankave. Ka shumë arsye për këtë, por më kryesorja është shkalla e lartë e përdorimit të *cash*-it në ekonomi.

Aktualisht, vrojtimi i ndërmarrjeve është metoda më e përdorshme. Ky vrojtim është ndërmarrë nga Banka e Shqipërisë si nismëtare e krijimit të regjistrit të plotë të ndërmarrjeve me kapital të huaj. Krijimi i këtij regjistri do të jetë baza për krijimin e serive kohore të vlefshme për bilancin e pagesave dhe për Pozicionin Ndërkombëtar të Investimeve. Deri tani janë realizuar dy vrojtime për IHD, përkatësisht në vitet 2003 dhe 2004 dhe kanë synuar intervistimin e të gjitha kompanive që investojnë direkt në Shqipëri. Banka e Shqipërisë ka planifikuar vrojtime vjetore, duke synuar anketimin në të gjithë popullatën e kompanive me kapital të huaj në Shqipëri.

Megjithëse konsiderohet një burim shumë i mirë informacioni, kryerja e vrojtimeve statistikore është proces shumë i vështirë dhe delikat. Ai kërkon përcaktimin e qartë të objektivave, pyetësorë të hartuar mirë, përzgjedhje të popullatës së vrojtimit sa më përfaqësuese, klasifikim dhe strukturë të mirëpërcaktuar të të dhënave statistikore, vlerësim të rezultateve dhe procedura agregimi efektive etj.. Për pasojë, një nga detyrat kryesore për hartuesit e bilancit të pagesave është përmirësimi i metodologjive përkatëse dhe studimi i vazhdueshëm për gjetjen e metodave statistikore dhe ekonometrike sa më të përshtatshme për përpunimin të dhënave përkatëse, pa harruar kërkimet për burime të tjera informacioni.

Krijimi i një historiku të dhënash për kapitalin e huaj të hyrë në Shqipëri në formën e investimeve direkte si dhe analizat studimore të rezultateve të vrojtimeve, do të japin një kuadër të qartë të origjinës së tij, sektorët e ekonomisë që kanë thithur më shumë atë, si dhe ndikimin në ekonomi. Analiza e karakteristikave të tregut të investimeve të huaja direkte si dhe produktivitetit të tyre, mund të shërbejë si një faktor nxitës në hapjen e kompanive të reja, me kapital të huaj në vend.

BIBLIOGRAFI

Bertrand, Ayse (1999): Foreign Direct Investment Data Sources and Reporting Systems: Main Issues in OECD: Workshop on Foreign Direct Investment Statistics in the Baltic States, Estonia November 16, 1999.

European Central Bank (2002): Accession Countries: Balance of Payments/ International Investment Position Statistical Methods, February 2002, http://www.ecb.int/pub/pdf/bop02ac

Falzoni, Anna M. (2000) "Statistics on Foreign Direct Investment and Multinational Corporations: a Survey", University of Bergamo, Italy

International Monetary Fund (1993), Balance of Payment Manual.

International Monetary Fund (2001), A Practical Guide to Foreign Direct Investment Statistics.

International Monetary Fund (1995): Balance of Payments Compilation Guide,

Lipsey, R.E. (2001), "Foreign Direct Investment and the Operations of Multinational Firms: Concepts, History and Data," NBER WP No. 8665

OECD (1996), OECD Benchmark definition of FDI, 3rd Edition, Paris.

SHËNIME

*Përgatiti: Argita Frashëri, përgjegjëse zyre, zyra e bilancit te pagesave;
Anjeza Hobdari, specialiste, zyra e bilancit te pagesave

Falenderojmë Departamentin Juridik për sugjerimet dhe ndihmën e dhënë gjatë përgatitjes së këtij materiali.

[1] OECD (1996).

[2] Person juridik janë shoqëritë tregtare të regjistruara në regjistrin tregtar pranë gjykatës si shoqëri tregtare, në një nga format e njohura nga ligji (komandite, të thjeshtë, përgjegjësi të kufizuar apo anonime). Kanë statut dhe akt themelimi.

[3] Person fizik janë ortakëri të paregjistruara në regjistrin tregtar si shoqëri tregtare apo në ndonjë formë tjetër të njohur nga ligji. Pra, janë thjesht një formë bashkëpunimi ndërmjet tregtarëve, por pa një formë të njohur nga ligji, domethënë nuk dalin si palë më vehte në marrëdhëniet juridike. Nuk kanë statut dhe akt themelimi.

[4] Filiali është një shoqëri tregtare më vehte, e cila konsiderohet filial me shoqërinë tregtare-mëmë.

BANKA E SHQIPËRISË NË HARKUN KOHOR JANAR-MARS 2006

Dorëzimi i Letrës së Mirëkuptimit dhe Memorandumit të Politikave Ekonomike dhe Financiare Fondit Monetar Ndërkombëtar.

Në datën 11 janar 2006, Qeveria Shqiptare i paraqiti zyrtarisht Fondit Monetar Ndërkombëtar, Letrën e Mirëkuptimit dhe Memorandumin e Politikave Ekonomike dhe Financiare. Ky dokument u firmos në praninë e Përfaqësueses së Misionit të FMN-së në Shqipëri, zj. Ann-Margret Westin, nga Kryeministri, z. Sali Berisha, Ministri i Financave, z. Ridvan Bode dhe nga Guvernatori i Bankës së Shqipërisë, z. Ardian Fullani. Në fjalën e tij pas nënshkrimit të këtij dokumenti, Guvernatori Fullani theksoi se marrëveshja e nënshkruar me FMN-në krijon një besueshmëri akoma më të madhe për Shqipërinë, rrit pavarësinë e Bankës së Shqipërisë, si dhe shton premisat për një stabilitet sa më të mirë makroekonomik.

Forumi i 11-ë i Euromoney me temë "Zgjerimi i kufijve: Përforcimi i konkurrencës në Evropën Qendrore dhe Juglindore".

Në datat 17-18 janar 2006, u organizua Forumi i 11-ë i Euromoney-it me temë: "Zgjerimi i kufijve: Përforcimi i konkurrencës në Evropën Qendrore dhe Juglindore", në Vjenë, Austri. Forumi ishte konceptuar në formën e paneleve me tema specifike, ku një rëndësi të veçantë kishte edhe paneli i Guvernatorëve, i cili u përqendrua kryesisht në zgjerimin e Bashkimit Evropian dhe Monetar në drejtim të Evropës Lindore dhe kostot e pritshme të këtij zgjerimi për këtë rajon dhe në përgjithësi, për gjithë Evropën. Në këtë panel, diskutoi edhe Guvernatori i Bankës së Shqipërisë, z. Ardian Fullani, i cili pasi prezantoi zhvillimet më të fundit të ekonomisë shqiptare, u fokusua mbi investimet e huaja në Shqipëri dhe problemet që paraqet ekonomia shqiptare në lidhje me to. Ai u përqendrua gjithashtu, dhe në kontributin që Banka e Shqipërisë mendon të luajë në mbështetjen e zhvillimit ekonomik në Shqipëri dhe rajon.

Takim i Guvernatorit të Bankës së Shqipërisë, z. Ardian Fullani me përfaqësues të komunitetit të biznesit, të pushtetit lokal, të sektorit bankar dhe me akademikë të Universitetit të qytetit të Shkodrës.

Në datën 17 shkurt 2006, Guvernatori i Bankës së Shqipërisë, z. Ardian Fullani, zhvilloi një takim në qytetin e Shkodrës, me përfaqësues të komunitetit të biznesit, të pushtetit lokal dhe të sektorit bankar, dhe me akademikë të universitetit "Luigj Gurakuqi" të Shkodrës. Në fjalën e tij, Guvernatori i Bankës së Shqipërisë evidentoi një tablo optimiste në lidhje me zhvillimet ekonomike të vitit 2005 dhe ato të pritshme të vitit 2006, si dhe theksoi domosdoshmërinë e shtimit të informacionit jo vetëm nga burimet zyrtare, por edhe nga vetë njësitë bazë të inputit statistikor, që janë kompanitë e biznesit. Për këtë qëllim, ai i bëri apel komunitetit të biznesit që të bashkëpunojë me degët e Bankës së Shqipërisë, për të ofruar informacion të vlefshëm në lidhje me aktivitetin e tyre. Ndërsa të pranishmit u shprehën entuziastë për këtë iniciativë të Bankës së Shqipërisë dhe theksuan se përfitimi nga kjo iniciativë do të jetë reciprok, si për komunitetin e biznesit ashtu edhe për bankat, sepse përmirësimi i mëtejshëm i statistikave dhe i informacionit do të ndihmojë në rritjen e bashkëpunimit midis këtyre komuniteteve.

Konferenca ndërkombëtare me temë: "Remitancat, një mundësi për rritje - emigracioni shqiptar në Itali si një rast studimi".

Në datat 3-4 mars 2006, Banka Botërore dhe Rajoni i Pulias, në bashkëpunim edhe me Bankën e Shqipërisë organizuan një konferencë ndërkombëtare me temë "Remitancat: një mundësi për rritje - emigracioni shqiptar në Itali si një rast studimi", në Bari, Itali. Pjesëmarrës në këtë konferencë ishin ekspertë të Bankës Botërore, të rajonit të Pulias, të Bankës së Shqipërisë, si dhe shumë të ftuar të tjerë të rëndësishëm nga Italia dhe Shqipëria, të cilët diskutuan gjerësisht mbi remitancat që përbëjnë një problem shumë aktual për të dyja vendet. Në këtë konferencë, merrte pjesë edhe Guvernatori i Bankës së Shqipërisë z. Ardian Fullani, i cili në diskutimin e tij trajtoi gjerësisht problemin e remitancave, si një çështje me rëndësi aktuale në ditët tona, duke theksuar se ato përbëjnë një instrument financiar që duhet kanalizuar nëpërmjet sistemit bankar.

Takim i Guvernatorit të Bankës së Shqipërisë, z. Ardian Fullani me Guvernatorin e Bankës së Italisë, z. Mario Draghi.

Në datën 6 mars 2006, Guvernatori i Bankës së shqipërisë, z. Ardian Fullani zhvilloi një takim pune me homologun e tij italian, z. Mario Draghi, në Romë, Itali. Guvernatori Fullani bëri një ekspoze të gjerë të zhvillimeve ekonomike në Shqipëri, duke vënë theksin tek investitorët italianë në përgjithësi, dhe tek bankat italiane në veçanti, të cilët kanë luajtur një rol shumë të rëndësishëm në zhvillimin e ekonomisë dhe të sistemit bankar privat në Shqipëri. Ndërsa, Guvernatori Draghi pasi vlerësoi arritjet e deritanishme të Bankës së Shqipërisë, shprehu gatishmërinë për të rritur asistencën dhe mbështetjen për Bankën e Shqipërisë.

Takim i Guvernatorit të Bankës së Shqipërisë, z. Ardian Fullani me Presidentin e Shoqatës së Bankave Italiane, z. Maurizio Sella.

Në datën 7 mars 2006, Guvernatori i Bankës së Shqipërisë, z. Ardian Fullani zhvilloi një takim pune me Presidentin e Shoqatës së Bankave Italiane, z. Maurizio Sella dhe Drejtorin e Përgjithshëm të kësaj Shoqate, z. Giuseppe Zadra, në Romë, Itali. Takimi u zhvillua në formën e një seminari të përbashkët, të organizuar nga Shoqata e Bankave Italiane dhe Banka e Shqipërisë, qëllimi i të cilit ishte njohja e eksperiencës italiane në lidhje me krijimin e Zyrës së Informacionit të Kredive në Shqipëri. Z. Fullani pasi njohu përfaqësuesit e lartë të Shoqatës së Bankave Italiane me përpjekjet e hershme të sistemit bankar shqiptar për të ngritur Zyrën e Informacionit të Kredive, theksoi se tashmë Banka e Shqipërisë është e vendosur të krijojë këtë zyrë. Në përfundim të takimit, z. Zadra dhe z. Sella u shprehën të gatshëm për të asistuar dhe për të mbështetur nismën e Bankës së Shqipërisë për krijimin e Zyrës së parë të Informacionit të Kredive në Shqipëri.

Leksioni i parë i "Serisë së leksioneve publike" të Bankës së Shqipërisë.

Në datën 23 mars 2006, u mbajt leksioni i parë i "Serisë së Leksioneve Publike" që Banka e Shqipërisë do të organizojë gjatë këtij viti në bashkëpunim me Zyrën e GTZ-së (Shoqata Gjermane për Bashkëpunim Teknik) në Tiranë. Seria e Leksioneve të Bankës së Shqipërisë do të trajtojë një numër çështjesh që kanë të bëjnë me politikën monetare, me ekonominë në tranzicion dhe me tregjet financiare. Kjo seri leksionesh ka për qëllim nxitjen dhe zhvillimin e kërkimit shkencor në fushën e financave, nëpërmjet trajtimit të tematikave nga bankingu, financat dhe çështjet ekonomike aktuale. Në fjalën e tij të hapjes, z. Fullani lançoi edhe projektin "Çmimi i Guvernatorit", i cili konsiston

në zhvillimin e një konkursi të hapur, ku të gjithë studentët e interesuar të fakulteteve ekonomike mund të konkurojnë me temat e tyre të diplomës, që fokusohen në çështje të lidhura me fushën e veprimtarisë së Bankës së Shqipërisë.

Takim i Guvernatorit të Bankës së Shqipërisë, z. Ardian Fullani me përfaqësues të komunitetit të biznesit, të pushtetit lokal, të sektorit bankar dhe me akademikë të Universitetit të qytetit të Gjirokastrës.

Në datën 31 mars 2006, Guvernatori i Bankës së Shqipërisë, z. Ardian Fullani, zhvilloi një takim në qytetin e Gjirokastrës me përfaqësues të pushtetit lokal, të sektorit bankar, të komunitetit të biznesit dhe akademikët e Universitetit të Gjirokastrës. Ky takim u organizua si një vazhdim i nismës së ndërmarrë nga Banka e Shqipërisë për të zhvilluar takime të tilla në rajone të ndryshme të vendit, me qëllim rritjen e rolit të degëve të Bankës së Shqipërisë dhe përmirësimin e komunikimit me publikun. Në fjalën e tij, Guvernatori vuri një theks të veçantë në komunikimin me grupe të ndryshme të interesit, ku u ndal në dialogun institucional dhe të vazhdueshëm që duhet ndërtuar me komunitetin e biznesit, me qarqet akademike, me sistemin bankar dhe me studentët. Reduktimi i informalitetit ishte një tjetër çështje e trajtuar nga Guvernatori, në lidhje me të cilën ai u shpreh se pajisja e çdo individi me kartë identiteti, me adresë postare dhe me llogari bankare janë tre elemente thelbësore për zgjidhjen e këtij problemi.

NGJARJET JURIDIKE, JANAR-MARS 2006

EMISIONI

Në datën 25 janar 2006, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë miratoi me vendimin nr. 2 rregulloren "Për ekspozimin e vlerave numizmatike në Bankën e Shqipërisë dhe administrimin e ruajtjen e tyre". Kjo rregullore përcakton rregullat dhe procedurat që do të ndiqen për ekspozimin e vlerave numizmatike dhe administrimin e ruajtjen e tyre në Bankën e Shqipërisë.

MBIKËQYRJA BANKARE

Në datën 25 janar 2006, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë miratoi vendimin nr.3 "Për dhënien e miratimit paraprak të licencës për të ushtruar veprimtari bankare, bankës së propozuar "Banka e Parë e Investimeve – Shqipëri sh.a."". Nëpërmjet këtij vendimi, kjo bankë do të transformohet nga degë në Tiranë e Bankës së Parë të Investimeve – Bullgari, në një filial në Shqipëri të Bankës së Parë të Investimeve – Bullgari.

Në datën 8 shkurt 2006, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë miratoi me vendimin nr. 9 dokumentin "Për misionin e mbikëqyrjes". Qëllimi i këtij dokumenti është përcaktimi i misionit të Bankës së Shqipërisë si autoriteti mbikëqyrës i bankave dhe i subjekteve të tjera financiare të licencuara prej saj.

AUDITIMI

Në datën 25 janar 2006, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë miratoi vendimin nr. 4 "Për caktimin e kontrollorëve të jashtëm për auditimin e aktivitetit të Bankës së Shqipërisë". Në bazë të këtij vendimi, kompania "Deloitte Albania sh.p.k." do të jetë kontrollore e jashtme për llogaritë, regjistrat dhe bilancin e Bankës së Shqipërisë për vitet 2005, 2006 dhe 2007.

JURIDIKU

Në datën 22 shkurt 2006, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë miratoi me vendimin nr.13 rregulloren "Për nxjerrjen e akteve juridike". Kjo rregullore ka për qëllim përcaktimin e rregullave dhe të procedurave të nxjerrjes së akteve juridike nga organet e Bankës së Shqipërisë.

POLITIKA EKONOMIKE

Në datën 13 janar 2006, Këshilli i Ministrave miratoi me vendimin nr. 15 një ndryshim në vendimin nr. 429, datë 30.08.1993 të Këshillit të Ministrave "Për krijimin e komitetit qeveritar të bisedimit të borxhit të jashtëm". Në bazë të këtij ndryshimi, ky komitet ka në përbërjen e tij Ministrin e Financave, Guvernatorin e Bankës së Shqipërisë, Ministrin e Drejtësisë, Ministrin e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjitikës, Drejtorin e Drejtorisë së Përgjithshme të Thesarit në Ministrinë e Financave, Drejtorin e Departamentit të Operacioneve Monetare në Bankën e Shqipërisë, si dhe ekspertë vendas apo të huaj.

Në datën 19 janar 2006, Kuvendi i Republikës së Shqipërisë miratoi me ligjin nr. 9465 "Marrëveshjen ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës Çeke për zgjidhjen e borxhit të Shqipërisë kundrejt Republikës Çeke". Kjo marrëveshje përcakton kushtet dhe mënyrën se si Republika e Shqipërisë do të shlyejë borxhin e saj kundrejt Republikës Çeke.

Në datën 2 shkurt 2006, Kuvendi i Republikës së Shqipërisë miratoi me ligjin nr. 9465 "Marrëveshjen financiare ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Komisionit të Komunitetit Evropian "Programi vjetor CARDS 2005 për Shqipërinë"". Komuniteti do të kontribuojë për financimin e programit CARDS 2005 për Shqipërinë me shumën prej 44.2 milionë euro.

Në datën 2 shkurt 2006, Ministria e Financave miratoi udhëzimin nr. 2 "Për zbatimin e buxhetit të shtetit për vitin 2006". Ky udhëzim saktëson rregullat e përgjithshëm dhe procedurat e zbatimit të buxhetit për vitin 2006.

Në datën 22 shkurt 2006, Këshilli i Ministrave miratoi vendimin nr. 179 "Për krijimin e njësive të integrimit evropian në ministritë e linjës". Sipas këtij vendimi njësi të integrimit evropian do të ketë në përbërjen e Ministrisë së Drejtësisë, Ministrisë së Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Ministrisë së Financave, Ministrisë së Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave, Ministrisë së Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, Ministrisë së Brendshme, Ministrisë së Shëndetësisë, Ministrisë së Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës dhe Ministrisë së Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve. Njësitë e integrimit evropian bashkërendojnë dhe mbështesin punën e institucioneve respektive, për fushat e përqendruara në elementet kryesore të *acquis communautaire*, në zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit.

Në datën 20 mars 2006, Kuvendi i Republikës së Shqipërisë miratoi ligjin nr. 9497 "Për krijimin e Agjencisë Shqiptare të Biznesit dhe Investimeve". Agjencia Shqiptare e Biznesit dhe Investimeve, do të jetë një person juridik publik nën varësinë e Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjitikës dhe do të ushtrojë veprimtarinë në gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë. Objekti kryesor i veprimtarisë së saj do të jetë zbatimi i politikave dhe strategjive,

zhvillimi i programeve dhe projekteve në mbështetje të zhvillimit të sektorit privat, si dhe nxitja, tërheqja dhe mbështetja e investimeve të huaja në përputhje me përparësitë e politikës së Qeverisë Shqiptare.

TREGU I SIGURIMEVE

Në datën 23 janar 2006, Autoriteti Mbikëqyrës i Sigurimeve miratoi me vendimin nr. 2 rregulloren "Për rregullat dhe kufijtë e investimit të kapitalit të shoqërive të sigurimit". Kjo rregullore përcakton kufijtë e investimit të kapitalit të shoqërive të sigurimit dhe vendos një ekuilibër midis aktivitetit të investimit të kapitalit të shoqërive të sigurimit dhe respektimit të detyrueshëm të disa raporteve mbikëqyrëse.

Në datën 23 janar 2006, Autoriteti Mbikëqyrës i Sigurimeve miratoi vendimin nr. 3 "Për miratimin e aksionerëve me pjesëmarrje influencuese në shoqërinë e sigurimit "Dukagjini Al sh.a"". Në bazë të këtij vendimi, aksionerë të kësaj kompanie bëhen z. Kadri Morinaj me një pjesëmarrje prej 75 për qind të aksioneve dhe z. Faik Broci me pjesëmarrje prej 12 për qind të aksioneve.

Në datën 3 shkurt 2006, Autoriteti Mbikëqyrës i Sigurimeve miratoi vendimin nr. 5 "Për ndryshimin e emrit të shoqërisë së sigurimeve "Dukagjini Al sh.a"". Në bazë të këtij vendimi, shoqëria e sigurimeve "Dukagjini Al sh.a." shndërrohet në "Eurosig sh.a."

Në datën 3 shkurt 2006, Autoriteti Mbikëqyrës i Sigurimeve miratoi vendimin nr.6 "Për miratimin e ushtrimit të veprimtarisë risiguruese të shoqërisë së sigurimit "Sigal sh.a."". Ky vendim i njeh të drejtën shoqërisë së sigurimit "Sigal sh.a." të ushtrojë veprimtarinë risiguruese, por Autoriteti Mbikëqyrës i Sigurimeve rezervon të drejtën e revokimit të këtij vendimi, në rast se në të ardhmen do të përkeqësohet gjendja financiare e shoqërisë së sigurimit nga ushtrimi i kësaj veprimtarie.

DREJTIMI I BANKËS SË SHQIPËRISË
31 MARS 2006

KËSHILLI MBIKËQYRËS

ARDIAN FULLANI	*Kryetar*
FATOS IBRAHIMI	*Zëvendëskryetar*
TEFTA ÇUÇI	*Anëtare*
ELISABETA GJONI	*Anëtare*
LIMOS MALAJ	*Anëtar*
SULO HADËRI	*Anëtar*
TONIN KOLA	*Anëtar*
KSENOFON KRISAFI	*Anëtar*
ADRIAN CIVICI	*Anëtar*

GUVERNATORI

ARDIAN FULLANI

KABINETI I GUVERNATORIT

GENC MAMANI

ZËVENDËSGUVERNATORËT

FATOS IBRAHIMI	*Zëvendësguvernator i Parë*

INSPEKTORI I PËRGJITHSHËM

TEUTA BALETA

DEPARTAMENTET DHE NJËSITË E TJERA

DEPARTAMENTI I BURIMEVE NJERËZORE	*Dashmir Halilaj*
DEPARTAMENTI I POLITIKËS MONETARE	*Gramoz Kolasi*
DEPARTAMENTI I KËRKIMEVE	*Erjon Luçi*
DEPARTAMENTI I OPERACIONEVE MONETARE	*Marjan Gjermeni*
DEPARTAMENTI I MBIKËQYRJES	*Klodion Shehu*
DEPARTAMENTI I TEKNOLOGJISË SË INFORMACIONIT	*Xhilda Kanini*
DEPARTAMENTI I STATISTIKËS	*Kliti Ceca*
DEPARTAMENTI I EMISIONIT	*Valer Miho*
DEPARTAMENTI I KONTABILITETIT DHE PAGESAVE	*Marseda Dumani*
DEPARTAMENTI JURIDIK	*Toni Gogu*
DEPARTAMENTI I KONTROLLIT	*Teuta Baleta*
DEPARTAMENTI I MARRËDHËNIEVE ME JASHTË, INTEGRIMIT EVROPIAN DHE I KOMUNIKIMIT	*Ina Kraja*
DEPARTAMENTI I ADMINISTRIMIT	*Agron Skënderaga*
DEPARTAMENTI I SIGURIMIT DHE MBROJTJES	-
SHTYPSHKRONJA	*Alfons Theka*

DEGËT

ERMIRA ISTREFI	*Shkodra*
VALENTINA DEDJA	*Elbasani*
ANILA THOMAJ	*Gjirokastra*
LILJANA ZJARRI	*Korça*
SHPRESA MEÇO	*Lushnja*

LISTA E SUBJEKTEVE TË LICENCUARA NGA BANKA E SHQIPËRISË*

BANKA DHE DEGË TË BANKAVE TË HUAJA

1. BANKA ITALO – SHQIPTARE SH.A.
Licenca nr.1/1996, datë 17.07.1998.
Miratuar me vendimin e Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë nr.89, datë 18.06.1998. Çertifikata nr. 1 "Për sigurimin e depozitave".
Drejtori: *Giovanni BOGANI*
Adresa: *Rruga "Barrikadave", Nr.70, Tiranë.*
Tel. Central: *23 39 65, 23 56 97, 23 56 98, 22 62 62.*
Faks: *23 30 34.*

2. BANKA RAIFFEISEN SH.A.
Licenca nr.2/1998, datë 11.01.1999.
Miratuar me vendimin e Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë nr.163, datë 11.12.1998. Çertifikata nr. 2 "Për sigurimin e depozitave".
Drejtori: *Steven GRUNERUD*
Adresa: *Rruga "Kavajës", Tiranë.*
Tel. Central: *22 45 40, 22 26 69, 22 54 16.*
Faks: *22 35 87, 22 36 95, 22 40 51.*

3. BANKA E BASHKUAR E SHQIPËRISË SH.A.
Licenca nr.3/1998, datë 11.01.1999.
Miratuar me vendimin e Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë nr.165, datë 11.12.1998. Çertifikata nr.3 "Për sigurimin e depozitave".
Drejtori: *Abdul Waheed ALAVI*
Adresa: *Bulevardi "Dëshmorët e Kombit", Nr.8, Tiranë.*
Tel. Central: *22 84 60, 22 38 73, 22 74 08.*
Faks: *22 84 60, 22 83 87.*

4. BANKA ITALIANE E ZHVILLIMIT (ISH-DARDANIA)
Licensa Nr. 5/1998, datë 11.01.1999
Miratuar me vendimin e Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë nr. 164, datë 11.12.1998. Çertifikata nr.4 "Për sigurimin e depozitave".
Drejtori: *Libero CATALANO*
Adresa: *Bulevardi "Dëshmorët e Kombit", Ndërtesa Kullat Binjake, Tiranë.*
Tel. central: *280 351 / 2 / 3 / 4 / 5.*
Faks: *280 356.*

5. BANKA KOMBËTARE TREGTARE SH.A
Licenca nr.6/1998, datë 11.01.1999.
Miratuar me vendimin e Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë nr.162, datë 11.01.1999. Çertifikata nr.5 "Për sigurimin e depozitave".
Drejtori: *Seyhan PENCAPLIGIL*
Adresa: *Bulevardi "Zhan D'Ark", Tiranë.*
Tel: *25 09 55.*
Faks: *25 09 56.*

6. BANKA TIRANA SH.A.

** Deri në 31 mars, 2006.*

Licenca nr.07, datë 12.09.1996.
Miratuar me vendimin e Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë nr.9, datë 12.09.1996. Çertifikata nr.6 "Për sigurimin e depozitave".
Drejtori: *Dimitrios FRANGETIS*
Adresa: *Bulevardi "Zogu I", Nr.55/1, Tiranë.*
Tel. Central: *23 34 41/42/43/44/45/46/47.*
Faks: *23 3417.*

7. BANKA KOMBETARË E GREQISË - DEGA TIRANË
Licenca nr.08, datë 25.11.1996.
Miratuar me vendimin e Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë nr.4, datë 14.03.1996. Çertifikata nr.7 "Për sigurimin e depozitave".
Drejtori: *Spiro BRUMBULLI*
Adresa: *Rruga "Durrësit", Godina "Comfort", Tiranë.*
Tel. Central: *23 36 21/22/23/24.*
Faks: *23 36 13.*

8. BANKA NDËRKOMBËTARE TREGTARE SH.A
Licenca nr.09, datë 20.02.1997.
Miratuar me vendimin e Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë nr.9, datë 30.04.1996. Çertifikata nr.8 "Për sigurimin e depozitave".
Drejtori: *Ooi Kooi KEAT*
Adresa: *Qendra e Biznesit, Rruga "Murat Toptani", Tiranë.*
Tel. Central: *25 43 72, 25 62 54.*
Tel/Faks: *25 43 68.*

9. DEGA NË TIRANË E BANKËS ALPHA
Licenca nr.10, datë 07.01.1998.
Miratuar me vendimin e Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë nr.01/03/96, datë 27.12.1997. Çertifikata nr. 9 "Për sigurimin e depozitave".
Drejtori: *Andrea GALATOULAS*
Adresa: *Bulevardi "Zogu I", Nr.47, Tiranë.*
Tel: *23 35 32, 23 33 59, 34 04 76/77.*
Tel/Faks: *23 21 02.*

10. BANKA AMERIKANE E SHQIPËRISË SH.A.
Licenca nr.11, datë 10.08.1998.
Miratuar me vendimin e Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë nr.105, datë 10.08.1998. Çertifikata nr.10 "Për sigurimin e depozitave".
Drejtori: *Lorenzo RONCARI*
Adresa: *Rruga "Ismail Qemali" Nr.27, P.O. Box 8319, Tiranë.*
Tel: *24 87 53/54/55/56.*
Tel/Faks: *24 87 62.*

11. BANKA PROCREDIT SH.A.
Licenca nr. 12, datë 15.03.1999.
Miratuar me vendimin e Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë nr.22, datë 03.03.1999. Çertifikata nr. 11 "Për sigurimin e depozitave".
Drejtori: *Ralf REITEMEIER*
Adresa: *Rruga "Sami Frashëri", Tirana e Re, P.O. Box. 2395, Tiranë.*
Tel: *27 12 72/73/74/75.*
Tel/Faks: *27 12 76.*

12. BANKA E PARË E INVESTIMEVE SH.A - DEGA TIRANË
Licenca nr. 13, datë 16.04.1999.
Miratuar me vendimin e Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë nr.45, datë

13.04.1999. Çertifikata nr. 12 "Për sigurimin e depozitave".
Drejtori: Martin Tsvetkov BOGDANOV
Adresa: Bulevardi "Zogu I", Nr. 64, Tiranë.
Tel: 25 64 23, 25 64 24.
Tel/Faks: 25 64 22.

13. BANKA EMPORIKI – SHQIPËRI SH.A.
Licenca nr. 14, datë 28.10.1999.
Miratuar me vendimin e Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë nr.105, datë 19.10.1999. Çertifikata nr. 13 "Për sigurimin e depozitave".
Drejtori: George CARACOSTAS
Adresa: Rruga "Kavajës", "Tirana Tower", Tiranë.
Tel: 35 87 55/56/57/58/59/60.
Tel/Faks: 35 87 52.

14. BANKA E KREDITIT TË SHQIPËRISË SH.A.
Licenca nr. 15, datë 28.08.2002.
Miratuar me vendimin e Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë nr.66, datë 28.08.2002. Çertifikata nr. 14 "Për sigurimin e depozitave".
Drejtori: Kamal Abdel MONEIM
Adresa: Rruga "Perlat Rexhepi", Al-Kharafi Group Administration Building, Kati 1&2, Tiranë.
Tel: 27 21 68; 27 21 62.
Tel/Faks: 27 21 62.

15. BANKA "CREDINS" SH.A.
Licenca nr. 16, datë 31.03.2003.
Miratuar me vendimin e Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë nr.22, datë 26.03.2003. Çertifikata nr. 15 "Për sigurimin e depozitave".
Drejtori: Artan SANTO
Adresa: Rruga ''Ismail Qemali'', Nr.21 Tiranë.
Tel: 22 29 16; 23 40 96.

16. BANKA POPULLORE SH.A.
Licenca nr.17, datë 16.02.2004.
Miratuar me vendimin e Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë nr.06, datë 11.02.2004. Çertifikata nr.16 "Për sigurimin e depozitave".
Drejtori: Edvin LIBOHOVA
Adresa: Rruga ''Donika Kastrioti'', Pallati 11/1, Kati I, Tiranë.
Tel: 27 27 88/89/90/91.
Faks: 27 27 81.

17. BANKA UNION SH.A, TIRANË.
Licenca nr. 18, datë 09.01.2006.
Miratuar me vendimin e Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë nr. 101, datë 28.12.2005. Çertifikata nr.17 "Për sigurimin e depozitave".
Drejtori: Gazmend KADRIU
Adresa: Bulevardi "Zogu I", Pallati 13-katësh, përballë Stacionit të Trenit, Tiranë.
Tel: 25 06 53.
Faks: 25 06 54.

SUBJEKTE JOBANKA

1. UNIONI FINANCIAR I TIRANËS SH.P.K. (UFT)
Licenca nr.1, datë 08.12.1999, për ushtrimin e veprimtarive financiare:
- të ofrimit të shërbimit të pagesave dhe të arkëtimeve;
- të ndërmjetësimit të transaksioneve monetare;
- të shërbimit si agjent dhe këshilltar financiar.

Drejtor: *Niko Leka; Edmond Leka*
Adresa: *Rruga "Reshit Çollaku", Pallati "Shallvare", Sh.2, Nr.18, Tiranë.*
Tel: *25 06 53.*
Faks: *25 06 54*

2. DINERS CLUB ALBANIA SH.P.K.
Licenca nr.2, datë 09.10.2000, për ushtrimin e veprimtarisë financiare:
- të ndërmjetësimit të transaksioneve monetare.

Drejtor: *Edmond Leka*
Adresa: *Bulevardi "Zogu I", Qendra e Biznesit "VEVE", Tiranë.*

3. POSTA SHQIPTARE SH.A.
Licenca nr.3, datë 18.04.2001, për ushtrimin e veprimtarive financiare:
- të ofrimit të shërbimit të pagesave dhe të arkëtimeve;
- të shërbimit si agjent dhe këshilltar financiar.

Pronësia: *Shtetërore.*
Drejtor: *Arqile Goreja*
Adresa: *Rruga "Reshit Çollaku", Nr.4 Tiranë.*
Tel: *22 23 15.*

4. "CREDINS" SH.A. TIRANË
Licenca nr. 4, datë 13.06.2001, për ushtrimin e veprimtarive financiare:
- të dhënies së kredive;
- të ofrimit të shërbimit të pagesave dhe të arkëtimeve;
- të ndërmjetësimit për transaksionet monetare (duke përfshirë valutat);
- të ofrimit të garancive;
- të shërbimit si agjent dhe këshilltar financiar (këtu nuk përfshihen shërbimet e parashikuara në pikat 3/a dhe 3/b të nenit 26, të ligjit: "Për bankat në Republikën e Shqipërisë").

Drejtore: *Migena Roshaj*
Adresa: *Rruga "Ismail Qemali", Nr.21, Tiranë.*
Tel: *22 29 16; 23 40 96.*

5. FONDI I FINANCIMIT TË ZONAVE MALORE
Licenca nr.5, datë 29.03.2002, si subjekt financiar jobankë, për ushtrimin e veprimtarisë financiare:
- të dhënies së kredive.
Themeluar me vendim të Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë.

Drejtor: *Arben Jorgji*
Adresa: *Rruga "Mustafa Matohiti", Vila nr.12, Tiranë.*
Tel: *25 06 33.*

6. "AK – INVEST" SH.A.
Licenca nr.7, datë 03.12.2003, si subjekt financiar jobankë, për ushtrimin e veprimtarive financiare:
- të ofrojë shërbimin e pagesave dhe të arkëtimeve;
- të ndërmjetësojë për transaksionet monetare (duke përfshirë valutat);
- të shërbejë si agjent dhe këshilltar financiar.

Administratori: *Ilir Adili*
Adresa: *Rruga "Ded Gjon Luli", Nr.2/3, Tiranë.*
Tel: *24 01 47.*

SUBJEKTET FINANCIARE QË NUK LICENCOHEN NGA BANKA E SHQIPËRISË PËR KRYERJEN E VEPRIMTARISË SË TYRE, NË MBËSHTETJE TË VENDIMIT NR. 26, DATË 29.03.2000, TË KËSHILLIT MBIKËQYRËS TË BANKËS SË SHQIPËRISË "PËR PËRJASHTIMIN E DISA SUBJEKTEVE NGA ZBATIMI I DISPOZITAVE TË LIGJIT NR. 8365, DATË 02.07.1998 "PËR BANKAT NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË"".

(Këto subjekte nuk licencohen apo mbikëqyren nga Banka e Shqipërisë, por kanë detyrimin të raportojnë në Bankën e Shqipërisë.)

1. FONDI I FINANCIMIT RURAL
Themeluar me vendim të Këshillit të Ministrave nr. 207, datë 28.04.1999.
Objekti i veprimtarisë: Financimi i zonave rurale.
Përjashtuar me shkresën e Bankës së Shqipërisë nr.1843, datë 01.08.2000.

Drejtore: *Zana Konini.*
Adresa: *Rruga"Ismail Qemali", Pallati 32, Tiranë.*

2. FONDACIONI "BESA"
Themeluar nga "Fondacioni i Shoqërisë së Hapur për Shqipërinë" (SOROS).
Objekti i veprimtarisë: Financimi i ndërmarrjeve të mesme dhe të vogla.
Përjashtuar me shkresën e Bankës së Shqipërisë nr. 2895/1, datë 19.01.2001.

Drejtori: *Bajram Muça.*
Adresa: *Rruga "Asim Vokshi", Nr. 35, Tiranë.*

3. PARTNERI SHQIPTAR NË MIKROKREDI
Aksioner: "Opportunity International" (East Europe).
Objekti i veprimtarisë: Kredidhënia.
Përjashtuar me shkresën e Bankës së Shqipërisë nr. 828/1, datë 08.04.2002.

Drejtori: *James Reiff.*
Adresa: *Rruga "Gjin Bue Shpata", Nr. 7/1, Tiranë.*

ZYRA TË KËMBIMEVE VALUTORE

1. ZYRA E KËMBIMEVE VALUTORE "JOARD" SH.P.K., TIRANË
Licenca: *Nr. 1, datë 01.10.1999.*
Adresa: *Rruga "Ded Gjon Luli", Nr.2, Tiranë.*
Kambistë: *Josif Kote, Pajtim Kodra.*

2. ZYRA E KËMBIMEVE VALUTORE "AMA" SH.P.K., DURRËS
Licenca: *Nr. 2, datë 01.10.1999.*
Adresa: *Rruga "Tregtare", Lagja 3, Durrës.*
Kambistë: *Mirlinda Ceka, Ilir Hoxha.*

3. ZYRA E KËMBIMEVE VALUTORE "ARIS" SH.P.K., TIRANË
Licenca: *Nr. 3, datë 01.10.1999.*
Adresa: *Rruga "Luigj Gurakuqi" , Tiranë.*
Kambistë: *Ardian Goci, Ismet Noka.*

4. ZYRA E KËMBIMEVE VALUTORE "UNIONI FINANCIAR TIRANË" SH.P.K.
Licenca: *Nr. 4, datë 01.10.1999.*
Adresa: *Rruga "Reshit Çollaku", "Pallati Shallvare", Shk. 2/18, Tiranë.*
Administrator: *Niko Leka*
Kambistë: *Arjan Lezha (Përgjegjës i agjencisë), Albert Sara, Dhimitër Papadhopulli, Genta Angjeli (Agalliu), Piro Teti, Flora Simixhi, Petrika Mano (Përgjegjës i agjencisë), Lindita Shala, Mirela Bakalli, Anila Demiri, Emili Bakalli (Nako), Astrit Sfërdelli, Mirela Kaiku, Erisa Emiri.*

5. ZYRA E KËMBIMEVE VALUTORE "AGLI" SH.P.K., TIRANË
Licenca: *Nr. 5, datë 01.10.1999.*
Adresa: *Agjencia 1: Rruga "Islam Alla", Nr.1, Tiranë.*
Agjencia 2: Rruga "Kavajës", pranë pastiçeri "Rinia", Tiranë.
Kambistë: *Kujtim Nina (Drejtor i shoqërisë), Agim Cani, Selim Luli.*

6. ZYRA E KËMBIMEVE VALUTORE "EXCHANGE" SH.P.K., TIRANË
Licenca: *Nr. 08, datë 24.11.1999.*
Adresa: *Rruga "Durrësit", Nr. 170, Tiranë dhe rruga "Reshit Çollaku", pallati "Shallvare", Shk.2, Ap. 42, Tiranë*
Kambistë: *Ivan Pavllovski.*

7. ZYRA E KËMBIMEVE VALUTORE "UNISIX" SH.P.K., KORÇË
Licenca: *Nr. 09, datë 26.11.1999.*
Adresa: *Bulevardi "Republika", Pallati 4, Korçë.*
Kambistë: *Pandi Cunoti, Ernest Golka, Nikolin Bicka, Eli Bode.*

8. ZYRA E KËMBIMEVE VALUTORE "EKSPRES J & E" SH.P.K., DURRËS
Licenca: *Nr. 10, datë 26.11.1999.*
Adresa: *Lagja 11, Rruga "Prokop Meksi" (pranë hotel "Durrësi"), Durrës.*
Kambistë: *Kostandin Ekonomi, Entela Ekonomi.*

9. ZYRA E KËMBIMEVE VALUTORE "ILIRIA '98" SH.P.K., TIRANË
Licenca: *Nr. 12, datë 25.02.2000.*
Adresa: *Sheshi "Skënderbej", Teatri i Kukullave, Tiranë.*
Kambistë: *Edmond Ymeri, Ali Topalli, Ilir Janku.*

10. ZYRA E KËMBIMEVE VALUTORE "SERXHIO" SH.P.K., ELBASAN
Licenca: *Nr. 14, datë 07.04.2000.*
Adresa: *Lagja "Luigj Gurakuqi", Rruga "11 Nëntori", pallati 70, Nr.14, Elbasan.*
Kambistë: *Amarildo Canoku.*

11. ZYRA E KËMBIMEVE VALUTORE "ALBTUR" SH.P.K., TIRANË
Licenca: *Nr. 15, datë 07.04.2000.*
Adresa: *Bulevardi "Zogu I", Pallati 32, Shk.1 (përballë Bankës Tirana), Tiranë.*
Kambistë: *Albert Rahmani, Artur Rahmani.*

12. ZYRA E KËMBIMEVE VALUTORE "R & M" SH.P.K., TIRANË
Licenca: *Nr. 16, datë 22.05.2000.*
Adresa: *Rruga "Punëtorët e Rilindjes", Pallati 182, Tiranë.*
Kambistë: *Edmond Stepa, Miranda Stepa.*

13. ZYRA E KËMBIMEVE VALUTORE "TEUTA 2000" SH.P.K., DURRËS
Licenca: *Nr. 17, datë 22.05.2000.*
Adresa: *Lagja 4, Rruga "Skënderbej", Ap. 950, Durrës.*
Kambistë: *Qemal Hoxha, Arben Çuni.*

14. ZYRA E KËMBIMEVE VALUTORE "T & E" SH.P.K., DURRËS
Licenca: *Nr. 18, datë 11.06.2000.*
Adresa: *Lagja 4, Rruga "9 Maji", Durrës.*
Kambist: *Shpëtim Hysa.*

15. ZYRA E KËMBIMEVE VALUTORE "SHIJAK 2000" SH.P.K., SHIJAK
Licenca: *Nr. 19, datë 24.11.2000.*
Adresa: *Lagja "Popullore", Shijak.*
Kambistë: *Nazmi Ademi, Farije Ademi.*

16. ZYRA E KËMBIMEVE VALUTORE "R & T" SH.P.K., TIRANË
Licenca: *Nr. 20, datë 20.12.2000.*
Adresa: *Bulevardi "Zogu I" (pranë BPI-së), Tiranë.*
Kambist: *Renis Tershana.*

17. ZYRA E KËMBIMEVE VALUTORE "MANUSHI" SH.P.K., TIRANË
Licenca: *Nr. 22, datë 18.04.2001.*
Adresa: *Bulevardi "Zogu I", Qendra e Biznesit "VEVE", Tiranë.*
Kambist: *Roland Manushi.*

18. ZYRA E KËMBIMEVE VALUTORE "UNIONI SELVIA" SH.P.K., TIRANË
Licenca: *Nr. 23, datë 21.05.2001.*
Adresa: *Rruga "Sami Frashëri", Pallati 11, Shk. 4, Ap. 29, Tiranë.*
Kambist: *Denis Merepeza (ortak i vetëm dhe administrator)*

19. ZYRA E KËMBIMEVE VALUTORE "KALENJA" SH.P.K., TIRANË
Licenca: *Nr. 24, datë 29.06.2001.*
Adresa: *Rruga "Kavajës" (pranë Ambasadës Turke), Tiranë.*
Kambistë: *Hair Shametaj, Fatmir Shametaj.*

20. ZYRA E KËMBIMEVE VALUTORE "TILBA" SH.P.K., ELBASAN
Licenca: *Nr. 25, datë 30.09.2001.*

Adresa: *Lagja "Luigj Gurakuqi", Bulevardi "Qemal Stafa", Njësia nr.12, Elbasan.*
Kambistë: *Kristaq Bako, Vjollca Bako.*

21. ZYRA E KËMBIMEVE VALUTORE "ANAGNOSTI" SH.P.K., TIRANË
Licenca: *Nr. 26, datë 31.10.2001.*
Adresa: *Zyra 1: Bulevardi "Zogu I", Pallati 97, Shk.3, Ap, 28, Tiranë.*
Kambistë: *Jani Anagnosti, Odise Anagnosti, Edlira Anagnosti.*
Zyra 2: Rruga "Kajo Karafili", Nr.11 Tiranë.
Kambist: *Fredi Cami.*

22. ZYRA E KËMBIMEVE VALUTORE "KO-GO" SH.P.K., TIRANË
Licenca: *Nr. 27, datë 12.11.2001.*
Adresa: *Rruga "Vaso Pasha", Pallati 16, Shk.2, Ap. 9, Tiranë.*
Kambistë: *Mihal Konomi, Përparim Goxhaj.*

23. ZYRA E KËMBIMEVE VALUTORE "ALB- FOREX" SH.P.K., TIRANË
Licenca: *Nr. 28, datë 22.11.2001.*
Adresa: *Agjencia 1: Rruga "Abdyl Frashëri, Nr.3, Tiranë.*
Kambistë: *Almir Duli, Agim Xhemo.*
Agjencia 2: *Rruga "Mine Peza", Pallati 102, Shk.1 (pranë Bar "Grand"), Tiranë.*
Kambist: *Fatmir Baholli.*

24. ZYRA E KËMBIMEVE VALUTORE "L&N" SH.P.K., TIRANË
Licenca: *Nr. 29, datë 22.11.2001.*
Adresa: *Rruga "Muhamet Gjollesha", ish-gjelltorja tek sheshi "ATATURK", Tiranë.*
Kambist: *Leonora Mihalcka.*

25. ZYRA E KËMBIMEVE VALUTORE "EXCHANGE ALOG" SH.P.K., TIRANË
Licenca: *Nr. 31, datë 22.11.2001.*
Adresa: *Rruga "Mine Peza" (përballë Selisë së Vatikanit), Tiranë.*
Kambistë: *Almida Sterio, Fatmir Tafaj, Eduard Andoni, Elida Hasamemi.*

26. ZYRA E KËMBIMEVE VALUTORE "BASHKIMI 2001" SH.P.K., TIRANË
Licenca: *Nr. 35, datë 12.12.2001.*
Adresa: *Rruga "Kavajës" (pastiçeri "Rinia"), Tiranë.*
Kambistë: *Bashkim Shametaj, Luan Shametaj, Ilir Mesini.*

27. ZYRA E KËMBIMEVE VALUTORE "ARJON 2002" SH.P.K., ELBASAN
Licenca: *Nr. 36, datë 14.12.2001.*
Adresa: *Lagja "Kongresi i Elbasanit", Bulevardi "Qemal Stafa", Pallati 9-katësh, Elbasan.*
Kambistë: *Arben Kovaçi, Besnik Lulja.*

28. ZYRA E KËMBIMEVE VALUTORE "ALAKTH" SH.P.K., TIRANË
Licenca: *Nr. 42, datë 18.01.2002.*
Adresa: *Rruga "Dibrës", Nr.105/1, Tiranë.*
Kambistë: *Kosta Papa, Arben Memko, Lorenc Konomi, Thoma Konomi, Aleko Plaku.*

29. ZYRA E KËMBIMEVE VALUTORE "FORMAT" SH.P.K., TIRANË
Licenca: *Nr. 43, datë 21.01.2002.*
Adresa: *Rruga "Durrësit", Pallati 85, Shk.1, Ap.1, Tiranë.*
Kambistë: *Diana Lemi, Egon Sinani.*

30. ZYRA E KËMBIMEVE VALUTORE "TRI URAT" SH.P.K., ELBASAN
Licenca: Nr. 44, datë 05.02.2002.
Adresa: Lagja "29 Nëntori", pranë Filialit të Postës Elbasan.
Kambistë: Fahri Sanco, Ismail Bejta.

31. ZYRA E KËMBIMEVE VALUTORE "BESA 2001" SH.P.K., TIRANË
Licenca: Nr. 46, datë 15.02.2002.
Adresa: Rruga "Myslym Shyri", Nr.25,Tiranë.
Kambistë: Belul Lleshi, Vladimir Avda, Mimoza Avda.

32. ZYRA E KËMBIMEVE VALUTORE "MARIO" SH.P.K., SARANDË
Licenca: Nr. 47, datë 14.03.2002.
Adresa: Lagja 1, pranë ish-Komitetit Ekzekutiv të rrethit Sarandë.
Kambistë: Vangjel Gramozi, Blerim Dhima.

33. ZYRA E KËMBIMEVE VALUTORE "JAV" SH.P.K., TIRANË.
Ka ndryshuar emrin Zyra e Këmbimit Valutor "R&T EXCHANGE" Sh.p.k.
Licenca: Nr. 48, datë 20. 03.2002.
Adresa: Bulevardi "Zogu I", Godina e "Zërit të Popullit", Tiranë.
Kambistë: Ervin Lera, Ilir Gurashi.

34. ZYRA E KËMBIMEVE VALUTORE "DROGU" SH.P.K., TIRANË
Licenca: Nr. 49, datë 23.04.2002.
Adresa: Rruga "Vaso Pasha", Kulla 1(pas pallatit Agimi), Kati I, Tiranë.
Kambistë: Shkëlqim Drogu, Kostandin Koteci.

35. ZYRA E KËMBIMEVE VALUTORE "HYSEN-C" SH.P.K., LAÇ
Licenca: Nr. 50, datë 23.04.2002.
Adresa: Lagja nr.3, përballë Komisariatit të Policisë, Laç.
Kambist: Cen Hyseni.

36. ZYRA E KËMBIMEVE VALUTORE "UNIONI FIER" SH.P.K., FIER
Licenca: Nr. 51, datë 08.05.2002.
Adresa: Lagja "15 Tetori", Rruga "Kastriot Muça", Fier.
Kambistë: Gjergj Dulaj (administrator).

37. ZYRA E KËMBIMEVE VALUTORE "TAXI EKSPRES" SH.P.K., ELBASAN
Licenca: Nr. 52, datë 20.05.2002.
Adresa: Rruga "Sami Frashëri", Nr.11 (pranë shkollës "Edith Durhan"), Tiranë.
Kambistë: Arben Sharra, Sokol Kaleci.

38. ZYRA E KËMBIMEVE VALUTORE "GLEAR" SH.P.K., SHIJAK
Licenca Nr. 55, datë 23.07.2002.
Adresa: Lagja "Kodër", Shijak, Durrës.
Kambistë: Argjend Calliku, Afërdita Calliku.

39. ZYRA E KËMBIMEVE VALUTORE "POSTA SHQIPTARE" SH.A. TIRANË
Licenca: Nr. 56, datë 28.08.2002.
Adresa: Rruga "Reshit Çollaku", Nr.4 Tiranë.

40. ZYRA E KËMBIMEVE VALUTORE "UNIONI BALLSH" SH.P.K., BALLSH
Licenca: *Nr. 57, datë 11.09.2002.*
Adresa: *Rruga "8 Nëntori", Ballsh.*
Kambistë: *Luan Zenelaj, Lavdimir Zenelaj.*

41. ZYRA E KËMBIMEVE VALUTORE "ESLULI" SH.P.K., TIRANË
Licenca: *Nr. 58, datë 17.10.2002.*
Adresa: *Rruga "Reshit Çollaku", Pallati "Shallvare", Shk.4/1, Tiranë.*
Kambistë: *Selim Luli, Kleomen Gjiknuri.*

42. ZYRA E KËMBIMEVE VALUTORE "DENI&KRISTI-2002" SH.P.K. TIRANË
Licenca: *Nr. 61, datë 02.06.2003.*
Adresa: *Rruga "Myslym Shyri", Pallati 60, Ap.3, Tiranë.*
Kambist: *Maksim Çeku.*

43. ZYRA E KËMBIMEVE VALUTORE "YLDON" SH.P.K. TIRANË
Licenca: *Nr. 62, datë 03. 06.2003.*
Adresa: *Rruga "Qemal Stafa", Pallati 382/2/2, Tiranë.*
Kambist: *Ylli Ndoqi (themelues dhe administrator).*

44. ZYRA E KËMBIMEVE VALUTORE "BILLI" SH.P.K. TIRANË
Licenca: *Nr. 63, datë 16. 02.2004.*
Adresa: *Sheshi "Wilson", Pallati i ri në kryqëzimin e Tiranës së Re.*
Kambist: *Sybi Cenolli (themelues dhe administrator).*

45. ZYRA E KËMBIMEVE VALUTORE "ALBA&ARBËR" SH.P.K., TIRANË
Licenca: *Nr. 65, datë 06.05.2004.*
Adresa: *Rruga "Kavajës", Pallati 3, Kati I, Tiranë.*
Kambistë: *Pëllumb Memetaj, Bukurosh Jaho (administratorë).*

46. ZYRA E KËMBIMEVE VALUTORE "I.S.N." SH.P.K., TIRANË
Licenca: *Nr. 66, datë 06.05.2004.*
Adresa: *Rruga "Kavajës", Pallati 3, Kati I, Tiranë.*
Kambistë: *Evzi Zemzadja (administrator), Nexhmi Uka, Salandi Brojaj.*

47. ZYRA E KËMBIMEVE VALUTORE "ARIABA" SH.P.K., TIRANË
Licenca: *Nr. 67, datë 07.06.2004.*
Adresa: *Rruga "Abdyl Frashëri", pranë Librit Universitar, Kati I, Shk.5, Tiranë.*
Kambistë: *Agim Xhemo (administrator), Astrit Hado.*

48. ZYRA E KËMBIMEVE VALUTORE "ALBACREDITS" SH.P.K., TIRANË
Licenca: *Nr. 68, datë 13.07.2004.*
Adresa: *Rruga "Ded Gjon Luli", Nr. 5, Tiranë.*
Kambistë: *Ermira Skënderi (administratore), Engjëll Skënderi, Burhan Kodra, Shqiponja Spahiu.*

49. ZYRA E KËMBIMEVE VALUTORE "ALB-KREDIT" SH.P.K., TIRANË
Licenca: *Nr.69, datë 19.07.2004.*
Adresa: *Rruga "Durrësit", Nr. 2, Tiranë.*
Kambistë: *Arben Cani (administrator), Vasil Marto, Rudina Muskaj, Teuta Koltarka, Hajredin Toca, Valbona Kadriu.*

50. ZYRA E KËMBIMEVE VALUTORE "IDEA - 2" SH.P.K., KAVAJË
Licenca: *Nr. 70, datë 02.09.2004*
Adresa: *Lagja nr.2, Rruga "10 korriku", Kavajë.*
Kambist: *Taulant Karkini (administrator).*

51. ZYRA E KËMBIMEVE VALUTORE "O & G" SH.P.K., TIRANË
Licenca: *Nr. 71, datë 30.09.2004*
Adresa: *Rruga "Kavajës", përballë Kishës Katolike, Tiranë*
Kambistë: *Prandvera Ago (administratore), Teuta Broqi.*

52. ZYRA E KËMBIMEVE VALUTORE "OMEGA" SH.P.K., TIRANË
Licenca: *Nr. 72, datë 20.12.2004*
Adresa: *Rruga "Abdyl Frashëri", Pallati 1, Shk. 2, Ap. 10, Tiranë.*
Kambistë: *Mihallaq Peko (administrator).*

53. ZYRA E KËMBIMEVE VALUTORE "ELBA 2005" SH.P.K., TIRANË
Licenca: *Nr. 73, datë 28.04.2005*
Adresa: *Bulevardi "Bajram Curri", pallatet "Agimi", nr. 16, Tiranë.*
Kambistë: *Kujtim Elbasani (administrator).*

54. ZYRA E KËMBIMEVE VALUTORE "JONADA – 05" SH.P.K., TIRANË
Licenca: *Nr. 74, datë 27.06.2005*
Adresa: *Rruga "Kavajës", Pallati 185, Shk. 2, Ap. 09, Tiranë.*
Kambistë: *Liliana Zyfi (administrator), Pëllumb Zyfi.*

55. ZYRA E KËMBIMEVE VALUTORE "BASHA – N.B." SH.P.K., ELBASAN
Licenca nr. *Nr. 75, date 08.07.2005*
Adresa: *Lagja "Shënkoll", rruga "Thoma Kaleshi", Pallati 110, shk. 1, kati i parë, Elbasan.*
Kambistë: *Nashifer Basha, Çlirim Basha, Sonila Alla.*

56. ZYRA E KËMBIMEVE VALUTORE "ÇELA 2005" SH.P.K., LUSHNJË
Licenca: *Nr. 76, datë 02.08.2005*
Adresa: *Lagja "Çlirim", Lushnjë.*
Kambistë: *Bledar Çela.*

57. ZYRA E KËMBIMEVE VALUTORE "I & K 2005" SH.P.K., LEZHË
Licenca: *Nr. 77, datë 09.09.2005*
Adresa: *Lagja "Besëlidhja", Pallati 73, Lezhë.*
Kambistë: *Ilir Malaj.*

58. ZYRA E KËMBIMEVE VALUTORE "EUROTOURS" SH.P.K., TIRANË
Licenca: *Nr.78, datë 17.10.2005*
Adresa: *Rruga "Reshit Çollaku", Nr. 2/18, pallatet "Shallvare", Tiranë.*
Kambistë: *Albert Cara, Ilir Stafa.*

59. ZYRA E KËMBIMEVE VALUTORE "A.B.I. EXCHANGE" SH.P.K., TIRANË
Licenca. *Nr.79, datë 17.02.2006*
Adresa: *Bulevardi "Zog I", Godina "Zëri i Popullit", Tiranë.*
Kambistë: *Ilir Doçi, Suela Dedaj*
Ortakë: *Rexhep Tafaj, Artan Pulaha, Ilir Doçi (administrator)*
Nr. mobile: *068 20 54 116*

60. ZYRA E KËMBIMEVE VALUTORE "REGENCY INTERNATIONAL CASINO TIRANA" SH.P.K., TIRANË
Licenca:. *Nr.80, datë 06.03.2006*
Adresa: *Rruga "Dëshmorët e 4 Shkurtit", Parku "Rinia", Tiranë.*
Kambistë: *Rajmonda Lami, Florjan Lami, Bandill Molla, Suzana Aliu, Aides Goga, Majlinda Jupas*

61. ZYRA E KËMBIMEVE VALUTORE "ARBËR F" SH.P.K., TIRANË
Licenca: *Nr.81, datë 07.03.2006*
Adresa: *Rruga "Kavajës", Pallati 3, Kati I (ish Guden) Tiranë.*
Kambistë: *Florina Jaho, Bukurosh Jaho*
Nr. mobile: *068 22 18 652*
Nr. telefoni: *248 384.*

62. ZYRA E KËMBIMEVE VALUTORE "EURO 2006" SH.P.K., DURRËS
Licenca: *Nr.82, datë 12.04.2006*
Adresa: *Lagja nr. 4, Rruga "Migjeni", pranë Poliklinikës Qendrore, Durrës.*
Kambistë: *Hysni Baganaçi, Medi Dyrmishi*
Nr. mobile: *068 26 18 699*

UNIONET E SHOQËRIVE TË KURSIM-KREDITIT

1. UNIONI I SHOQËRIVE TË KURSIM-KREDITIT "JEHONA" TIRANË
Licenca: Nr.1, datë 27.06.2002.
Adresa: Rruga "Kajo Karafili", nr.26/1
Kryetar i bordit drejtues: Vojsava Rama.
Anëtare të këtij unioni janë 41 shoqëri të kursim-kreditit, të cilat janë të licencuara edhe si shoqëri të veçanta. Mbështeten me asistencë teknike nga fondacioni "Lëvizja për zhvillimin e shoqërive të kursim-kreditit".

2. UNIONI I SHOQËRIVE TË KURSIM-KREDITIT "UNIONI SHQIPTAR KURSIM-KREDITIT", TIRANË
Licenca: Nr.2, datë 09.08.2002.
Adresa: Rruga "Ismail Qemali", Nr.32.
Kryetar i bordit drejtues: Zana Konini
Anëtare të këtij unioni janë 98 shoqëri të kursim-kreditit, të cilat janë të licencuara edhe si shoqëri të veçanta. Mbështeten me asistencë teknike nga Fondi i Financimit Rural.

ZYRA TË PËRFAQËSIMIT TË BANKAVE TË HUAJA

1. ZYRA E PËRFAQËSIMIT TË BANKËS POPULLORE PULIEZE NË SHQIPËRI.
Licenca: Nr.1, datë 02.07.2003.
Adresa: Sheshi "Skënderbej", Pallati i Kulturës, Kati III, Tiranë.
Përfaqësuesi: Pasquale Guido Vergine.